

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR

2017

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
1.1. TË ARRITURAT KRYESORE.....	9
1.2. SFIDAT DHE PENGESAT.....	9
2. KORNIZA LIGJORE.....	10
2.1. RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2017 NGA AGJENCIA.....	11
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	12
3.1. MISIONI DHE VIZIONI	12
3.1.1. MISIONI.....	12
3.1.2. VIZIONI.....	12
3.2 KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT.....	12
4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA.....	12
4.1. BORDI I DREJTORËVE.....	13
5. DEPARTAMENTI I SHITJES	13
6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT.....	15
6.1. SPIN OFF-ET SPECIALE.....	15
6.2. SPIN OFF-ET ME KUSHTE TË VEÇANTA	18
6.3. ADMINISTRIMI DIREKT.....	20
6.4. NDËSHKIMET FINANCIARE.....	23
7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT.....	24
7.1. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	24
7.2. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE.....	26
7.3 SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ KREDITORËVE.....	26
7.4. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE PA ASETË DHE/OSE PA KËRKESA KREDITORE.....	27
7.5. NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS.....	28
8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL.....	29
8.1. SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETËVE.....	29

8.2. ASETET E LËSHUARA ME QIRA.....	30
8.3. TRAJTIMI I ASETETEVE TË UZURPUARA.....	32
9. DEPARTAMENTI LIGJOR.....	33
9.1. MASAT E PËRKOHSHME NGA DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME.....	33
10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT.....	33
10.1. NJËSIA E MARKETINGUT DHE MARRËDHËNIEVE ME INVESTITORË.....	33
10.2. NJËSIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN.....	34
11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE.....	35
11.1. PAGAT.....	35
11.2. REKRUTIMET DHE LËVIZJET E STAFIT.....	35
12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS.....	36
13. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT.....	37
13.1. FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së.....	37
13.2. PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE.....	38
14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT.....	39
15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE.....	39
15.1. KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË PRONËSI SHOQËRORE.....	39
15.2. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ASETETEVE ME KARAKTER SPECIFIK	39
15.3. KOMISIONI PËR CAKTIMIN E STATUSIT TË NDËRMARRJEVE – KPS.....	40
15.4. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE.....	40
15.5. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NDAJ LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE.....	41
16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	42
17. REKOMANDIMET PËRMBLEDHËSE PËR TË ARDHMEN.....	42
18. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT	43
19. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....	44
20. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së.....	45

PARATHËNIE

Viti 2017 ishte viti më i suksesshëm i Agjencisë Kosovare të Privatizimit që nga ekzistenca e saj, përfshirë edhe periudhën para shpalljes së pavarësisë së vendit. Rezultatet janë mbresëlënëse në thuajse të gjitha proceset që mbulon Agjencia. Mbi 200 asete të ndërmarrjeve shoqërore janë shitur, që përbëjnë 14% të numrit të përgjithshëm të shitjeve që nga shitja e parë e realizuar në vitin 2003. Për këto asete ofertuan mbi 1,800 ofertues duke zotuar mbi €50 milion. Kjo konkurrencë e rritur bëri që çmimet e asteve të shënojnë rritje të konsiderueshme. Në anën tjetër, procesi i likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore gjithashtu tejkaloi rezultatet e viteve të kaluara. U likuiduan një sosh ndërmarrje shoqërore. Gati në terësi u shqyrtuan kërkesat kreditore në procesin e likuidimit. Gjatë vitit u realizuan mbi €8 milion pagesa për kreditorët e 41 ndërmarrjeve shoqërore. Sa u përket proceseve të tjera në Agjenci, qiratë shënuan rritje prej 25% nga viti paraprak, e 33% nga viti 2015. Pagesat e 20-përqindëshit ishin mbi €9 milion, nga të cilat përfituan mbi 10,000 punëtorë. Një numër asetesh u identifikuan, ndërsa u liruan gati në terësi asetet e uzurpuara. Transparenca u rrit!

Agjencia punoi fort edhe në avancimin e legjislacionit bazë dhe atij dytësor. Ligji për Agjencinë, që pritet të aprovohet nga Kuvendi i Kosovës në fillim të vitit 2018, përveç që do të avansojë shumë procese, do t'i hapë rrugë zhbllokimit të fondeve të privatizimit, kërkesë kjo e kahmotshme.

Në rrafshin e përgjegjësisë sociale, gjatë vitit 2017 Agjencisë iu bashkuan 9 kolegë me nevoja të veçanta. U treguan shumë të zellshëm! Të gjithë u jemi mirënjohës për punën e pashoq.

Të gjitha këto arritje u reflektuan edhe në perceptimin e publikut dhe investorëve karshi Agjencisë. Matjet e opinionit publik tregojnë për rritje të besueshmërisë në punën e Agjencisë.

Këto rezultate janë produkt i bashkëpunimit të shëndoshë me shumë institucione dhe aktorë të tjerë të jetës publike. U jemi mirënjohës të gjithëve!

Përkundër këtyre rezultateve, ne jemi të vetëdijshëm për punët dhe sfidat e shumta që na presin në 2018. Zotimi i Agjencisë është të vazhdojë me energjinë dhe zellin e njëjtë edhe në këtë vit. Ndërsa, institucioneve qëndrore iu mbetet të na e sigurojnë pavarësinë funksionale si mekanizëm i vetëm në vend i ngarkuar me administrimin e pronave shoqërore në Kosovë.

Sinqerisht,

Petrit Gashi

Kryesues dhe Drejtor

Bordi i Drejtorëve

PËR VËMENDJEN E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS:

Raporti vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit i plotëson kërkesat ligjore për raportim sipas nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

Raporti është miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së dhe dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform nenit 20.1 të ligjit të AKP-së.

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë kapitull është paraqitur një përmbledhje e shkurtër për periudhën deri më 31 Dhjetor 2017 lidhur me këto fusha:

- Të arriturat kryesore;
- Administrimi dhe Shitja e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Pagesat për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore (20%);
- Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Trepça;
- Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së;
- Përmbledhje lidhur me financat.

1.1. TË ARRITURAT KRYESORE

- Pas një periudhe pothuajse dyvjeçare është filluar me shitjet e aseteve. Strategjia është shumë sfiduese nëpërmjet të cilës është planifikuar që të realizohen shitjet në cikle mujore;
- Aprovimi i raporteve për shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve për 41 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, pagesat e realizuara deri më 31 Dhjetor 2017 janë gjithsej EUR 8,105,856 (duke përfshirë pagesa e ekzekutuara për vendimet e vitit 2016 në shumën prej EUR 1,537,403);
- Shpërndarja e 20% për punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore EUR 9,283,737 për 10,231 punëtorë;
- Rritja e efikasitetit në administrimin, kontrollimin dhe monitorimin e NSh-ve, Spin-Off-et speciale dhe privatizimeve me kushte;
- Trajtimi i aseteve të uzurpuara apo të shfrytëzuara pa bazë ligjore nga palët e treta;
- Rritja e jashtëzakonshme e inkasimit të qirasë prej 6.00% në krahasim me vitin 2016 dhe 36% në krahasim me vitin 2015. Vetëm për periudhën Janar – Dhjetor 2017 janë inkasuar prej EUR 6,528,207;
- Bashkëpunimi me institucionet në nivel qendror dhe lokal.

1.2. SFIDAT DHE PENGESAT

Sa i përket sfidave dhe pengesave, më poshtë kemi paraqitur faktorët e jashtëm të cilat kanë një rol kyç në administrimin më të mirë të aseteve, shitjen, likuidimin e tyre, dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative. Faktorët që kanë ndikuar dhe do të ndikojnë në periudhat pasuese janë paraqitur si më poshtë:

- **Kuvendi i Kosovës** - Luan një rol kyç në proceset e AKP-së.
 - Kuvendi i Kosovës emëron anëtarët e Bordit të AKP-së. Mandati i anëtarëve të Bordit përfundon në Dhjetor 2017, përveç Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit që kanë mandat deri në Dhjetor 2018. Çdo vonesë e mundshme në emërimin e anëtarëve të Bordit do të shkaktoj vonesa në procesin e shitjes, shpërndarjen e 20% të punëtorëve dhe procesin e likuidimit të NSh-ve;
 - Trajtimin e tokave bujqësore apo strategji që trajtojnë asetet në interes të Republikës së Kosovës;
 - Amandamentimin/ndryshimin sa i përket financimit të aktiviteteve të AKP-së. AKP për buxhetin e vitit 2018 nga gjysmë vjetori i dytë e tutje nuk do të ketë mjete në dispozicion për mbulim të shpenzimeve për zhvillim e aktiviteteve operative me normën 5% sipas nenit 21 të ligjit të AKP-së.
- **Gjykatat** - Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe Gjykatat Themelore kanë kapacitete të limituara sa i përket shqyrtimit të lëndëve për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Varësisht nga kompleksiteti i rasteve, shqyrtimi dhe vendimi përfundimtar mund të merr shumë kohë (vite). P.sh. Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ka caktuar Masë të Përkohshme ndaj një aseti i cili ka qenë në valën 37 në vitin 2009. Nga viti 2009, kontesti gjyqësor ende nuk është zgjidhur. Të gjitha proceset (administrimi, shitja dhe likuidimi) lidhen me Gjykatat. Janë mbi 30,000 raste gjyqësore që duhet trajtuar në instanca të ndryshme, prej të cilave rreth 23,000 janë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ndërsa rreth 7,000 janë në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës;
- **Komunat** – faktorë relevant në përsheptimin e kohës dhe përgatitjes të aseteve për shitje. P.sh. vonesa në qasjen e dokumenteve kadastrale ose komuna në mënyrë të njëanshme, në emër të saj, ka ndërruar titullarin e pronësisë;

- **Komunat në pjesën veriore të Republikës së Kosovës** - ekziston një numër i konsiderueshëm i aseteve në këtë pjesë, për të cilat ka mungesë të bashkëpunimit me këto komuna, që mund të krijojnë vonesa në realizimin e shitjeve të aseteve;
- **ATK-ja** - Vonesa në dhënien e informacioneve për barrën tatimore dhe vonesa në heqjen e barrës tatimore. Gjithsesi është rritur bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve;
- **Qeveria** - Pagesa e pronave të shpronësuara nga ana e Qeverisë. Janë 1017 asete të cilat janë shpronësuar dhe për të cilat duhet paguar mjetet nga ana e Qeverisë;
- **Qiratë nga Qeveria dhe institucionet relevante** - pronat e shfrytëzuara me qira të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. P.sh. nga përvoja e AKP-së, ka dy vite që institucionet ende nuk kanë bërë ndonjë zgjidhje për zhvendosjen e zyrave të AKP-së. Janë gjithsej 90 asete, të cilat shfrytëzohen nga Qeveria dhe institucionet ndërkombëtare;
- **Ndërtimet joligjore dhe uzurpatorët** - Janë përafërsisht të njohura deri më tani rreth 2,500 raste. Veçanërisht lidhen edhe me Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (shih më lartë);
- **Ofertat e blerësve** – Mund të ketë asete të cilat nuk janë atraktive për tërheqjen e investitorëve/ blerësve, faktor ky i cili ndikon në ri-tenderimin e aseteve për shitje për shkak të mungesës së ofertave;
- **Tjera** – mungesë e dokumentacionit në përcaktimit të statusit të NSH-ve dhe trajtimit të shitjeve të aseteve të tyre.

Të gjithë këta faktorë të shënuar më lartë, ndër vite kanë qenë dhe janë ende sfida dhe pengesa lidhur me procesin e privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore. Gjithsesi, këto sfida vit pas viti janë bërë më të lehta, kjo për shkak të ngritjes të kapaciteteve ndër institucionale, por ka shumë punë për të bërë në nivel qendror dhe lokal, sidomos në shqyrtimin e lëndëve nga Dhoma e Posaçme e Kosovës dhe komunave, të cilat janë faktorë kyç në përshpejtimin e proceseve.

2. KORNIZA LIGJORE

1. Ligji i AKP-së nr. 04/L-034 dhe ndryshuar me Ligjin nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015;
2. Akti themelues i AKP-së;
3. Statuti i Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
4. Politikat Operacionale të AKP-së dhe Anekset e saj;

- 4.1. Rregullat e tenderit në privatizim;
- 4.2. Rregullat e tenderit në likuidim;
- 4.3. Rregullat e Procedurës të Komisionit për shqyrtim të ankesave ndaj listave të punëtorëve.
5. Procedurat Financiare të AKP-së;
6. Udhëzuesi i Likuidimit me Anekset e tij:
 - 6.1. Lista me Format/Formularët për Likuidim;
 - 6.2. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave të Caktuara të Punës (marrëdhënia e punës);
 - 6.3. Udhëzuesi për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore (të NSH-së) gjate periudhës së transformimit;
 - 6.4. Aneks i Udhëzuesit të Likuidimit për Procedimin e Kërkesave Kolektive në procedurën e likuidimit.
7. Rregullorja për kompensimin e anëtarëve të Bordit;
8. Udhëzuesi për Procedurën e shpërndarjes së të hyrave nga 20%;
9. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore;
10. Udhëzuesi mbi procedurat e prokurimit për përdorim nga Ndërmarrjet Shoqërore në likuidim;
11. Procedurat e brendshme të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
12. Procedurat Bankare të AKP-së;
13. Rregullorja Nr. 01/2012 mbi Ruajtjen e Integritetit të AKP-së;
14. Rregullorja për përdorimin të vulave zyrtare të Agjencisë dhe Autorizimit për lejimin e përdorimit të vulave zyrtare të Agjencisë nga Autoriteti i Likuidimit;
15. Statuti Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB);
16. Rregullorja për përcaktimin e mënyrave të kompensimit për menaxherët si dhe punëtorët tjerë të NSH-ve nën mandatin e Njesisë së Administrimit Direkt;
17. Rregullorja për procedurën e rekrutimit të Drejtorit Menaxhues, dy Zëvendës Drejtorëve Menaxhues dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve;
18. Rregullorja për Zhvillimin e punonjësve dhe ngritje të kapaciteteve;
19. Rregullorja për procedurat dhe masat e nevojshme

për sigurinë e personave që hyjnë dhe dalin në AKP;	41. Rregullorja për monitorim të Trepçës;
20. Rregullorja e brendshme e Agjencisë për Vlerësim të Performancës së Menaxhmentit;	42. Procedurat e Shitjes dhe Rregullat e Përgjithshme të Tenderit.
21. Politikat mbi pagesën e pjesshme për punëtorët;	2.1. RREGULLORET DHE PROCEDURAT E APROVUARA GJATË VITIT 2017 NGA AGJENCIA
22. Udhëzuesi i prokurimit për ndërmarrjen Trepça nën Administrimin e AKP-së;	Rregulloret dhe procedurat e aprovuara gjatë periudhës raportuese janë:
23. Rregullorja e Shitjes së Ndërmarrjes Trepça në Administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;	1. Rregulloret dhe procedurat e aprovuara gjatë periudhës raportuese janë: Rregullore e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit – 30 Janar/14 Shkurt 2017.
24. Rregullorja e Pagave për nëpunësit e Agjencisë;	2. Rregullorja për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim të informacionit - 14 Shkurt 2017.
25. Rregullorja e Personelit për nëpunësit e Agjencisë;	3. Udhëzuesi për zyrtarët e rastit lidhur me Pagesat e faturave për tatimin në pronë nga data e fillimit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim – 30/31 Mars 2017.
26. Rregullorja e Përdorimit të Veturave zyrtare të Agjencisë;	4. Udhëzimi Administrativ për Inicimin dhe Pagesat nga Buxheti i AKP-së - 30/31 Mars 2017.
27. Rregullat e Procedurës për Shitjen e Banesave të NSH-ve;	5. Rregullore për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik dhe shitja e tyre me negociim të drejtpërdrejtë – 27 Prill 2017
28. Rregullat e Punës të Komisionit për ndërtimeve jo ligjore në pronat e ndërmarrjeve shoqërore;	6. Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci - 01 Qershor 2017.
29. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore;	7. Ndryshimi/plotësimi i Aktit Themelues të AKP-së – 30 Qershor 2017.
30. Rregullorja për qiradhënien e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore në likuidim;	8. Udhëzuesi për Menaxhimin dhe Funkcionimin e Linjës së Posaçme Telefonike – 13/17 Korrik 2017.
31. Rregullat e Procedurës së Komisionit për shqyrtimin e listave fillestare të punëtorëve (KShLFP);	9. Plotësim ndryshimi i procedurave të shitjes dhe rregullave të tenderit – 21/22 Gusht 2017.
32. Vendimi për lirim të aseteve të uzurpuara të NSH-ve dhe Udhëzuesi për lirim të aseteve nga uzurpatorët;	10. Strategjia për media – 21/22 Gusht 2017.
33. Rregullorja për Procedurat e Njesisë së Kontrollit dhe Mbikëqyrjes gjatë Monitorimit të Ndërmarrjeve të Privatizuara me Spin Off Special dhe me Kushte;	11. Amadamentimi i Rregullave të Tenderit - 21/25 Shtator 2017.
34. Rregullorja mbi Procedurat e trajtimit të llogarive të arkëtueshme;	12. Plotësim/ndryshimi i paragrafit 10.2.2. të nenit 10 të Rregullores për Zhvillimin e Punonjësve dhe Ngritje të Kapaciteteve – 30 Tetor/01 Nëntor 2017.
35. Udhëzuesi për Menaxhimin e Performancës së Personelit;	13. Plotësim/ndryshimi i Rregullave të procedurës së punës” se Komisionit për Shqyrtimin e Listave fillestare të Punëtorëve (KShLFP) – 30 Tetor/01 Nëntor 2017.
36. Udhëzuesi për Teknologjinë Informativë;	14. Plotësim/ndryshimi i Rregullores për Pagat e nëpunësve në Agjencinë Kosovare të Privatizimit – 30 Nëntor dhe 01-06 Dhjetor 2017.
37. Statuti i Komitetit të Auditimit;	
38. Rregullorja e punës së Njesisë së Administrimit Direkt;	
39. Rregullorja e re e Qiradhënies së aseteve të NSH-ve;	
40. Udhëzuesi për Lirim të Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore nga Uzurpuesit e Paligjshëm;	

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

3.1. MISIONI DHE VIZIONI

3.1.1. MISIONI

Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Për realizimin e këtij misioni, Agjencia mban dhe administron secilën ndërmarrje (nën mandatin e saj) në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, si dhe shet ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me ligjin.

3.1.2. VIZIONI

Agjencia është e vendosur për të trajtuar me shpejtësi ndikimet pozitive për ekonominë si dhe nxitjen e investimeve në Ndërmarrjet Shoqërore, përmes autorizimeve të gjera publike administrative që i ka mbi këto ndërmarrje dhe asetë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose asetëve tek investitorët privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa.

3.2. KOMPETENCAT E AGJENCISË SIPAS LIGJIT

Agjencia Kosovare e Privatizimit është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me Ligjin nr. 04/L-034, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar nga Kuvendi i Kosovës në Korrik të vitit 2008 si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit”, dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë asetë dhe përgjegjësi të Agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit i raporton Kuvendit të Kosovës në baza vjetore.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të Agjencisë janë menaxhuar nga Drejtori Menaxhues, Zëvendës Drejtori Menaxhues-Shitje dhe Zëvendës Drejtori Menaxhues-Likuidim.

Brenda Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë edhe departamentet si në vijim:

- Departamenti i Shitjes;
- Departamenti i Likuidimit;
- Departamenti i Koordinimit Rajonal;
- Departamenti Ligjor;
- Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët;
- Departamenti i Burimeve Njerëzore;
- Departamenti i Administratës;
- Departamenti i Financave dhe Buxhetit;
- Departamenti i Prokurimit; dhe
- Departamenti i Komisioneve Profesionale.

4. FUSHËVEPRIMI QË MBULON AGJENCIA

Ndërmarrjet Shoqërore kanë funksionuar në sektorë të ndryshëm duke përfshirë përpunimin e metalit, plastikës, letrës, hotelieri, miniera, agro-industri, bujqësi, pylltari, material ndërtimor, ndërtimtari, tekstil, verari dhe vreshtari, prodhimin e birrës, duhanit, shitjen me shumicë dhe pakicë.

NSh-të zënë rreth 90% të industrisë dhe minierave në Kosovës, 50% të hapësirës për shitje komerciale me pakicë dhe më pak se 20% të tokës bujqësore duke përfshirë tërë tokën komerciale bujqësore dhe shumicën e pjesës malore të Kosovës.

Shumica e pronës industriale e Kosovës, toka bujqësore, pyje, tokë urbane komerciale dhe pronë komerciale janë pronë e NSh-së. Privatizimi i këtyre asetëve dhe tërheqja e investitorëve të huaj si dhe atyre nga diaspora, rajoni dhe Kosova pritet që të kenë ndikim pozitiv në ekonominë dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

AKP-ja deri në datën raportuese ka menaxhuar me 576 Ndërmarrje Shoqërore. Ndërsa, në periudha të ndryshme janë larguar gjithsej 36 Ndërmarrje nga mandati i AKP-së me vendim të Bordit të Drejtorëve. Ndërmarrjet që nuk janë në kompetencën e AKP-së janë si më poshtë:

PËRSHKRIMI	NUMRI
Trepça	20
Ekonomitë Pyjore	13
Kosovatransat	13
NSH-të që janë hequr me vendime të Bordit	36
GJITHSEJ:	92

4.1. BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej¹ funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas ligjit. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve të cilët janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i Bordit të Drejtorëve është dyvjeçar për anëtarët e Bordit (deri në Dhjetor 2017), ndërsa për Kryesuesin dhe Zëvendës Kryesuesin është trevjeçar (deri në Dhjetor 2018).

Gjatë vitit 2017, deri në fund të shtatorit të këtij viti, Bordi ka mbajtur 17 mbledhje, ku janë marrë gjithsej 234 vendime formale dhe shumë udhëzime për veprim për Menaxhmentin. Në vijim, në mënyrë përmbledhëse janë të paraqitura aktivitetet e Bordit për këtë periudhë:

- Janë aprovuar shitjet nga valë të shitjeve të aseteve në likuidim
- Janë shpallur valë të shitjes së aseteve (SHAL30-SHAL38) për shitje përmes tenderit publik;
- Janë vendosur në procedurë likuidimi Ndërmarrje Shoqërore me qëllim të përmbylljes sa më të shpejtë të tyre;
- Janë bërë shpërndarjet e përkohshme për kreditorët e Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Janë bërë shpërndarjet për ish punëtorët e Ndërmarrjeve Shoqërore nga 20% i shitjeve;
- Janë aprovuar raporte të Komisionit për shitjen e banesave në pronësi shoqërore;
- Janë aprovuar raporte të Komisionit për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik;
- Janë aprovuar qiradhënie të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat janë në likuidim, dhe atyre që ende nuk janë në procedurë likuidimi;
- Janë aprovuar dhe/ose amendamentuar akte nënligjore të Agjencisë, si: Rregullore e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, Rregullorja për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim të informacionit, Rregullore për shqyrtimin e aseteve me karakter specifik dhe shitja e tyre me negociim të drejtpërdrejtë, Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, Amendamenti i

Aktit Themelues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Udhëzuesi për menaxhimin dhe funksionimin e linjës së posaçme telefonike, Amendamenti i Procedurave të Shitjes dhe Rregullave të Përgjithshme të Tenderit, si dhe udhëzues tjerë të brendshëm;


- Sa i përket Trepçës, Agjencia ka finalizuar projektin e Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me orientim strategjik, ka angazhuar ekspertizë të jashtme lidhur me analizimin e të njëjtit studim, dhe të gjitha këto raporte, në pako ia ka dorëzuar Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës;
- Janë aprovuar raporte për përcaktimin e statusit të Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Janë liruar nga kushtet e marrëveshjes së zotimit disa ndërmarrje e privatizuar me kushte;
- Është aprovuar buxheti dhe plani vjetor për vitin 2018 si dhe raporte tjera që u përcillen institucioneve qendrore sipas ligjit në fuqi.

5. DEPARTAMENTI I SHITJES

Në përputhje me objektivat e paraqitura në raportin e planit të punës për vitin 2017, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka arritur t'i përmbush ato me një sukses të madh duke filluar me përshpejtimin dhe përmirësimin e procesit të shitjes. Viti 2017 ishte vit i rekordeve sa i përket shitjeve të Agjencisë prej se ekziston, si në numrin e shitjeve gjatë një viti, numrin e aseteve të ofruara për shitje gjatë një viti, numrin e ofertave të pranuar, numrin e ofertave për një ditë të shitjes, numrin e kontratave të realizuara brenda një viti, e po ashtu edhe për shumatat e inkasuara nga shitjet.

Nëpërmjet grafikoneve të mëposhtëm është paraqitur numri i aseteve të tenderuar sipas periudhave mujore. Grafiku i mëposhtëm paraqet rezultatet sipas prerjes së periudhës 31 dhjetor 2017. Këto rezultate mund të ndryshojnë në periudhat pasuese, pasi që mund të ketë tërheqje apo anulim të tenderit nga Bordi i Drejtorëve apo faktorë të tjerë që janë jashtë administrimit të AKP-së.

¹ Përbërja, procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e Bordit të Drejtorëve janë të paraqitura në nenin 14 dhe 15 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe nenin 12 të Ligjit nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034.



1,855 oferta.
 Vlera e ofertave të pranuar nga AKP-ja në total është EUR 50,915,416.
 209 kontrata janë nënshkruar si dhe 119 janë në proces.

Vala 27 - Dhjetor 2016	Vala 28 - Janar 2017	Vala 29 - shkurt 2017	Vala 30 - Mars 2017
Vala 31 - Prill 2017	Vala 32 - Maj 2017	Vala 33 - Qershor 2017	Vala 34 - Korrik 2017
Vala 35 - Shtator 2017	Vala 36 - Tetor 2017	Vala 37 - Nëntor 2017	Vala 38 - Dhjetor 2017

Duhet theksuar se dita e shitjes për Valën 27 është mbajtur në dhjetor 2016, por të gjitha procedurat tjera për këtë shitje janë zhvilluar në vitin 2017.

Vlen të theksohet se, po këtë vit kemi realizuar valën më të suksesshme të privatizimit që nga fillimi i këtij procesi. Në Shitjen e Aseteve me Likuidim nr. 38, për 120 asete të tenderuar kemi pranuar numër rekord të ofertave, 371 oferta dhe me vlerën e ofertave mbi 13.5 milionë euro.

Gjithashtu, sipas planit vjetor 2017 ishte aprovuar edhe shitja alternative 38A dhe të gjitha procedurat


dhe përgatitjet për realizimin e shitjes ishin kryer, por shitja u pezullua për të respektuar vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për pezullimin e përkohshëm të shitjes së tokave bujqësore.

Sukses kemi shënuar edhe në përpunimin dhe procesimin e kontratave të shitjes. Vetëm këtë vit të blerësit i kemi dorëzuar 209 kontrata të privatizimit, që paraqet vitin më të suksesshëm deri më tani për sa i përket finalizimit të kontratave me blerësit. Numri më i madh i kontratave të dorëzuara ishte në vitin 2012, kur ishin dorëzuar te blerësit 162 kontrata të shitjes.

Gjithashtu, gjatë vitit 2017 është realizuar nënshkrimi i dy kontratave për shitjet, për të cilat ka pasur masë të përkohshme nga DHPGJS, ato janë: Ndërmarrja e Re “KB Shtime - Zyra Administrative SH.P.K.” në Shtime, kjo shitje ka qenë e tenderuar në vitin 2010 përmes metodës të Spinof-it të rregullt në valën 42 të shitjes, dhe Ndërmarrja e Re “Jugobanka Zyra në Skënderaj shpk”, kjo shitje ka qenë e tenderuar në vitin 2013 përmes metodës të Spinof-it të rregullt në valën 58 të

shitjes. Në anën tjetër, vlen të theksohet se vetëm për vitin 2017, janë tenderuar për shitje 438 asete apo 23% e totalit të aseteve të të identifikuar për shitje prej 2,243.

Gjithsesi, nëpërmjet grafikonit të mëposhtëm është paraqitur procesi në tërësi i identifikimit dhe shitjes të aseteve nga viti 2003 deri më 31 dhjetor 2017.



Ashtu siç është paraqitur më lartë, AKP-ja ka arritur që të implementoj strategjinë për shpalljen e shitjeve të aseteve në periudha mujore dhe njëkohësisht që të realizohen shitjet (nënshkrimi i kontratave).

Gjithashtu, një ndër objektivat kryesore të AKP-së është rritja dhe ruajtja e vlerës të aseteve të NSH-ve dhe se AKP-ja do të ruaj raportin e realizimit të shitjeve me vlerën e synuar. Pra, strategjia është sfiduese e cila kërkon ruajtjen e këtij balanci dhe e cila kryesisht varet nga faktorët e jashtëm dhe situatat e mëposhtëm:

- Fuqia blerëse – absorbimin e ofertave kundrejt vëllimit të shitjeve;
- Menaxhimin efikas dhe efektiv të aseteve – p.sh. afatet kohore të marrëveshjeve të qirave dhe vënia në dispozicion për shitje tek blerësit;
- Koordinim me institucionet relevante të tilla si: objektet e shfrytëzuara nga institucionet, ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, komunitat, bashkëpunimi me ATK-në rreth barrës tatimore etj;
- Lirimin e aseteve nga uzurpatorët;
- Trajtimin e ndërtimeve ilegale të aseteve të NSH-ve;
- Kompletimin e dokumentacionit (regjistrave kadastral);

6. NJËSIA E MONITORIMIT, KONTROLLËS DHE ADMINISTRIMIT DIREKT

6.1. SPIN OFF-ET SPECIALE

Që nga fillimi i procesit të privatizimit e deri më tani janë privatizuar 26 ndërmarrje përmes metodës së “Spin Off-it Special”. Nga këto ndërmarrje 20 janë liruar nga marrëveshja e zotimeve, 4 ndërmarrje për shkak të mospërbushjes së zotimeve për investime dhe punësim me vendim të Bordit të AKP-së iu janë marrë aksionet kurse dy ndërmarrje të privatizuara me metodën e “Spin Off-ve Speciale” janë monitoruar nga Njësia për Kontrollë e Mbikëqyrje gjatë periudhës e këto janë “IDGJ Tobacco” -

Gjilan dhe “NBI Suhareka” (Agrokosova Holding) - Suharekë. Për këto dy Ndërmarrje të Reja, më poshtë janë shpalosur aktivitetet në mënyrë detaje. Për të gjitha Ndërmarrjet e Reja të shitura me “Spin Off Special” janë paraqitur vlera e shitjes, vlera e investimeve, numri i të punësuarve dhe përbushja/mospërbushja e zotimeve të bëra.

TABELA E NDËRMARRJEVE TË REJA TË SHITURA SIPAS MENYRËS ME "SPIN OFF SPECIAL"

Nr.	Emri i Ndërmarrjes	Data e nënshkrimit	Vlera e Zotuar për Investime	Vlera e Raportuar e Investimeve	Investimet e rap. të pa audituara	Totali	Nr. Punëtorëve të zotuar	Nr. Punëtorëve të raportuar
1	Perparimi	23/03/2005	2,000,000.00	2,001,530.75		2,001,530.75	150	154
2	SunflowerOil	26/06/2006	0.00	0.00		0.00	169	169
	Released from KTA	Sub total	2,000,000.00	2,001,530.75		2,001,530.75	319	323
3	Lamkos Steel LLC	21/07/2005	15,000,000.00	1,666,264.86		1,666,264.86	500	500
4	Xim Strezovci (XIM)	13/12/2007	14,300,000.00	138,073.41		138,073.41	238	11
5	Grand Hotel	13/10/2006	20,200,000.00	1,987,060.15		1,987,060.15	540	540
6	Magnezite Mine Goleshi LLC (MIM)	11/12/2007	16,200,000.00	326,978.00		326,978.00	355	58
	Call Option from PAK on 14 of August 2009	Sub total	65,700,000.00	4,118,376.42		4,118,376.42	1,633	1,109
7	Banja e Klokotit	24/11/2005	3,100,000.00	3,252,000.84		3,252,000.84	201	201
8	Peja Brewery	29/06/2006	15,206,000.00	15,234,098.28		15,234,098.28	612	612
9	IMN Brick Factory	28/07/2006	0.00	0.00		0.00	666	667
10	Feronikeli		20,000,000.00	59,677,464.00		59,677,464.00	1,000	1,043
11	Rahoveci Winery	31/07/2006	5,000,000.00	4,772,692.00		4,772,692.00	250	252
12	Balkan L.L.C	21/07/2005	6,000,000.00	6,115,784.03		6,115,784.03	375	375
13	7 Korriku	11/06/2006	n/a	n/a		#VALUE!	n/a	n/a
14	Mulliri Fabrika e Bukes	28/04/2008	5,000,000.00	5,554,287.97		5,554,287.97	80	83
15	Tullorja Kamenice	04/06/2008	n/a	n/a			81	84
16	IMK Pipe Factory	20/11/2007	13,200,000.00	13,400,316.04		13,400,316.04	360	365
17	Shpk"M&SILLOSI"	11/05/2005	19,887,564.00	19,328,797.00		19,328,797.00	358	370
18	Modeli	13/04/2007	2,200,000.00	2,224,142.44		2,224,142.44	170	171
19	FlourMill Fushe Kosova	10/07/2007	15,000,000.00	14,362,698.00		14,362,698.00	260	260
20	KosovaTex	31/08/2006	4,000,000.00	4,341,099.68		4,341,099.68	200	260
21	FAN	23/03/2006	2,800,000.00	1,789,565.31		1,789,565.31	236	236
22	Hotel Iliria	31/07/2006	3,000,000.00	5,761,196.56		5,761,196.56	250	256
23	Minex	12/07/2010	n/a	n/a			145	145
24	Jugoterm	17/04/2012	2,760,000	2,478,860.22		2,478,860.22	282	282
25	IDGJ Tabacco	14/08/2006	5,057,876.00	5,152,516.70		5,152,516.70	90	81
	Released from PAK	Sub total	122,211,440.00	163,445,519.07		163,445,519.07	5,616	5,743
26	NBI Suhareka/Agrokosova Holding	27/08/2007	8,600,000.00	7,045,713.00	3,278,833.00	10,324,546.00	345	76
	Active SSO's	Sub Total	8,600,000.00	7,045,713.00	3,278,833.00	10,324,546.00	345	76
		Total	198,511,440.00	176,611,139.24	3,278,833.00	179,889,972.24	7,913	7,251

Ndërmarrja e Re “Agrokosova Holding” Suharekë

Janë zhvilluar disa vizita monitoruese ku ndërmarrja është duke zhvilluar aktivitetin në prodhimin verës nga rrushi që kanë pasur në dispozicion për prodhim. Sipas blerësit ata janë duke punuar në marketing për plasim të produktit dhe se kanë siguruar disa kontrata për shitje të verës në Itali dhe në Zvicër.

Numri i punëtorëve të angazhuar në ndërmarrje varion nga 20 në sezonin e dimrit deri në 90 në periudhën kur fillojnë aktivitetet në teren. Punimet në terren janë realizuar duke hapur hapësira të reja ku janë mbjellur me grurë, misër, fasule, domate të varieteteve të ndryshme, specja, qersh, pjeshkë, dardhë, shalqi dhe pjesa më e madhe këtyre terreneve është mbjellur me hardhi të re të rrushit.

NJKM nga Komuna e Suharekës, Departamenti i Kadastrit ka siguruar listën poseduese të Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding”. Në krahasimin e bërë në mes të kësaj liste dhe listës e cila figuron në kontratën e shitblerjes së kësaj ndërmarrje del se nuk ka asnjë ndryshim apo transfer të pronave.

Gjithashtu, kemi pranuar informata edhe nga Gjykata Themelore e Prishtinës në lidhje me çështjen në mes të aksionarëve të Agrokosova Holding. Ata na kanë njoftuar se lënda është në ekspertizë ku janë angazhuar ekspertë të vreshtarisë, ndërtimtarisë dhe makinerisë.

Nga Banka Ekonomike kemi marrë përgjigjen në shkresën e datës 20/04/2017 ku kemi kërkuar informata mbi kolateralin që ka lënë njëri aksionar i Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding”. Sipas përgjigjes së tyre kolateral në formë të pengut është lënë vetëm parcela me numër 2681/1 me numër të marrëveshjes 429/Pr dhe datë 22.03.2010, dhe kjo sipas tyre ka qenë më herët një praktik e aplikuar nga Bankat dhe se tani banka nuk ka asnjë pretendim ndaj kësaj prone.

Janë dërguar përgjigjet në shkresat e “Grupoo Vinicolo Fantinel” si aksionar i Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding” si dhe në shkresën e Shpresa Berisha Rexhepi – avokate si përfaqësuese e aksionarit tjetër “QMI”. Gjithashtu nga “QMI” si aksionar i “Agrokosova Holding” kemi pranuar një shkresë drejtuar Bordit të Drejtorëve ku kërkon që të bëhet një auditim nga fillimi i periudhës së zotimeve apo nga viti 2012 deri më tani dhe pastaj të merret vendim për lirim, ngase ai pretendon se ata kanë përmbushur marrëveshjen e zotimeve.

Kemi mbajtur një takim me zyrtarë të hetuesisë nga Policia e Kosovës, ku na kanë informuar në lidhje me vendosjen peng të disa parcelave të Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding” nga aksionari “QMI” tek Banka Ekonomike. Më vonë nga ta kemi pranuar edhe disa dokumente lidhur me pengun dhe shitjen e disa materialeve të inoksit.

Është bërë verifikimi i aseteve të transferuara në

kontratën e shitjes të Ndërmarrjes së Re “Agrokosova Holding”, Suharekë. Nga komisioni janë verifikuar asetet e ndërmarrjes të transferuara sipas listës, e cila është e përfshirë në kontratën e shitjes ku shihet se ka një numër mjaft të madh të aseteve që mungojnë.

Së bashku me disa anëtar të Bordit të Drejtorëve dhe Zëvendës Drejtoreshën Menaxhuese–Shitja të AKP-së është zhvilluar një vizitë tek kjo ndërmarrje në mënyrë që edhe menaxhmenti dhe Bordi të shohin nga afër gjendjen në ndërmarrje. Aksionari “QMI” njoftoi pjesëmarrësit mbi aktivitetet që janë duke u zhvilluar në ndërmarrje gjatë kësaj periudhe dhe disa aktivitete shtesë që do të bëhen në të ardhmen.

Nga blerësi kemi pranuar raportin e investimeve të bëra për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.08.2017 ku blerësi ka raportuar investime prej 1,473,333.00 Euro, gjithashtu blerësi ka dorëzuar edhe një raport për investime për periudhën 01.09.2017 deri më 30.11.2017 ku vlera e investimeve të raportuara është 392,503.00 euro. Sipas raportit të pranuar numri mesatar i të punësuarve është 108 por këto raportime të blerësit janë të pa audituara.

Menaxhmenti ka përgatitur Memo për Bordin e Drejtorëve i cili në mbledhjen e mbajtur më 14 dhe 15 dhjetor ka aprovuar kërkesën e blerësit që të bëhet zgjatja e periudhës së zotimeve për 4 muaj për periudhën 01.01.2015 deri më 30.04.2015 dhe për këtë periudhë të bëhet auditimi i përmbushjes së zotimeve për investime kapitale dhe punësim.

Ndërmarrja e Re “IDGJ Tobacco” Gjilan

Janë realizuar disa vizita monitoruese në Ndërmarrjen e Re “IDGJ Tobacco”, për të parë gjendjen aktuale në ndërmarrje. Nga raportimet e blerësit shihet se ata kanë paguar paga për rreth 91 punëtorë, por gjatë vizitave në ndërmarrje kryesisht shihet se ky numër sillet nga 20 deri 30 që kanë qenë prezent në ndërmarrje.

Një vizitë në ndërmarrje është bërë edhe së bashku me disa anëtar të Bordit të Drejtorëve të AKP-së dhe menaxhmentin për të parë nga afër aktivitetet që janë duke u zhvilluar në ndërmarrje. Përfaqësuesi i blerësit informoi mbi investimet që janë bërë deri më tani në këtë ndërmarrje, mbi punësimin dhe vështirësitë që kanë pasur për fillimin e aktivitetit prodhues për shkak se marrja e licencave ka marrë shumë kohë deri kah fundi i vitit 2016. Sipas tij, ata kanë përmbushur zotimet për investime dhe punësim dhe janë duke u angazhuar që të rifillojnë prodhimin, ngase sipas përfaqësuesit të blerësit ata përveç muajit shtator dhe tetor nuk kanë zhvilluar prodhim më tej ngase ende nuk kanë gjetur plasman për prodhimet e tyre dhe se janë në komunikim me disa blerës kryesisht nga Azia për shitjen e prodhimeve të tyre dhe deri më tani theksoi se kanë disa para-kontrata të nënshkruara por ende nuk kanë ndonjë

marrëveshje konkrete për fillimin e prodhimit. Përfaqësuesit e ndërmarrjes shpresojnë se pas një muaji do të fillojnë prodhimin e tyre dhe se sipas tyre e tërë makineria është e gatshme për të filluar prodhimin.

Nga vizitat e bëra gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017 nuk shihet se ka zhvilluar aktivitet prodhues.

Nga Prokuroria Speciale e Eulexit kemi marre njoftimin mbi përfundimin e hetimeve lidhur me rastin e "IDGJ Tobacco", ku ndër të tjera theksohet se prokuroria nuk ka dyshime të bazuara për veprën penale e krimit të organizuar.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 13 dhe 17 korrik 2017 ka nxjerr vendimin me numër ref. BD-95/10 për zgjatjen e periudhës së zotimeve nga 10 shtator 2014 deri më 28 shkurt 2015 dhe kryerjen e auditimit në këtë ndërmarrje për periudhën sa është zgjatur marrëveshja e zotimeve.

Është përgatitur dhe dorëzuar draft kontrata bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve dhe kemi angazhuar kompaninë audituese për auditimin e investimeve për këtë periudhë sa iu është zgjatur marrëveshja e zotimeve.

AKP ka angazhuar kompaninë audituese "Grant Thornton" për të bërë auditimin e përmbushjes së zotimeve për investime dhe punësim për periudhën e zgjatjes së marrëveshjes së zotimeve nga data 10 shtator 2014 deri më 28 shkurt 2015. Më datën 30 nëntor, AKP ka pranuar raportin e auditimit ku sipas këtij raporti për këtë periudhë blerësi ka bërë investime prej 847,395.00 Euro si dhe punësim total në vlerë prej 546 të punësuarve. Prandaj, bazuar në raportin e parë dhe të dytë të auditimit, blerësi ka bërë investime kapitale në vlerë prej 4,101,633.00 euro nga 4,000,000.00 të zotuar apo përmbushje prej 102.54%.

Sa i përket punësimit sipas të dy raporteve të auditimit blerësi ka punësuar 2,507 punëtor nga 2,625 të zotuar apo përmbushje prej 95.6%.

Menaxhmenti ka përgatitur memo për Bord të Drejtorëve bazuar në raportet e auditimit dhe Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 14 dhe 15 dhjetor 2017 ka vendosur që për mos përmbushje të zotimeve për punësim ndërmarrja të ndëshkohet me shumë prej 29,500.00 Euro dhe ndërmarrja të lirohet me kusht nga marrëveshja e zotimeve nëse paguan shumën prej 29,500.00 euro.

6.2. SPIN OFF-ET ME KUSHTE TË VEÇANTA

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku KI" Gjakovë

Janë realizuar disa vizita monitoruese në Ndërmarrje e Re "Emin Duraku Kompleksi Industrial" në Gjakovë. Gjatë vizitave të realizuara kryesisht kanë qenë të

angazhuar 8 punëtorë në prodhim, kurse në roje ishin 6 punëtor, ndërsa me vonë numri i punëtorëve në prodhim është rritur në 12, po ashtu si roje 12 kanë qenë të angazhuar.

Në gusht të vitit 2017 është lëshuar në prodhim objekti i ri në të cilin priten të punësohen 200 punëtorë.

Po ashtu, në ndërmarrje zhvillon aktivitetin e saj kompania "INTERTEX" dhe "Blue Chip" dhe "Comodita Home". Kompania "Intertex" gjeneron prodhim brenda hapësirës së Ndërmarrjes, punohen gardërobë pune për kompani të ndryshme, mbulesa për vetura për një përdorim për "Volvo" dhe çanta nga lëkura për kompaninë "The Brige" nga Italia.

Pas vendimit të Bordit të Drejtorëve për auditim të përmbushjes së zotimeve, është bërë auditimi nga kompania audituese "Grand Thornton", dhe sipas raportit të pranuar nga kompania audituese blerësi ka përmbushur kushtet e marrëveshjes së zotimeve.

Menaxhmenti i AKP-së ka dorëzuar memo për Bordin e Drejtorëve të AKP-së dhe në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të AKP-së të mbajtur më 14 dhe 15 dhjetor 2017 ka vendosur për lirim të ndërmarrjes nga marrëveshja e zotimeve.

Ndërmarrja e Re "Emin Duraku Edico" Gjakovë

Janë realizuar disa vizita monitoruese për të parë nga afër gjendjen në Ndërmarrjen e Re "Emin Duraku Edico". Gjatë vizitave në Ndërmarrje kryesisht kanë qenë të angazhuar në prodhim nga 20 deri 23 punëtor, për këta punëtor, blerësi paguan paga dhe kontribute, si dhe ua siguron një shujtë të ngrohtë. Në këtë ndërmarrje kryesisht prodhohen rroba sportive për mosha të ndryshme për femra dhe meshkuj.

Sa i përket investimeve në një pjesë të hapësirës së ndërmarrjes, blerësi e ka shtruar dyshemenë me qeramikë në hapësirën prej 700 m². Blerësi është duke mbajtur aktivitetin e tij bazuar në kontratën e cila i skadon më 01 mars 2018.

Ndërmarrjen e Re

"Dubrava Livestock Dairy Farm" Istog

Është realizuar një vizitë monitoruese në Ndërmarrjen e Re "Dubrava Livestock Dairy Farm" për të parë nga afër se a është duke mbajtur aktivitetin blerësi i kësaj Ndërmarrje, përkundër faktit se kësaj ndërmarrje i ka skaduar afati i marrëveshjes me datën 19 dhjetor 2016. Ekipi i NJKM-së gjatë vizitës ka parë se në ndërmarrje janë 253 krerë gjedhe, dhe po ashtu blerësi po vazhdon të mbaj numrin prej 17 punëtorëve, ashtu siç është paraparë me marrëveshjen e zotimeve. Blerësi theksoi se janë kryer mbjelljet pranverore prej 90 ha me jonxhë, misër dhe bar suedez. Blerësi potencoi se Ndërmarrja ka fituar një grant nga Bashkimi Evropian për rregullimin e sistemit të ujitjes pikë-pikë dhe me

spërkatje në vlerë 500,000 € për 150 ha tokë, i cili projekt do të rregullohet me sistem modern.

Nga kompania audituese e angazhuar “Audit & Konto” është pranuar raporti final i auditimit për Ndërmarrjen e Re “Dubrava Livestock and Dairy Farm”. Sipas raportit të auditimit, blerësi dhe ndërmarrja kanë përmbushur kushtin e paraparë me marrëveshjen e zotimeve me rastin e privatizimit të ndërmarrjes.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së me vendimin e datës 25.05.2017 ka liruar blerësin dhe ndërmarrjen nga marrëveshja e zotimeve, i cili njoftim iu është dorëzuar blerësit.

Ndërmarrje e Re “Famipa” Prizren

Pasi që ndërmarrjes i ka skaduar marrëveshja e zotimeve, ne kemi përgatitur raportin për shqyrtim për Bordin e Drejtorëve të AKP-së. Gjithashtu është kontaktuar me z. Lutfi Susuri që është mbikëqyrës në Njësinë kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit në Prizren lidhur me hetimet për Ndërmarrjen e Re “Famipa” Prizren. Nga biseda që zhvilluam ai theksoi se hetimet janë ndërprerë, mirëpo ata nuk mund të na japin dëshmi me shkrim për shkak se ato nuk janë iniciuar nga AKP-ja, por nga vetë njësia e krimeve në Prizren dhe se ata edhe kanë bërë ndërprerjen e hetimeve.

Pas marrjes së informacionit se objektet tek Ndërmarrja e Re “Famipa” janë rrënuar, ekipi i NJKM ka bërë një vizitë në hapësirat e ndërmarrjes ku kanë realizuar edhe disa fotografi të cilat pasqyrojnë gjendjen e ndërmarrjes dhe shihet se objektet e ndërmarrjes janë rrënuar të gjitha.

Është përgatitur dhe dorëzuar memo për bordin e Drejtorëve për vendim marrje, e cila ende nuk është shqyrtuar nga ana e bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Ndërmarrja e Re

“Fabrika e Amortizatorëve” Prishtinë

Është përgatitur memo për Ndërmarrjen e Re “Fabrika e Amortizatorëve” Prishtinë, si dhe tërë dokumentacioni tjetër përcjellës për menaxhmentin dhe Bordin e Drejtorëve të AKP-së, ku në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës 31.01.2017 është vendosur se ndërmarrja nuk ka obligime kontraktuese ndaj AKP-së, i cili vendim iu është dorëzuar blerësit të Ndërmarrjes së Re “Fabrika e Amortizatorëve” Prishtinë.

Ndërmarrja e Re “Hotel Unioni” Prishtinë

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur disa takime ndërmjet përfaqësuesve të LSHK-së dhe blerësit të Hotel Unioni nga të cilat takime është konstatuar se LSHK të angazhoj një kompani vlerësuese për të

vlerësuar qiranë në objektet e Hotel Unionit.

Pas pranimit të raportit të vlerësimit të qirasë për objektin e Ndërmarrjes së Re “Hotel Union” i përgatitur nga kompania vlerësuese Studio “Capital Group”, ky raport i vlerësimit iu është dorëzuar përfaqësuesve të “Benetton Group”, si dhe kemi kërkuar që të propozojnë ofertën e tyre për sigurimin e hapësirës së LSHK-së pas pranimit të këtij raporti të pavarur të vlerësimit. Blerësi dhe LSHK pas disa takimeve janë marrë vesh për pagesën që do të bëjë blerësi i “Hotel Unionit” për LSHK dhe të dy palëve iu është dorëzuar draft kontrata bazuar në marrëveshjen e tyre. Ndërkohë, blerësi ka përmbushur detyrimin tij ndaj LSHK-së duke paguar shumën në vlerë prej 260,000.00 në llogarinë bankarë të LSHK-së. Pas kryerjes së obligimit nga ana e blerësit, Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më datën 14 dhe 15 dhjetor 2017 ka marrë vendim për lirimin e ndërmarrjes nga marrëveshja e zotimeve.

Ndërmarrja e Re

“Fabrika e Baterive Industriale Trepça” Pejë

Janë përgatitur disa shkresa në kërkesën e blerësit të Ndërmarrjes së Re “Fabrika e Baterive Industriale Trepça” Pejë, ku ka kërkuar lirimin e Ndërmarrjes nga marrëveshja e zotimit. Gjithashtu është punuar në memo për këtë ndërmarrje. Për shkak të disa problemeve kadastrale lidhur me një ngastër që ende figuron në emër të NSH-së e jo në emër të Ndërmarrjes së Re, ende nuk kemi proceduar me raport informues për bordin e drejtorëve lidhur me këtë ndërmarrje.

Ndërmarrja e Re “Sharr Cem” Hani i Elezit

Është përgatitur shkresa në kërkesën e drejtuar AKP-së nga Komisioni i Pavarur për Miniera në lidhje me Ndërmarrjen “Sharrcem” për periudhën e komercializimit. Ne kemi përgatitur dhe ju kemi dorëzuar kontratën e komercializimit të ndërmarrjes si dhe raportin e auditimit për periudhën 10 vjeçare ku përfshihen investimet e realizuara në këtë periudhë.

Me kërkesë të Menaxhmentit është realizuar një vizitë monitoruese në Ndërmarrje e Re “Sharrcem” Hani i Elezit. Gjatë kësaj vizite monitoruese ekipi i NJKM është takuar me përfaqësuesit e blerësit. Përfaqësuesit e blerësit theksuan se ndërmarrja është duke vazhduar aktivitetin e saj të rregullt prodhues. Në këtë takim i njoftuam përfaqësuesit e blerësit në lidhje me raportin e auditimit, ku është paraqitur diferenca në investimet kapitale. Përfaqësuesit e blerësit pohojnë se përgjatë vitit 2016 janë realizuar investime kapitale në vlerë prej 5,148,000.00 Euro (investime në makineri, pajisje dhe tokë). Gjithashtu, ata potencuan edhe faktin se nga fillimi i këtij viti e deri më tani janë realizuar investime kapitale në vlerë prej 2,141,000.00 Euro, e që deri në fund të këtij

viti janë planifikuar investime totale në vlerë prej 4 milion, të cilat investime sipas tyre arrijnë vlerën e diferencës në raportin e auditimit. Përfaqësuesit e blerësit theksojnë se në vitin 2016, ndërmarrja ka dalë në humbje në vlerë prej 2 milion euro si pasojë e marzhës së vogël të fitimit në çimento.

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen mbajtur më 13 dhe 17 korrik 2017 ka vendosur që të bëhet një auditim i kushteve të tregut dhe pas kryerjes së auditimit të merret vendimi për këtë ndërmarrje. Pasi që tenderi për auditim ka dështuar dy herë, AKP ka filluar negociatat me disa kompani audituese për kryerjen e këtij auditimi por që vetëm kompania audituese "BDO Kosova" ka shprehur gatishmërinë për kryerjen e këtij auditimi dhe kanë përfunduar negociatat ku kompania audituese ka pranuar të bëjë angazhimin bazuar në termat e referencës dhe kushtet e parapara me tender.

Ndërmarrja e Re "Kualiteti International" Gjilan

Është zhvilluar një vizitë e shkurtër në hapësirat e Ndërmarrjes së Re "Kualiteti International" ku nga vizita është parë se aty janë ndërtuar tri objekte banesore afariste dhe sipas blerësit e tërë makineria e mullirit është zhvendosur në fshatin Bresalc prej ku do të zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes. Gjithashtu është përgatitur një raport informues për Bordin e Drejtorëve për ndërmarrjen. Duke pasur parasysh se në Dhomen e Posaçme të Gjykatës Supreme ende nuk është pranuar vendimi, Bordi i Drejtorëve ka vendosur që deri në vendimin nga Dhoma e Posaçme të pritet vendimi për këtë ndërmarrje.

6.3.ADMINISTRIMI DIREKT

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" Magure

Anëtarët e komisionit të caktuar nga menaxhmenti i ndërmarrjes kanë kryer regjistrimin e inventarit dhe mjeteve themelore të Ndërmarrjes së Re "MIM GOLESH" për vitin 2017.

Me datë 26.01.2017, MIM"GOLESH"-in e ka vizituar komisioni i përbërë nga anëtarë të KPMM-ës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Kosovës me qëllim të inspektimit të zonës së licencës së Magnezit të shfrytëzuar nga ish pronari dhe konstatimin e nevojës për ri kultivimin e asaj zone. Komisioni ka konstatuar se zona nuk është ri kultivuar dhe bazuar në ligjin për Miniera dhe Minerale duhet ekzekutuar garancioni i kompanisë së sigurimeve të lëshuar në emër të ish pronarit.

Me datë 13.02.2017 së bashku me anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së, kemi vizituar Ndërmarrjen e Re Miniera dhe Industria e Magnezitit. Vizita në këtë ndërmarrje ka qenë me qëllim që të njoftohen

anëtarët e Bordit me afër me pozitën, pasuritë dhe kapacitetin e kësaj ndërmarrje. Është biseduar gjithashtu edhe për gjetjen e mundësive eventuale për funksionalizimin e Ndërmarrjes së Re "MIM Golesh".

Është dorëzuar në KPMM raporti vjetor i punës dhe gjendja e rezervave të ndërmarrjes. Raporti përmban po ashtu edhe të dhënat financiare. Ky raport është pranuar nga KPMM.

Pjesëmarrje në prezantimin e GIZ-it Gjerman për "MIM Golesh". Në prezantim u fol për mundësitë dhe domosdoshmërinë e aktivizimit të ndërmarrjes para se të privatizohet ngase kështu mund të rrisim vlerën e po ashtu edhe të jemi më atraktiv për investitor potencial. Po ashtu profesori gjerman në studimin e tij kishte përfunduar se me pak investime mund të themelohet njësi për përpunimin e mineraleve të ndryshme në kuadër të "MIM Goleshit". Kjo për shkak të pajisjeve të cilat i posedon ndërmarrja në të cilat mund të përpunohet edhe minerale tjera përveç magnezit.

Kemi pranuar një kërkesë nga "Bechtel Enka" për tërheqjen e materialit të mbetur me çmim prej 0.60 cent, për shkak se materiali i minuar dhe seperuar është i përzier me mbetje. NJAD i ka sugjeruar që të dërgojnë kërkesë me shkrim. Duhet theksuar se çmimi sipas marrëveshjes është 5.50 euro për ton. Kërkesa është refuzuar dhe Bordi ka aprovuar shitjen e këtij materiali së bashku me materialet tjera të gatshme për shitje të cilat ndodhen në "MIM Golesh".

Është aprovuar kërkesa e Menaxhmentit të Ndër e Re "MIM Golesh", për blerjen e programit të kontabilitetit, i cili do të ndihmonte ndërmarrjen në mbajtjen e të dhënave financiare dhe paraqitjen e raporteve financiare më të sakta dhe më të besueshme.

Ndërmarrja e Re "MIM Golesh" aktualisht nuk është duke inkasuar të hyra nga aktiviteti i saj primar apo shitja e materialeve të cilat janë të deponuara si stok. Kontrata me "Bechtel Enka" ka skaduar në muajin prill 2017.

Në Ndërmarrjen e Re "MIM Golesh" janë të angazhuar 45 punëtor dhe pagat bruto për muaj janë në vlerë prej 18,948.00 euro ndërsa pagat neto janë në vlerë prej 17,127.00 euro.

Numri më i madh i punëtorëve është i angazhuar në ruajtjen e aseteve duke konsideruar faktin se hapësira e ndërmarrjes është shumë e madhe 267 ha, ndërsa punëtorët tjerë janë të angazhuar në menaxhim dhe mirëmbajtje të aseteve të cilat janë shumë të rëndësishme për ndërmarrjen, si dhe në administratë, kontabilitet etj.

Procedimi i pagesës për taksë administrative vjetore për Ndërmarrjen e Re "MIM Golesh" si poseduese e licencës së shfrytëzimit me nr. 15312/KPMM/2016.

AKP ka aplikuar në një projekt i cili do të financohej nga GIZ-i Gjerman të cilët do të bënin një plan biznesi detal për ndërmarrjen. Ende nuk kemi marrë informatë nga GIZ-i lidhur me mundësin e angazhimit të tyre në këtë projekt.

NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë

Njësia e Administrimit Direkt me qëllim të rritjes së të hyrave ka aprovuar kërkesën e menaxhmentit të ndërmarrjes për dhënien e aseteve me qira.

Njësia e Administrimit Direkt në përputhje me Rregulloren e qiradhënies ka tenderuar seperacionin dhe disa zyra të objektit të drejtorisë. Anëtarët e komisionit kanë vlerësuar ofertat e pranuar nga operatorët ekonomik dhe i kanë propozuar Bordit të Drejtoreshave të AKP-së aprovimin e qiradhënies.

Bordi i Drejtoreshave të AKP-së ka aprovuar qiradhënien e seperacionit dhe disa zyra të Drejtorisë në Klinë, sipas kriterëve të përcaktuara. Kontratat e qirasë për të dy asetet e NSH “Boksitet e Kosovës” janë nënshkruar dhe janë paguar qiratë e para konform kontratës po ashtu edhe garancioni bankar për mbulimin e kontratës së qirasë për separacion në afat prej një viti.

Më datë 13.02.2017 së bashku me anëtarët e Bordit të Drejtoreshave të AKP-së është vizituar NSH “Boksitet e Kosovës” Klinë. Vizita në këtë ndërmarrje ka qenë me qëllim që të njoftohen anëtarët e bordit më afër me pozitën, pasuritë dhe kapacitetin e ndërmarrjes.

Të hyrat e vetme të cilat i realizon ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht, ndërmarrja ka tri asete të dhëna me qira. Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 5,204.00 euro.

NSH “Ereniku Industria” Gjakovë

Të hyrat e vetme të cilat i realizon ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht, ndërmarrja ka tri asete të dhëna me qira. Të hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 1,368.00 euro.

Një aset i NSH “Ereniku Industria” ka qenë i uzurpuar dhe i cili aset pas refuzimit të shfrytëzuesit të paligjshëm të aseti të NSH Ereniku-Industria në Piskotë të Gjakovës për të hyrë në qira më çmimin e përcaktuar nga komisioni dhe aprovuar nga Bordi i Drejtoreshave, janë zhvilluar procedurat konform udhëzuesit për dëbimin e uzurpatorëve.

Me datën 24 prill 2017, NJAD ka intervenuar me policinë e Kosovës për lirimin e asetit të shfrytëzuar pa bazë, ku më pas janë zhvilluar procedurat për dhënien e këtij aseti me qira ku është formuar komisioni për vlerësimin e qirave dhe janë kryer të gjitha procedurat e parapara dhe aseti është dhënë me qira.

NSH “Virxhinia” Gjakovë

Bordi i Drejtoreshave të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Pas marrjes së kontrollit të ndërmarrjes, NJMKAD ka ndërmarrë veprimet të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Njesisë së AD.

- NJMKAD ka njoftuar përfaqësuesit e ndërmarrjes për vendimin e Bordit të Drejtoreshave të AKP-së;
- Menaxhmenti i AKP-se ka aprovuar propozimin e NJMKAD për emërimin e anëtarëve të Bordit të Përkohshëm Menaxhues;
- NJMKAD ka bllokuar llogarite bankare të ndërmarrjes dhe ka autorizuar zyrtarët të cilët do të kenë qasje në llogarite bankare të ndërmarrjes me te drejta të barabarta;
- Regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes;
- Prerja e bilancit të gjendjes dhe pranimi i pasqyrave financiare;
- NJMKAD është njoftuar edhe për numrin e punëtorëve, kontratat mbi qira, mundësinë e mbulimit të shpenzimeve për paga duke ju dhënë përkrahje financiare nga programi buxhetor riorganizimi dhe administrimi i NSH-ve të dedikuara për njësinë e AD.

Te hyrat e vetme të cilat i realizon ndërmarrja janë dhënia e aseteve me qira. Aktualisht, ndërmarrja ka tetëmbëdhjete (18) kontrata të qirasë. Te hyrat mujore nga dhënia e aseteve me qira janë në vlerë prej 3,700.00 euro.

NSH “Jatex” Gjakovë

Bordi i Drejtoreshave të AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Pas marrjes së kontrollit të ndërmarrjes, NJMKAD ka ndërmarrë veprimet të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të njesisë së AD.

- NJMKAD ka njoftuar përfaqësuesit e ndërmarrjes për vendimin e Bordit të Drejtoreshave të AKP-së;
- Menaxhmenti i AKP-se ka aprovuar propozimin e NJMKAD për emërimin e anëtarëve të Bordit të Përkohshëm Menaxhues;
- NJMKAD ka bllokuar llogarite bankare të ndërmarrjes dhe ka autorizuar zyrtarët të cilët do të kenë qasje në llogarite bankare të ndërmarrjes me te drejta të barabarta;
- Regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes;

- Prerja e bilancit të gjendjes dhe pranimi i pasqyrave financiare;
- NJMKAD është njoftuar edhe për numrin e punëtorëve, kontratat mbi qira, mundësinë e mbulimit të shpenzimeve për paga dhe shpenzime tjera.

NSH “Metaliku” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Pas marrjes së kontrollit të ndërmarrjes, NJMKAD ka ndërmarrë veprimet të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Njesisë së AD.

- NJMKAD ka njoftuar përfaqësuesit e ndërmarrjes për vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
- Menaxhmenti i AKP-se ka aprovuar propozimin e NJMKAD për emërimin e anëtarëve të Bordit të Përkohshëm Menaxhues;
- NJMKAD ka bllokuar llogarite bankare të ndërmarrjes dhe ka autorizuar zyrtaret të cilët do të kenë qasje në llogarite bankare të ndërmarrjes me të drejta të barabarta;
- Regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes;
- Prerja e bilancit të gjendjes dhe pranimi i pasqyrave financiare;
- Nga Menaxhmenti i ndërmarrjes, NJMKAD është njoftuar për numrin e punëtorëve dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes në fjalë.

Ndërmarrja aktualisht nuk inkason asnjë të hyrë.

NSH “Fabrika e Enëve” Gjakovë

Bordi i Drejtorëve i AKP-së në mbledhjen e mbajtur më 21 dhe 25 shtator 2017 ka vendosur për futjen e kësaj ndërmarrje në Administrim Direkt. Pas marrjes së kontrollit të Ndërmarrjes, NJMKAD ka ndërmarrë veprimet të cilat janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Njesisë së AD.

- NJMKAD ka njoftuar përfaqësuesit e ndërmarrjes për vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së;
- Menaxhmenti i AKP-se ka aprovuar propozimin e NJMKAD për emërimin e anëtarëve të Bordit të Përkohshëm Menaxhues;
- NJMKAD ka bllokuar llogarite bankare të ndërmarrjes dhe ka autorizuar zyrtaret të cilët do të kenë qasje në llogarite bankare të ndërmarrjes me të drejta të barabarta;

- Regjistrimi i aseteve të ndërmarrjes;
- Prerja e bilancit të gjendjes dhe pranimi i pasqyrave financiare;
- NJMKAD është njoftuar për numrin e punëtorëve dhe mënyrën e funksionimit të ndërmarrjes në fjalë nga Menaxhmenti i ndërmarrjes.

Ndërmarrja aktualisht nuk inkason asnjë të hyrë.

NSH “Iliria” Peje

Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 30/31 mars 2017 ka marrë vendim për vendosjen e NSH “Iliria” në Administrim Direkt të AKP-së.

Menaxhmenti i AKP-së, Njësia e Monitorimit, Kontrollit dhe Administrimit Direkt ka ekzekutuar vendimin e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vendosjen e kontrollit të drejtpërdrejt mbi ndërmarrjen.

Menaxhmenti i AKP-se ka aprovuar propozimin e NJMKAD për emërimin e koordinatorit të NSH “Iliria” Pejë.

Zyrat në objektin e Administratës të NSH “Iliria” janë të uzurpuara nga dy persona fizik të cilat i kane adaptuar për banim. Rasti për dy shfrytëzuesve të paligjshëm është në Gjykatën Themelore të Pejës për pengim posedim.

Ndërmarrja ka pas kontratë të qirasë për lokalin/bodrumin në sipërfaqe përafërsisht prej 105m². Po të njëjtën kontratë ish Drejtori i kësaj ndërmarrje nuk e ka vazhduar. NJMKAD i ka dërguar shkresë shfrytëzuesit të asetit/bodrumit në sipërfaqe përafërsisht prej 105 m² dhe ka përcaktuar kushtet për futjen në marrëveshje kontraktuale sipas Udhëzuesit për uzurpatorët. NJMKAD ka pranuar përgjigje nga shfrytëzuesi i lokalit/bodrumit. Rasti ende nuk ka përfunduar.

Po ashtu në objektin e Administratës së ndërmarrjes, i cili gjendet në rrugën Mbretëresha Teuta, një sipërfaqe përafërsisht prej 110 m² është e uzurpuar nga një person fizik. Nga informatat që i posedojmë nga Zyra Rajonale e Pejës dhe nga punëtorët e ndërmarrjes, personi është me të meta psikike dhe këtë sipërfaqe të ndërmarrjes e shfrytëzon vetëm për fjetje. Në hyrje të kësaj sipërfaqe janë të vendosura dyer të metalta të cilat janë të mbyllura me dry.

Ndërmarrja aktualisht nuk inkason asnjë të hyrë.

6.4. NDËSHKIMET FINANCIARE

Gjatë vitit 2017 janë aplikuar ndëshkimet financiare në vlerë prej 29,500.00 Euro për ndërmarrjen e re "IDGJ Tobacco" por gjithashtu me vendim të Bordit të Drejtorëve është vendosë që të shlyhen ndëshkimet e mëhershme për këtë ndërmarrje bazuar në

kontratën e novacionit.

Më poshtë paraqesim tabelën e ndëshkimeve financiare.

Shuma totale e ndëshkimeve për 5 SSO-të dhe një ndërmarrje me likuidim		
Ndërmarrje Re	Vlera e ndëshkimeve 01.01.2017	Vlera e ndëshkimeve 31.12.2017
Ndërmarrja e Re "Grand Hotel"	8,822,314.97	8,822,314.97
Ndërmarrja e Re "IDGJ Tobacco"	4,573,649.11	29,500.00
Ndërmarrja e Re "Xim Strezovc"	7,298,170.76	7,298,170.76
Ndërmarrja e Re "MIM Golesh"	8,447,812.27	8,447,812.27
Ndërmarrja e Re "Agrokosova Holding"	3,579,997.53	3,579,997.53
Ndërmarrja e Re "Llamkos"	1,715,488.79	1,715,488.79
Totali	EUR 34,437,433.43	EUR 29,893,284.32

Lidhur me ndëshkimet financiare, AKP ka angazhuar ekspertin ligjor dhe bazuar edhe në atë opinion NJMKAD dhe menaxhmenti i AKP-së ka dorëzuar memo në Bord të Drejtorëve.

Rekomandimet e dorëzuara për Bord të Drejtorëve janë që për ndërmarrjet të cilave iu janë tërhequr aksionet ("Grand Hotel", "XIM" Strezovc dhe "MIM" Golesh të ndërmerren hapat ligjor për inkasimin e tyre, për ndërmarrjen "IDGJ Tobacco" të shlyhen ndëshkimet financiare dhe për ndërmarrjet "Agrokosova Holding" dhe "Llamkos Galvasteel" të priten vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 14 dhe 15 dhjetor 2017 ka vendosur që ndëshkimet financiare të vendosura për Ndërmarrjen e Re "IDGJ Tobacco" para kontratës së novacionit në vlerë prej

4,573,649.11 euro të shlyhen nga pasqyrat financiare bazuar në kontratën e novacionit kurse për po të njëjtën ndërmarrje të aplikohen ndëshkimet në vlerë prej 29,500.00 euro për mos përmbushje në tërësi të zotimeve për punësim.

Gjithashtu Bordi i Drejtorëve në këtë mbledhje ka vendosur që menaxhmenti të bëjë analizë të mëtutjeshme për propozimin për ndëshkimet financiare për ndërmarrjet që iu janë tërhequr aksionet kurse për ndërmarrjet "AgroKoosva Holding" dhe "Llamkos Galvasteel" të priten vendimet gjyqësore dhe pastaj të ndërmerren hapat e mëtutjeshëm.

7. DEPARTAMENTI I LIKUIDIMIT

7.1. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Gjatë periudhës raportuese kanë filluar procedurat e likuidimit dhe janë emëruar Autoritetet e Likuidimit për 38 Ndërmarrje Shoqërore gjegjësisht asete. Sipas procedurave të parapara me Ligj janë bërë publikimet e njoftimeve për kreditorët dhe pronarët

e ndërmarrjeve në dy gazeta në Kosovë, një në Serbi dhe një në Mal të Zi. Brenda afatit të paraparë ligjor për parashtrimin e kërkesave për këto ndërmarrje janë pranuar 998 kërkesa kreditore në Zyrat Rajonale përkatëse të AKP-së.

Lista e Ndërmarrjeve Shoqërore/Aseteve për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit në periudhën janar-dhjetor 2017

Nr.	Nr. ID AKP-së	Emri i Ndërmarrjes Shoqërore	Regjioni	Data e fillimit të likuidimit dhe emërimit të AL-së
1	GJI064	FAM- Viti	Gjilan	22 shkurt 2017
2	MIT013	Kristal	Mitrovicë	15 shkurt 2017
3	MIT023	Ivo Lola Ribar Lesak	Mitrovicë	15 shkurt 2017
4	MIT024	Prva Petoletka	Mitrovicë	15 shkurt 2017
5	MIT028	Lola Alati	Mitrovicë	15 shkurt 2017
6	MIT036	Javor	Mitrovicë	15 shkurt 2017
7	MIT048	Simpo	Mitrovicë	15 shkurt 2017
8	MIT050	Zitoprodukt	Mitrovicë	15 shkurt 2017
9	MIT051	Univerzal	Mitrovicë	15 shkurt 2017
10	MIT053	Kosvik	Mitrovicë	15 shkurt 2017
11	MIT055	KB Leposavic	Mitrovicë	15 shkurt 2017
12	MIT109	Srbolek	Mitrovicë	15 shkurt 2017
13	MIT124	Organizata Punuese për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e objekteve	Mitrovicë	12 janar 2017
14	MIT132	Kosovska Metohijska Banka	Mitrovicë	15 shkurt 2017
15	MIT141	Konfekcioni Rashka	Mitrovicë	15 shkurt 2017
16	MIT142	Progres Shkup	Mitrovicë	12 janar 2017
17	MIT145	Zateks	Mitrovicë	12 janar 2017
18	MIT146	Alhos Sarajevo	Mitrovicë	12 janar 2017
19	MIT148	Muharrem Bekteshi	Mitrovicë	12 janar 2017
20	MIT150	Rubin-Karmin Shkup	Mitrovicë	12 janar 2017
21	PEJ002	Apiko	Pejë	22 shkurt 2017
22	PEJ100	Stacioni i veterines Pejë	Pejë	22 shkurt 2017
23	PEJ126	Iliria	Pejë	22 shkurt 2017
24	PEJ190	Ndërmarrja për shfaqjen e Filmave RAD	Pejë	22 shkurt 2017
25	PRN071	Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore të Kosovës	Prishtinë	22 shkurt 2017
26	PRN074	Rilindja Revista	Prishtinë	19 janar 2017

27	PRN119	Njësia Punuese Kabllar, Kralevë	Prishtinë	15 shkurt 2017
28	PRN120	Jugo Auto Prishtina	Prishtinë	15 shkurt 2017
29	PRN133	Banka e Lubjanës	Prishtinë	19 janar 2017
30	PRN142	Rilindja Gazeta	Prishtinë	22 shkurt 2017
31	PRN147	Rekord	Prishtinë	19 janar 2017
32	PRN151	TAN	Prishtinë	22 shkurt 2017
33	PRN175	IT Proleter	Prishtinë	19 janar 2017
34	PRN176	KBI Vrbas Komerc	Prishtinë	19 janar 2017
35	PRN177	KB Agrobisernica Rozhaje	Prishtinë	19 janar 2017
36	PRZ076	OLTI-Osijek	Prizren	22 shkurt 2017
37	PRN111	Përparimi	Prishtinë	12 qershor 2017
38	MIT113	Ndërmarrja për mirëmbajtje Ndërtimore Zveçan	Mitrovicë	2 tetor 2017

Në total, nga fillimi i tërë procesit deri në datën e raportimit janë gjithsej 501 Ndërmarrje Shoqërore për të cilat kanë filluar procedurat e likuidimit.

administruar nga Autoritetet e Likuidimit (OSHP me AKP-në) për NSh-të të cilat kanë asete sipas shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 - Ofruesin e Shërbimeve Profesionale.

Këto Ndërmarrje Shoqërore në likuidim janë

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2017	Tërë procesi (deri më 31 dhjetor 2017)
Numri i NSh-ve në likuidim	38	501
Numri i kërkesave të parashtruara nga kreditorët	998	90,808
Numri i kërkesave të shqyrtuara	1,006	90,545
Numri i NSh-ve të mbyllura sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK)- (NSH-të pa asete dhe/ose pa kërkesa kreditore)	5	17
Numri i raporteve të shpërndarjes së parakohshme	41	161
Shuma e fondeve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë për shpërndarje tek kreditorët e ligjshëm	€6,798,803.92	€ 24,282,834

Nga numri prej 90,808 të kërkesave kreditore, deri në datën e raportimit për 90,545 janë lëshuar vendimet për parashtruesit e kërkesave kreditore nga Autoritetet e Likuidimit.

7.2. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Ashtu siç është përshkruar më lartë, Ofruesi i Shërbimeve Profesionale është i angazhuar si pjesë e Autoritetit të Likuidimit për Ndërmarrjet Shoqërore

të cilat kanë asete. Kjo në përputhje me nenin 13 të shtojcës të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Përshkrimi	A	B	C	C=A-B	D=B/A
	Vlera e kontraktuar	Pagesat e realizuara për gjatë aneksit 2 të kontratës	Pagesat e realizuara (për periudhën janar-dhjetor 2017)	Shuma e mbetur nga aneksi 2 i kontratës	%
10% E VLERËS SË ANEKSIT 2 TË KONTRATËS	€1,992,000	1,411.000	996,000	581,000	70.83%
GJITHSEJ	€1,992,000	1,411.000	996,000	581,000	70.83%

Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar implementimi i aneksit 2 të kontratës për Projektin e Likuidimit të portofolios të Ndërmarrjeve Shoqërore në Republikën e Kosovës, me ç'rast ka vazhduar procesi i likuidimit për të gjitha ato NSh për të cilat është iniciuar procedura e likuidimit.

7.3. SHPËRNDARJA E MJETEVE NDAJ

KREDITORËVE

Autoritetet e Likuidimit të NSh-ve në Likuidim kanë përgatitur raportet përfundimtare të shpërndarjes dhe ka vazhduar shpërndarja e mjeteve tek kreditorët e ligjshëm sipas raporteve të aprovuara nga Bordi i Agjencisë.

Në mbledhjet e mbajtura gjatë periudhës janar - dhjetor 2017, janë aprovuar për shpërndarje gjithsej 41 Ndërmarrje. Vlera e fondeve për shpërndarje sipas raporteve të aprovuara për 41 NSh është gjithsej EUR 6,798,803.92. Në total janë **EUR 24,282,834**.

LLOJET E KREDITORËVE	SHUMAT E APROVUARA			PAGESAT 2011 - 2017	PAPAGUAR
	JANAR -DHJETOR 2017	DERI MË 31 DHJETOR 2016	GJITHSEJ		
Për paga të punëtorëve	4,268,362	6,507,567	10,775,929	10,530,898	245,031
ATK-ja	856,282	3,984,328	4,840,610	4,839,527	1,083
Trusti	575,079	1,718,988	2,294,067	2,283,218	10,849
Tatimi në pronë	320,739	967,402	1,288,141	1,285,348	2,793
Shërbimet publike	109,882	798,095	907,977	881,023	26,954
Kreditor të tjerë	692,917	3,483,193	4,176,110	4,157,870	18,240
GJITHSEJ	6,823,261*	17,459,573	24,282,834	23,977,884	304,950

* Numri i raporteve të aprovuara për shpërndarje gjatë vitit 2017 është për 41 NSh. Ndërsa pjesë të raporteve të korrigjuara për vendime të kreditorëve gjatë vitit 2017 të cilat janë aprovuar në vitin paraprak janë gjithsej për 4 NSh. Pagesat ndaj kreditorëve

të këtyre NSh-ve janë ekzekutuar në vitin 2017, më detajisht janë paraqitur në pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim në shënimin shpjegues nr. 16.

7.4. LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE PA ASETE DHE/OSE PA KËRKESA KREDITORE

Njësia e Likuidimit e cila bënë likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat nuk kanë asete dhe/ose kërkesa kreditore.

Nga 37 Ndërmarrje Shoqërore janë likuiduar 16 prej tyre (tërë procesi) me vendim të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa gjatë periudhës raportuese janë likuiduar 4 NSh.

1. Lista e Ndërmarrjeve të Likuiduara gjatë periudhës janar - dhjetor 2017

Nr.	Komuna	Emri i NSh-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në Bordin e AKP-së	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGJSK	Aktvendimi i DhPGJSK për mbylljen e likuidimit
1	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Gaçkë"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	10 mars 2014	23 nëntor 2016	25 janar 2017	5 prill 2017
2	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Agrokultura"	Pa asete / Pa kërkesa kreditore	10 mars 2014	30 mars 2017	11 prill 2017	21 qershor 2017
3	Han i Elezit	Ndërmarrja Shoqërore "16 Nëntori"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	10 mars 2014	27 prill 2017	2 maj 2017	21 qershor 2017
4	Prizren	Ndërmarrja Shoqërore "Ndërtimi"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	9 dhjetor 2013	25 maj 2017	6 qershor 2017	31 korrik 2017

2. Lista e Ndërmarrjeve të likuiduara gjatë tërë procesit

Nr.	Komuna	Emri i NSh-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në Bordin e AKP-së	Data e prezantimit të Raportit Përfundimtar në DhPGJSK	Aktvendimi i DhPGJSK për mbylljen e likuidimit
1	Skenderaj	Kooperativa Bujqësore "Likovci"	Me asete / Pa kërkesa kreditore	05 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	11 janar 2013
2	Skenderaj	Kooperativa Bujqësore "Liria"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	04 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	31 janar 2013
3	Skenderaj	NSh "Graniti"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	09 gusht 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	10 dhjetor 2012
4	Vushtrri	NSh SHAM "Ruzhdi Bytyqi"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	19 qershor 2013	31 janar 2014	04 shkurt 2014	19 mars 2014

5	Mitrovicë	NSh Hidrotermika"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	31 dhjetor 2010	20 korrik 2012	16 gusht 2012	15 tetor 2012
6	Suharekë	NSh "SH.A.M. Semafor" Suharekë	Pa asete / Me kërkesa kreditore	31 dhjetor 2010	27 qershor 2013	28 qershor 2013	17 janar 2014
7	Pejë	Kooperativa Bujqësore "Ozdrim"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	27 qershor 2013	19 dhjetor 2013	26 dhjetor 2013	27 shkurt 2014
8	Pejë	Kooperativa Bujqësore "Vitomirica"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	27 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	1 gusht 2016
9	Prizren	NSh Shoqata "Auto Moto"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	11 qershor 2013	16 maj 2016	18 korrik 2016	2 gusht 2016
10	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Bibaj"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	3 mars 2014	16 maj 2016	18 korrik 2016	24 gusht 2016
11	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Xhafa"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	23 qershor 2014	31 gusht 2016	21 shtator 2016	30 shtator 2016
12	Viti	Kooperativa Bujqësore "Visoqa"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	3 mars 2014	21 shtator 2016	23 shtator 2016	14 tetor 2016

7.5. NJËSIA PËR TRANZICIONIN E TREPÇËS

Gjatë vitit 2017, Agjencia përmes Ofruesve të Shërbimeve Profesionale të kontraktuar ka përfunduar realizimin e Studimit të Fizibilitetit të Trepçës. Kontrata e lidhur dhe e filluar në shtator 2016, është vazhduar, përmbushur dhe përfunduar në prill 2017, kur Raporti i Studimit është dorëzuar dhe miratuar nga Bordi i Drejtorëve të AKP. Realizimi i këtij studimi është përcjell me vështirësi të konsiderueshme, për shkak të rezistimeve për bashkëpunim që janë hasur. Vështirësitë kanë vazhduar edhe pas përfundimit, kur për shkak të vakuimit institucional, realizimin i pagesës së studimit nuk ka mundur të kryhet në kohë. Kjo situatë ka zgjatur deri në fund të vitit 2017, kur obligimet e Agjencisë janë kryer në tërësi.

Raporti i Studimit është dorëzuar tek dy Menaxhmentet e Ndërmarrjes Trepça. Është dorëzuar në mënyrë zyrtare dhe solemne edhe tek Kabineti i Kryeministrit të Kosovës, Kabineti i Kryetarit të Kuvendit, Ministrit Zhvillimit Ekonomik, si dhe tek Dhoma e Posaçme, dhe pesë Ambasadat e shteteve të Quint-it në Kosovë.

Raporti i Studimit është dorëzuar në vlerësim tek tre ekspertë të fushave përkatëse të studimit, dhe ka

siguruar shqyrtimin e studimit nga Banka Botërore (BB), me financim të vetë BB. Komentet e ekspertëve të pavarur, si dhe të ekspertëve të BB, janë dorëzuar tek Kabineti i Kryeministrit të Kosovës.

AKP duhet të presë vendimin për ndarje të aseteve të Trepçës që sipas Ligjit 05/L-120 duhet të merret nga Bordi Mbikëqyrës i Trepçës. Vendimi që do të merret nga ky Bord i Trepçës, është kusht që AKP të dijë listën e njësive ndaj të cilave do të mund të ndërmerr veprime ligjore për privatizim dhe likuidim. Meqë konstituimi i Bordit Mbikëqyrës të Trepçës nuk është bërë gjatë vitit 2017, AKP nuk ka mundur të ndërmerr veprime për privatizim dhe likuidim të tyre, pasi që ky vendim që definon cilat janë njësitë nën Kompetenca të AKP ndaj të cilave mund të merren veprim të likuidimit/privatizimit, nuk është sjellë ende.

Ish Njësia e Riorganizimit të Trepçës, në v. 2017 është transformuar në Njësinë për Tranzicion të Trepçës. Në pamundësi të marrjes së veprimeve rreth aseteve të Trepçës, stafi i NjTT është pakësuar në 2 gjithsej në pjesën e parë të vitit 2017, ndërsa në pjesën e dytë, NjTT ka transferuar edhe një zyrtar në departament tjetër ku Agjencia ka pasur nevojë, përderisa NjTT ka funksionuar me një zyrtar - Kryesuesin e Njësisë.

Në janar 2017, Agjencia ka dorëzuar Memorandum bashkëpunimi në MZHE për të ofruar ndihmë lidhur me Trepçën, duke parashikuar nevojën për kontroll dhe mbikëqyrje që Trepça duhej ta kishte në këtë fazë. Pas vënies në dijeni se prodhimi në vitin 2017 ka pësuar rënie prej rreth 35% krahasuar me prodhimin e vitit 2016 (kur Trepça ndodhej nën administrim të AKP), Agjencia në fund të vitit 2017 ka dorëzuar sërish memorandum për ndihmë dhe bashkëpunim, mirëpo një bashkëpunim i tillë nuk është jetësuar në 2017.

NjTT, përveç koordinimit të punëve të lartcekura lidhur me Trepçën, gjatë 2017, gjithashtu ka ndihmuar Agjencinë që në koordinim me GIZ, të përfitojë grant nga institucione gjermane, për financim të analizave të mostrave të hallozoiteve, magnezitit, bentonitit, diatomitit e talkut, me qëllim të rekomandimit për

shfrytëzim të qëndrueshëm të këtyre resurseve për zhvillim ekonomik. Granti është fituar, ndërsa analizat dhe raporti për materiet e lartcekura është kryer. Raporti ku potencohen mundësitë e shndërrimit të MIM Golesh-t në qendër potenciale për procesim të metaleve industriale është dorëzuar në AKP dhe MZHE. Pas konstatimit se MIM ka këto potenciale, NJTT në emër të AKP në nëntor 2017, sërish ka aplikuar për grant në GIZ, për financim të projektit të Biznes Planit nga ekspertë të kësaj industrie, ku do të përshkruhen veprimet konkrete që duhet ndërmarë, dhe, ku do të përcaktohet lartësia e investimeve të nevojshme për transformim të suksesshëm të Goleshit në qendër procesimi të metaleve industriale. Ky Biznes Plan, duhet të shërbej si udhërrëfyes në vendimmarrjen lidhur me MIM Goleshin në të ardhmen.

8. DEPARTAMENTI I KOORDINIMIT RAJONAL

8.1. SHITJA DHE ADMINISTRIMI I ASETEVE

Agjencia sipas mandatit të saj, nga viti 2002 deri më 31 Dhjetor 2017 ka administruar dhe kërkon të administroj (duke përfshirë asetet jashtë territorit të Kosovës) me gjithsej 3,700 asetë të Ndërmarrjeve Shoqërore. Ky numër paraqet numrin e të gjitha asetëve të shitura dhe të pashitura të cilat janë identifikuar nga ana e Agjencisë brenda Republikës së Kosovës dhe jashtë Republikës së Kosovës. Më poshtë janë paraqitur të dhënat në mënyrë tabelare

të asetëve sipas territorit apo llojit të tyre nga viti 2002 – 2017.

Asetet e mbetura (të pashitura) me të cilat ende administron AKP-ja janë gjithsej 2,032, ndërsa asetet jashtë Kosovës janë 162. Gjithsesi, ky numër mund të ndryshoj në periudhat pasuese, varësisht në ndërrimin e statuseve të NSH-ve apo identifikimit të asetëve të NSH-ve përkatëse.

RAPORTI PËRMBLEDHËS I ASETEVE TË PASHITURA BRENDA KOSOVËS

	1	2	3	4=sum(1:3)	=4/total
Rajoni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej	
Prishtina	264	183	61	508	25%
Peja	229	229	105	563	28%
Prizren	97	218	10	325	16%
Gjilan	46	39	131	216	11%
Mitrovica	197	191	32	420	21%
Gjithsej	833	860	339	2032	100%

Asetet jashtë Republikës së Kosovës:

Regjioni	Asetet tjera	Tokat bujqësore	Tokat tjera	Gjithsej
Bosne	14	-	1	15
Kroaci	5	-	-	5
Mal të Zi	34	-	1	35
Maqedoni	6	-	1	7
Slloveni	1	-	-	1
Serbi	99	-	-	99
Gjithsej	159	-	3	162

Nr.	Përshkrimi	Kosovë		Jashtë Kosovës		Gjithsej	
		Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura	Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura	Nr. NSh-ve	Asetet e pashitura
1	Në likuidim- asete të pashitura	321	1858	38	162	359	2020
2	Në transicion- asete të pashitura	54	174	1	0	55	174
	GJITHSEJ:	375	2032	39	162	414	2194

Gjatë kësaj periudhe lidhur me këto asete, AKP-ja kryesisht ka administruar lidhur me: qiratë, trajtimin e tyre si asete të uzurpuara, në koordinim me institucionet – shpalljen e interesit publik, kontestet gjyqësore dhe të tjera.

8.2. ASETET E LËSHUARA ME QIRA

Edhe gjatë kësaj periudhe pjesë thelbësore e strategjisë, sa i përket menaxhimit të aseteve, ka qenë edhe dhënia me qira e aseteve.

AKP-ja menaxhon me një numër të madhë të aseteve apo të NSh-ve që janë të mëdha dhe komplekse të

tilla si NSh Grand Hotel, NSh Pallati i Rinisë, NSh ABC Genci dhe NSh Tregu.

Përveç menaxhimit me NSh-të e mëdha dhe komplekse, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike në Kosovës dhe sistemin gjyqësor në Kosovë, implementimi i politikave në dhënie me qira të aseteve për AKP-në ka qenë sfidë në vete.

Në krahasim me vitin 2016, inkasimi i qirasë është rritur në nivel prej 6% si dhe në krahasim me vitin 2015 prej 36%. Vlen të përmendet se në vitin 2016, AKP-ja ka inkasuar qiranë prej EUR 915,063 nga UNMIK-u për qiranë e papaguar për vitet 2003 – 2009. Andaj, llogaritur nivelin e rritjes të vitit 2017 në krahasim me vitin 2016, pa përfshirë këtë shumë, atëherë kemi rritje prej 25%.

NSH	GJITHSEJ	2017	2016	2015	2002 - 2014
Pallati	3,989,506	1,572,808	1,049,235	496,908	870,555
Grandi	1,238,136	425,509	431,618	381,009	-
ABC Genci	403,034	178,922	116,364	107,748	-
Tregu	2,124,070	845,568	651,978	573,466	53,058
GJITHSEJ	7,754,746	3,022,807	2,249,195	1,559,131	923,613
NSH-të TJERA	19,786,586	3,505,400	3,888,375	3,237,410	9,155,401
GJITHSEJ	27,541,332	6,528,207	6,137,570	4,796,541	10,079,014

Rritja e performancës të inkasimeve (sidomos gjatë 2015 - 2017) ka ardhur si rezultat i dy faktorëve të paraqitur si më poshtë:

1. Administrimin nga AKP me Nsh-të të cilat kanë vazhduar aktivitetin e përgjithshëm ekonomik - NSh Grandi, NSh Tregu, NSh ABC Genci dhe administrimi (tranzicion/likuidim) me Pallatin e Rinisë; dhe
2. Vendimi i datës 21 Nëntor 2014 nga Menaxhmenti për lirin e aseteve të uzurpuara. Për këto janë paraqitur shënimet ndarazi në nënkapitullin


“Trajtimi i Aseteve të Uzurpuara”.

Gjithsesi, më poshtë nëpërmjet grafikont, është paraqitur performanca e rritjes të qirave duke marrë për bazë tre viteve të fundit.

SQARIMI I GRAFIKUT

Për vitin 2016 është paraqitur shuma prej EUR 5,222,507 pa përfshirë inkasimin e qirasë të paguar nga UNMIK-u. UNMIK-u si qiramarrës i asetit të NSh “Jugobanka”, në nëntor të vitit 2016 ka paguar shumën prej EUR 915,063 për obligimet e viteve 2003 – 2009.

KRAHASIMI I I PERIUDHAVE TË INKASIMIT TË QIRASË



*Përqindjet e shprehura në këtë grafikun, paraqesin nivelin e rritjesë të qirave vit pas viti duke i përfshirë të gjitha NSh-të.

Në anën tjetër, vlen të përmendet, se vetëm brenda tre viteve 2015 – 2017 janë inkasuar rreth 64% të totalit të qirasë. Pjesa tjetër prej 36% është për periudhën 2003 – 2014 përkatësisht 12 vite. Kuptohet, ashtu siç e kemi potencuar edhe më lartë, faktor në këtë rritje të performancës është nga inkasimi i qirave për NSh-të e mëdha për të cilat vazhdon aktiviteti i tyre ekonomik (kryesisht qiradhënia) të NSh Grandi, Tregu, Pallati dhe ABC Genci. Pjesëmarrja në totalin e


qirasë të këtyre NSh-ve është prej 25% për vitin 2015 2017 dhe 3% për vitin 2003 - 2014.

Mirëpo, edhe për NSh-të tjera që nuk kanë vazhduar aktivitetin e tyre ekonomik, pjesëmarrja në totalin e qirasë është 39% për vitin 2015 – 2017 si dhe 33% për vitin 2003 – 2014.

Nëpërmjet grafikut 2 të mëposhtëm është paraqitur pjesëmarrja në përqindje kundrejt totalit ndërmjet periudhave 2003 – 2014 vs 2015 – 2017.

GRAFIKU 2 – PJESËMARRJA E QIRASË PËR TRE VITET E FUNDIT KUNDREJT TOTALIT TË REALIZUAR

**NIVELI I PJESËMARRJESË NË PËRQINDJE TË TOTALIT TË QIRASË
2003 - 2014 vs 2015 - 2017**



8.3. TRAJTIMI I ASETEVE TË UZURPUARA

Zyrat rajonale vazhdimisht kanë punuar në lirim të pronave të uzurpuara ku nga numri prej 53 aseteve të uzurpuara në fund të vitit 2016, në fund të periudhës raportuese ky numër është 23 raste të cilat ndodhen në veriun e Mitrovicës.

Sa i përket rasteve të aseteve në veri AKP ka kërkuar disa herë asistencë për lirim të aseteve mirëpo të

gjitha rastet kjo është anuluar në moment të fundit nga Policia e Kosovës, me arsyetimin se ka rrezikshmëri të lartë për të intervenuar, andaj edhe pse DKR i ka përfunduar të gjitha veprimet juridike dhe praktike në dispozicion, megjithatë do të vazhdon të bëjë përpjekje për lirim të këtyre aseteve, normalisht në koordinim të plotë me Policinë e Kosovës.

9. DEPARTAMENTI LIGJOR

Njësia e Opinioneve Ligjore dhe Shqyrtimit të Kontratave të Shitjes - Opinione Ligjore të kërkuara me Kërkesë për Veprim apo nga Menaxhmenti 34; Hartimi, shqyrtimi apo analizimi i dokumenteve të ndryshme 59; Takimet në të cilat është kërkuar pjesëmarrja e zyrtarëve ligjorë 85; Kontrata të shqyrtuara 219.

Njësia për Çështjet Gjyqësore - Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 723 (Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë: Mbrojtje në padi 532; Kundërpërgjigje 62; Përgjigje në ankesë 71; Parashtrësë 53; Seanca Gjyqësore 167; Urdhra të pranuar 139; Ankesa 30; Përgjigje në urdhër 61; Përgjigje në masë të përkohshme 42; Aktvendim 143, Aktgjykim 85). Veprimet procedurale të ndërmarra nga Njësia e Përfaqësimeve Gjyqësore në çështjet lidhur me listat e punëtorëve. Numri i përgjithshëm i lëndëve të pranuar: 499. Veprimet procedurale të ndërmarra në lëndë: Përgjigje në urdhër 57; Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 32; Aktgjykim 63; Përgjigje në ankesë 408; Parashtrësë 37; Aktvendim 66.

Njësia për Trajtimin e Aseteve Jashtë Kosovës - Ankesa kundër Vendimeve të Organeve (në procedurën gjyqësore dhe administrative) të shteteve të huaja 11; Pjesëmarrje në seancë gjyqësore 11; Parashtrësë 3.

9.1. MASAT E PËRKOHSHME NGA

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME

Për katër (4) shitje të organizuara kemi ndalesa nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme dhe derisa nuk hiqen këto ndalesa nuk mund të vazhdohet me shitjen. Ndalesat vlejné për ndërmarrjet/asetet në vijim:

1. Ndërmarrja e Re "AGROKOSOVA – Zyret Sh.P.K." – Vala 37;
2. Ndërmarrja e Re "Punëtorja Iliria Sh.P.K." – Vala 43.
3. Aseti në likuidim "Farmakos Blue Factory" Prizren;
4. Njësia nr. 12: Lavërtari Blegtori - Tokë Bujqësore Miradi e Poshtme i - SHAL 20;

Deri më datë 31 dhjetor 2017 janë të regjistruara 915 raste me propozime për masë të ndalimit të përkohshëm të dorëzuara në Dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme ndaj veprimeve të AKP-së. Përgjatë periudhës së procesit të privatizimit dhe likuidimit nga qershor 2002 e deri më 31 dhjetor 2017 janë këto të dhëna:

- 110 masa të përkohshme janë ende në fuqi;
- 302 kërkesa për masë të përkohshme janë ende në shqyrtim e sipër nga Gjykata; dhe
- 503 kërkesa janë refuzuar nga Gjykata.

10. DEPARTAMENTI I MARKETINGUT, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN DHE INVESTITORËT

10.1. NJËSIA E MARKETINGUT DHE

MARRËDHËNIEVE ME INVESTITORE

- **Përkrahja e plotë në shpallje të Shitjeve të Aseteve** - Njësia e Marketingut ka aplikuar praktikat e deritanishme të informimit publik përmes aktiviteteve mbështetëse për shpalljen e shitjeve, në drejtim të implementimit të strategjisë së marketingut masiv në kombinim me aktivitete të marketingut direkt, për çdo Shitje të Aseteve që është shpallur (SHAL29, SHAL30, SHAL31, SHAL32, SHAL33, SHAL34, SHA35, SHA36, SHA37 dhe SHA38).
- **Ngritja e vizibilitetit dhe promovimit të procesit të privatizimit** - Në kuadër të aktiviteteve promovuese është bërë realizimi i të gjitha produkteve të marketingut të cilat kryhen brenda njësisë, përfshirë konceptimin, dizajnin dhe realizimin teknik të TV reklamave, shpalljeve të shtypura, broshurave, prezantimeve dhe të gjitha materialeve tjera promovuese.
- Në mbështetje të strategjisë për promovimin dhe tërheqjen e investitorëve Njësia e Marketingut ka marrë pjesë në ngjarje të ndryshme, me qëllim të promovimit të procesit të privatizimit, përfshirë Panairin Ndërkombëtar "Expokos 2017", forumin ekonomik Kosovë-Greqi, Panairin Ndërkombëtar "Prishtina 2017" etj.
- **Ngritja e transparencës dhe nivelit të informimit përmes azhurnimit dhe popullimit të ueb-faqes së AKP-së me informata të sakta dhe në kohë reale** - uebfaqja e AKP-së është populluar me të gjitha informatat publike në lidhje me procesin e privatizimit në Kosovë.
- **Funksionalizimi dhe lansimi i ueb-faqes së re të Agjencisë** - lansimi i faqes së re është bërë me datë 12 dhjetor 2017.
- **Përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve të ofruara për investitorët potencial** - Njësia e Marketingut dhe Marrëdhënie me Investitorë ka vazhduar të mbetet pika primare e komunikimit me investitorët potencial vendor dhe ndërkombëtar,

duke u përgjigjur kërkesave dhe ofruar udhëzime dhe këshillime rreth procesit të privatizimit dhe pjesëmarrjes në tenderët e shpallur, përfshirë parakualifikimin, koordinimin e hulumtimit paraprak dhe sigurimin e materialeve tenderuese (Rregullat e Tenderit, Memorandume Informimi etj.).

10.2. NJËSIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

- Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë kësaj periudhe ka hartuar dhe dërguar njoftimet për media për njëmbëdhjetë shitje të aseteve me likuidim dhe ka përgatitur fjalimet për këto ceremoni;
- Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun ka bërë monitorimin ditor të medieve të shkruara dhe elektronike vendore dhe ndërkombëtare për interes të AKP-së;
- Njësia për Media dhe Marrëdhënie me Publikun, gjatë këtij viti ka përgatitur rreth 71 përgjigje me shkrim të dërguara përmes emalit në pyetje të gazetarëve të medieve të ndryshme;
- Njësia për Marrëdhënie me Publikun dhe Media ka hartuar dhe dërguar për media dhe përmes tyre tek opinionin i gjerë rreth 40 Komunikata për Media për aktivitetet e ndryshme të Agjencisë.
- NjMMP ka filluar me zhvillimin e artikujve të

sponsorizuar rreth procesit të privatizimiti AKP-së dhe rëndësisë së Privatizimit për ekonominë e vendit, në këtë drejtim NjMMP gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar artikujt për publikim në media dhe portale;

- Prezentime përmbledhëse të rezultateve të punës, dhe të arriturave dhe aktiviteteve përmbledhëse të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për gjatë vitit 2017 në TV portale dhe gazeta ditore;
- Gjatë këtij viti NjMMP ka zhvilluar dokumentin mbi Strategjinë AKP-së për Media dhe Marrëdhënie me Publikun;
- Veç kësaj NjMMP gjatë periudhës raportuese ka bërë 100 postime në rrjetet sociale si dhe rreth 200 përgjigje dhe pronocime për mediet e shkruara dhe ato elektronike si dhe ka zhvilluar 4 fushata të sponsorizuara në FB për të ngritur transparencëm dhe me qëllim të përmirësimit të imazhit.
- Kjo njësi ka përgatitur edhe raporte për Ministrinë e Integritimit Evropian lidhur me zbatimin e planit kombëtar për zbatim të MSA-së, pra raportin vjetor të AKP-së për 2017.
- Janë përgatitur raporte të rregullta (çdo tre muaj) dhe këto raporte i janë dërguar njësisë përkatëse të Qeverisë së Kosovës/Zyrës së Kryeministrit, e cila përgatit raportin gjithëpërfshirëse të institucioneve publike, për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Numri i kërkesave të pranuar 2017

Numri total	Qasja e lejuar	E refuzuar	E kufizuar	Pa përgjigje	Arsye tjera
15	9	4	1	1	

11. DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE


Gjatë periudhës raportuese (1 Janar - 31 Dhjetor 2017) në Departamentin e Burimeve Njerëzore janë zhvilluar aktivitetet si në vijim:

11.1. PAGAT

- Janë përgatitur dhe dërguar për ekzekutim në baza mujore Listat e Pagave (Payrollit) për muajt Janar- Dhjetor 2017;
- Është bërë planifikimi i buxhetit për paga/ mëditje, trajnime dhe vendimet e gjykatave për 2018-2010 (në bashkëpunim me Departamenti e financave dhe Buxhetit).

11.2. REKRUTIMET DHE LËVIZJET E STAFIT

- Gjatë kësaj periudhe, DBNJ ka udhëhequr me procedurat e rekrutimit për pozitat e mëposhtme:
 - Zyrtar Kadastral (ZR Gjilan);
 - Zyrtar Kadastral (ZR Mitrovicë);
 - Ekspert Ligjor – Opionione (o.sh.)
 - Janë angazhuar si Ofrues të Shërbimeve (OSH) gjashtë (6) persona me aftësi të kufizuara të rekomanduar nga shoqata Handikos;
 - Janë kthyer në vend të punës katër (4) zyrtarë që kanë qenë në pezullim parandalues;
 - Ndërprerje e marrëdhënies së punës për tre (3) nëpunës në zëvendësim;



- Komisioni për Zgjidhjen e Kontestave dhe Ankesave ka shqyrtuar dhe ka marrë Vendim për njëzet e dy (22) ankesa;
- Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar dhe ka marrë vendim për një (1) rast KD 01/2017;
- Gjatë vitit 2017, janë realizuar gjithsej 26 trajnime ku numri total i pjesëmarrësve ka qenë 316;
- Janë draftuar dhe aprovuar nga Bordi i Drejtorëve Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci si dhe Rregullorja e Pagave të nëpunësve të AKP-së;
- Përpilimi i Raportit vjetor i Evaluimit të Vlerësimit të Performancës për vitin 2016;
- Përpilimi i Raportit Vjetor të realizimit të Planit të Trajnimeve për vitin 2016;
- Përpilimi i Planit vjetor të Trajnimeve për vitin 2017;
- Është iniciuar procesi i vlerësimit të performancës për periudhën janar – dhjetor 2017, caktimin e objektivave për periudhën janar –dhjetor 2018 si dhe Plani i trajnimit për vitin 2018.

12. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Aktivitetet kryesore për këtë periudhë të raportimit paraqiten për njësitë: Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme, Njësia e Arkivit, Njësia e Përkthimeve, Njësia e Teknologjisë Informative, Njësia e Protokollit dhe Zyra e Transportit.

- Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar dhe proceduar gjithsej **3507** parashtrës, prej tyre **731** kërkesa/lëndë të reja dhe 2862 dokumente/parashtrës shtesë lidhur me lëndët e regjistruara me herët;
- Rreth **32718** fletë janë fotokopjuar lidhur me parashtrësat e lëndëve të Njesisë së përfaqësimeve, për dorëzim në gjykatë;
- Njësia e Përkthimeve ka përkthyer **104 dokumente** me **7,392 faqe** dhe ka siguruar përkthyesit për **33 takime**.
- Njësia e Protokollit: Dokumente hyrëse në këtë zyre 5109 shkresa; Shkresa dalëse nga kjo zyre janë regjistruar 4998;
- Njësia e Teknologjisë Informative: Instalimi i dhe konfigurimi i pajisjeve të reja; Instalimi dhe konfigurimi i Firewallit të Gjeneratës së fundit (3rd Generation Firewall). **Arkivimi i E-mailave (PST)**;
- Njësia e arkivit: Regjistrorë të skanuar, regjistruar dhe arkivuar për Departamentet dhe Njësitë e AKP-së, gjithsej 580;
- Njësia e Shërbimeve të Përgjithshme: Gjatë kësaj periudhe nëntëmujore kemi asistuar në lirim të pronave shoqërore në rajonin e Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Gjilanit dhe Prishtinës, në gjithsej 80 njësi aty ku është shfaqur nevoja; Kemi iniciuar 17 deklarata të nevojave pas analizave dhe hulumtimeve dhe kërkesave për nevoja të ndryshme të AKP-së;
- Njësia e Transportit: Gjatë kësaj periudhe 12 mujore kemi pasur 1025 kërkesa për shërbime të rregullta dhe 1561 shërbime-kërkesa urgjente dhe të cilat janë mbuluar po ashtu.

13. DEPARTAMENTI I FINANCAVE DHE BUXHETIT

Tabelat e paraqitur më poshtë është një përmbledhje e pasqyrave financiare e nxjerrë nga pasqyrat financiare për Buxhetin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Fondet në Mirëbesim. Ndërsa pasqyrat Financiare së bashku me shënimet shpjeguese dhe të cilat janë dorëzuar në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave. Pasqyrat janë dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar nga Rregullorja për Pasqyrat Financiare, e nxjerrë nga Ministria e Financave.

13.1. FINANCIMI I AKTIVITETEVE OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-së

Aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së financohen nga të hyrat e dedikuara të realizuara nga 5% e shitjeve të aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore. Për më tepër shih nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-034 mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pasqyrat financiare janë pjesë e këtij raporti të cilat janë të bashkangjitur në Shtojcë

PËRSHKRIMI	Nr.	BUXHETI ORIGINAL (LIGJI NR. 05/L -125)	BUXHETI I RISHIKUAR GJYSMËVJETOR LIGJIT NR. 06/L -002	BUXHETI DERI NË DATËN 31 DHJETOR 2017	PAGESAT	PROGRESI NË %	PROGRESI NË %
		a	b	c	d	e=d/a	f=d/c
Gjithsej	1+2	7,020,884.00	7,619,804.00	7,582,788.00	6,876,167	98%	91%
Pagat dhe mëditjet		4,402,884.00	4,402,884.00	4,402,884.00	4,390,281	100%	100%
Mallrat dhe Shërbimet		2,380,000.00	2,948,920.00	2,911,904.00	2,349,683	99%	81%
Shpenzimet Komunale		98,000.00	118,000.00	118,000.00	80,912.93	83%	69%
Subvencione & Transferet		40,000.00	50,000.00	50,000.00	41,379.43	103%	83%
Investimet Kapitale		100,000.00	100,000.00	100,000.00	13,910.00	14%	14%
Granti i Përgjithshëm 2017	1	100,000.00	698,920.00	661,904.00	652,959.90	653%	99%
Mallrat & Shërbimet		100,000.00	698,920.00	661,904.00	652,959.90	653%	99%
Të hyrat e dedikuara 2017	2	6,920,884.00	6,920,884.00	6,920,884.00	6,223,207	90%	90%
Pagat dhe mëditjet		4,402,884.00	4,402,884.00	4,402,884.00	4,390,281	100%	100%
Mallrat & Shërbimet		2,280,000.00	2,250,000.00	2,250,000.00	1,696,723	74%	75%
Shpenzimet Komunale		98,000.00	118,000.00	118,000.00	80,912.93	83%	69%
Subvencione dhe Transferet		40,000.00	50,000.00	50,000.00	41,379.43	103%	83%
Investimet Kapitale		100,000.00	100,000.00	100,000.00	13,910.00	14%	14%

13.2. PROCESI I FONDEVE NË MIRËBESIM – NDËRMARRJET SHOQËRORE

PËRSHKRIMI	1	2	3=1+2
	DERI MË 31 DHJETOR 2016	TRANSAKSIONET Hyrje/dalje	GJENDJA DERI MË 31 DHJETOR 17
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE			
<u>Të hyrat nga shitjet</u>	666,082,049	31,087,867	697,169,916
<u>Të hyrat nga qiraja</u>	26,034,444	6,528,207	32,562,651
<u>Interesi i fituar</u>	34,844,700	0.00	34,844,700
<u>Tarifa për pjesëmarrjen në tenderat e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave</u>	7,577,564	652,400	8,229,964
<u>BID depozitat e ofertuesve</u>	592,320	1,438,500	2,030,820
<u>Të hyra të tjera</u>	6,707,317	159,218	6,866,535
<u>Kapitali themeltar i Agjencisë</u>	1,013,200	0.00	1,013,200
GJITHSEJ PRANIMET	742,851,594	39,866,192	782,717,786
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA			
<u>20% i punëtorëve transferuar në BSPK</u>	109,973,567	9,283,737	119,257,304
<u>Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)</u>	14,423,930	996,000	15,419,930
<u>Mallra dhe shërbime</u>	12,186,335	2,194,849	14,381,184
<u>Shërbime publike</u>	1,262,807	731,503	1,994,309
<u>Tatimet</u>	3,288,605	1,723,361	5,011,966
<u>Vendimet e gjykatave/përmbauesve (depozita dhe taksa)</u>	1,774,806	33,405	1,808,211
<u>Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së</u>	32,148,000	6,100,000	38,248,000
<u>Të tjera</u>	715,255	34,286	749,541
<u>Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-së</u>	15,872,028	8,105,856	23,977,884
<u>Fondet tepriçë transferuar Qeverisë</u>	90,244,911	325,664	90,570,575
GJITHSEJ SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	281,890,244	29,528,661	311,418,904
	31 Dhjetor 2016	Hyrje/Dalje	31 Dhjetor 2017
GJENDJA BANKARE	460,961,350	10,337,531	471,298,882

Të dhënat më lartë, paraqesin rezultatet e transaksioneve të realizuara (pranimet dhe pagesat) sipas prerjes deri më datën 31 Dhjetor 2017. P.sh. tek shitja, është vlera e pagesave të realizuara, por jo të kontratave të nënshkruara. Gjithashtu, përveç realizimit të të hyrave sipas dy metodave (Spin Off dhe Shitje të Aseteve përmes Likuidimit) të paraqitura tek nënkaptulli "Shitja e Aseteve" janë realizuar të hyra

të tjera të tilla si: tepriçat e realizuara nga shitja e aseteve të konfiskuara nga ATK-ja, shitje të aksioneve apo të ngjashme, të hyrat nga shitja e banesave apo raste të tjera.

14. DEPARTAMENTI I PROKURIMIT

Ne Departamentin e Prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 janë nënshkruar 38 kontrata duke përdorur të gjitha procedurat e prokurimit në vijim:

- Procedura e prokurimit me vlerë të madhe;
- Procedura e prokurimit me vlerë të mesme;
- Procedura e negociuar pa publikimin e njoftimit për kontratë; si dhe
- Procedura e kuotimit të çmimit me vlerë të vogël dhe vlerë minimale.

Me poshtë gjeni ndarjen e kontratave sipas kategorive:

- Kontratë për shërbime - janë realizuar gjithsej 22;
- Kontratë për furnizime - janë realizuar gjithsej 16.

Janë edhe 6 lëndë prokurimi tjera në proces, që janë bartur në vitin 2018 për të vazhduar me procedurat tjera të prokurimit.

15. DEPARTAMENTI I KOMISIONEVE PROFESIONALE

15.1. KOMISIONI PËR SHITJEN E BANESAVE NË

PRONËSI SHOQËRORE

Komisioni për Shitjen e Banesave në Pronësi të NSH-ve ka pranuar gjithsej 1492 kërkesa për blerje të banesave nga themelimi i tij, prej të cilave deri më tani nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së janë vendosur 1112 kërkesa.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2017, aktivitetet e Komisionit kanë qenë si në vijim;

- Janë shqyrtuar 146 kërkesa dhe janë vendosur nga Bordi i Drejtorëve, nga të cilat:

- 46 kërkesa janë aprovuar si të bazuara;
- 66 kërkesa janë refuzuar si të pabazuara;
- 7 kërkesa janë hedh poshtë si të papranueshme për shkak të jokompetencës lëndore;
- Eshtë pezulluar shqyrtimi i 26 kërkesave për shkak procedurave gjyqësore dhe me fuqi ligjore për transformimin e IMKTrepcanë SH.A.;
- 1 kërkesë është hedhur poshtë si e papranueshme për shkak të mos plotësimit të kushteteve formale për shqyrtim merit.
- Janë përmbyllur 50 Kontrata për Shitjen e banesave;
- Janë dërguar 146 njoftime palëve lidhur me vendimet e Bordit të Drejtorëve;
- Komisioni në vazhdimësi ka realizuar verifikime shtesë sipas detyres zyrtare për secilen kërkesë duke u koordinuar me Agjencinë e Pronës, Zyret Kadastrale, Agjencionin Kadastral, Ndërmarrjen Publike Banesore dhe me gjykatat;
- Është lidhur marrëveshja e mirëkuptimit me Ndërmarrjen Publike Banesore.

Gjatë kësaj periudhe raportuese Komisioni ka pranuar 53 kërkesa të reja për blerjen e banesave.

15.2. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ASETEVE ME

KARAKTER SPECIFIK

- Komisioni gjatë periudhës raportuese ka pranuar gjithsejtë 35 (tridhjetë e pesë) raste të reja.
- Janë aprovuar 36 (tridhjetë e gjashtë) lëndë me konkluzion pa vërejtje nga ana e anëtarëve të Komisionit.
- Janë përgatitur 4 (katër) raporte rekomanduese dhe janë dërguar për shqyrtim në takimet e mbajtura të Bordit të Agjencisë.

Emri	Pranuar	Aprovuar	Refuzuar	Në pritje
Zyra Rajonale në Gjilan	74	41	1	32
Zyra Rajonale në Prishtinë	93	65	/	28
Zyra Rajonale në Mitrovicë	35	28	/	07
Zyra Rajonale në Prizren	84	18	/	66
Zyra Rajonale në Pejë	33	18	/	15
GJITHSEJT	319	170	1	148

15.3. KOMISIONI PËR CAKTIMIN E STATUSIT


TËNDËRMARRJEVE – KPS

Gjatë periudhës raportuese Komisioni ka mbajtur 30 (tridhjetë) takime dhe ka miratuar njëzetetë (23) raporte përmbledhëse të SDR-ve, të cilat i ka referuar në BD për aprovim.

15.4. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN

E LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE

Gjatë periudhës raportuese, është iniciuar shpërndarja e pjesës së 20% për punëtorët e kualifikueshëm të NSh-ve në shumë të përgjithshme prej EUR 9,283,737, kurse kanë përfituar nga shpërndarja e fondeve të 20% gjithsej 10,231 punëtorë të 71 Ndërmarrjeve Shoqërore. Ndërsa, bilanci i pagesave të realizuara nga llogaritë e NSh-ve në llogarinë e BSPK-së për periudhën 1 Janar - 31 Dhjetor 2017 është EUR 9,283,737 nga llogaritë e fondeve në mirëbesim në të mirë të llogarisë të BSPK-së.



*Në vitin 2012 ka ndodhur shpërndarja e 20%-it për punëtorët NSh "Sharrcem" dhe NSh Ratar. Vetëm për këto dy NSh janë shpërndarë rreth EUR 6 milion.

Tabela 1. Listat fillestare të publikuara për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017

Nr.	NR. ID	Emri i NSh-së	Regjioni	Numri i punëtorëve
1	PRN072	"Engineering" në Prishtinë	Prishtinë	34
2	PEJ197	Barnatoret e Gjakovës në Gjakovë	Pejë	14
3	MIT030	"Teuta" në Bare	Mitrovicë	0
4	PEJ042	KB "Leshani" në Leshan	Pejë	1
5	GJI052	Stacioni i Veterinës, në Shtërpcë	Gjilan	3
6	GJI027	KB "Zhivko Vasiq" në Ranilluk	Gjilan	0
7	PRN072	KB "Dumnica"	Prishtinë	15
8	MIT016	Betonjerka	Mitrovicë	50
9	PRZ018	Unimont	Prishtinë	114

Tabela 2. Listat finale të publikuara për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017

Nr.	NR. ID	Emri i NSh-së	Regjioni	Numri i punëtorëve
1	GJI152	Stacioni i vetrines-Shterpcë	Gjilan	3
2	PRN072	EUP Injineriing	Prishtinë	34
3	PEJ197	Barnatoret-Gjakovë	Pejë	11
4	PEJ042	KB Leshan	Pejë	1
5	PRN072	KB Dumnica	Prishtinë	15

Tabela 3. Listat që janë pranuar nga BSPK dhe ende janë në shqyrtim nga KShLFP për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017:

Nr.	NR. ID	Emri i NSh-së	Regjioni	Numri i punëtorëve
1	MIT013	“Kristal”, në Laposaviq	Laposaviq	0
2	MIT051	“Univerzal”, në Laposaviq	Laposaviq	0
3	PEJ106	“Mofast”, në Pejë	Pejë	24
4	PRZ018	“Unimont” në Prizren	Prizren	94
5	MIT016	“Betonjerka” në Mitrovicë	Mitrovicë	63
6	GJI027	KB “Zhivko Vasiq” në Ranilluk	Gjilan	0

15.5. KOMISIONI PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

NDAJ LISTAVE TË 20% TË PUNËTORËVE

- Janë përgatitur pesë Raporte të shqyrtimit të ankesave në listat e 20% të punëtorëve, të cilat janë aprovuar në Komision, dhe janë propozuar për aprovim përmes Menaxhmetit në Bord.
- Janë përgatitur dy Raporte të shqyrtimit të komisionit me propozimin për anulimin e dy ftesave për aplikim të punëtorëve.
- Përgatitja e njoftimit (për publikim) për anulimin e dy ftesave (sipas Vendimit- udhëzimit të DHPGJSK janë anuluar ftesat).
- Përgatitja e katër Vendimeve (në gjuhën shqipe dhe serbe), për punëtorët të cilëve ju është refuzuar ankesa nga ana e KSHALP-së.

16. NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) me sukses ka arritur që të përmbushë planin e vet të punës për periudhën Janar-Dhjetor 2017, duke i ofruar menaxhmentit të lartë rekomandime konkrete.

Në vazhdimësi paraqiten aktivitetet e NJAB-së gjatë kësaj periudhe:

1. **Auditimi i Autoriteteve të Likuidimit (AL);**
2. **Auditimi i Departamentit Ligjor (DL);**
3. **Auditimi i Departamentit të Administratës (DA);**
4. **Auditimi i Njesisë për Marrëdhënie me Publikun dhe Medie (NJMPM);**
5. **Auditimi i Departamentit të Koordinimit Rajonal (ZR e Gjilanit dhe ZR e Prizrenit);**
6. **Auditimi i Departamentit të Prokurimit;**
7. **Auditimi i Departamentit të Shitjes;**
8. **Auditimi i Departamentit të Financave dhe Buxhetit;;**
9. **Mbajtja e takimeve të Komitetit të Auditimit:** Gjatë periudhës raportuese Komiteti i Auditimit ka mbajtur katër takime;
10. **Përgatitja e raporteve mbi aktivitetet e NJAB-it** për Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm (NJQHAB): Duke iu referuar kërkesave ligjore, në muajin Janar, NJAB ka përgatitur dhe dorëzuar tek NJQHAB-ja raportet mbi aktivitetet e saj për vitin 2016. Po ashtu gjatë periudhës raportuese NJAB-ja ka bërë raportimin e saj të rregullt tremujor mbi aktivitetet kryera të saj;
11. **Përgatitja e planit të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2018:** Gjatë periudhës raportuese është përgatitur Plani i punës së NJAB-it për vitin 2018, së bashku me strategjinë e rishikuar për periudhën 2018-2020. Këto dokumente, sipas procedurave janë aprovuar nga ZKA-ja, Komiteti i Auditimit si dhe Bordi i Drejtorëve;
12. **Hartimi i regjistrit të rrezikut të AKP-së për vitin 2017:** Gjatë periudhës raportuese është azhurnuar regjistri i rrezikut të Agjencisë dhe i njëjti është harmonizuar me objektivat e AKP-së për vitin 2017;
13. **Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) për AKP-në dhe Fondet në Mirëbesim nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA):** Gjatë periudhës raportuese, Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare të AKP-

së dhe Fondeve në Mirëbesim, për vitin 2016. Në muajin Qershor, nga ZKA-ja kemi pranuar raportet finale të auditimit të PVF-ve të Fondeve në Mirëbesim dhe AKP-së për vitin 2016. Po ashtu, gjatë periudhës raportuese (gjatë periudhës Shtator-Nëntor), Ekipi i Auditimit të ZKA-së ka kryer auditimet e ndërmjetme të PVF-ve të AKP-së dhe Fondeve në Mirëbesim për vitin 2017. ZKA-ja në fund të këtyre auditimeve të ndërmjetme ka lëshuar dy memo të auditimit, ku janë dhënë disa këshilla lidhur me çështje të caktuara që kryesisht kanë të bëjnë me Pasqyrat Financiare;

14. **Përgatitja e Planit të veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2016:** Duke iu referuar kërkesave ligjore, pas pranimit të raporteve të auditimit nga ZKA-ja, në bashkëpunim me Menaxhmentin është përgatitur Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitin 2016. Ky plan, konform procedurave është dorëzuar tek ZKA-ja brenda afateve të përcaktuara ligjore;
15. **Pjesëmarrja në punëtoritë e organizuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK) dhe OSBE-ja:** Përfaqësues të NJAB-it kanë marrë pjesë në punëtoritë e organizuar nga AKK-ja lidhur me hartimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit për periudhën 2018-2022, si dhe në disa punëtori të organizuara nga OSBE-ja lidhur programin “Zhvillimi i kapaciteteve të agjencive të Kosovës dhe të prokurorisë speciale për të luftuar korrupsionin e nivelit të lartë”;
16. **Përgatitja e objektivave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Strategjinë Kundër Korrupsionit 2018-2023:** Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur komentet lidhur me objektivat e AKP-së për Strategjinë Kundër Korrupsionit 2018-2023, si dhe të njëjtat komente janë dorëzuar në AKK.

17. REKOMANDIMET PËRMBLEDHËSE PËR TË ARDHMEN

Agjencia, sa i përket kompetencave të saj, i ka përmbushur të gjitha objektivat sipas planit për vitin 2017 dhe atë:

- Planin e Riorganizimit;
- Fillimin e procesit të Shitjes – shpalljen e shitjeve. Strategjia që çdo muaj të shpallen shitjet e cila ka filluar që të implementohet nga tremujori i fundit të vitit 2016;
- Monitorimin e shitjeve me “Spin Off Special” dhe Kushte të veçanta;
- Shpërndarjen e 20% të punëtorëve; dhe
- Shpërndarjen e kreditorëve.

Për periudhën e ardhshme, Agjencia Kosovare e Privatizimit rekomandon që të ndërmerren veprimet nga Qeveria apo Kuvendi lidhur pesë veprimet e mëposhtme të cilat janë për përmbushjen e misionit sipas Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Pikat e paraqitura më poshtë që AKP-ja rekomandon të trajtohen me prioritet janë si më poshtë:

1. Mënyra e Financimit të aktiviteteve të AKP-së. Aktualisht AKP-ja financohet nga të hyrat e dedikuara sipas nenit 21 të Ligjit nr. 04/L-034. Sipas këtij neni, 5% e të shitjeve janë të hyra të dedikuara. Maksimum, deri në gjysmë-vjetorin e parë të vitit 2018, AKP-ja do të ketë mjete në dispozicion për të mbuluar aktivitetet e saja operative dhe administrative. AKP-ja sugjeron që të trajtohet me prioritet mënyra e financimit të aktiviteteve të AKP-së apo të ndryshohet neni 21 i Ligjit të AKP-së nga 5% në 7%.
2. Ngritjen e kapaciteteve në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Gjykatave Themelore. Ngritja e kapaciteteve ndikon në çështjet e mëposhtme:
 - 1.1. Shitja - Kontestet gjyqësore të pronësisë;
 - 1.2. 20% e punëtorëve - Realizimin e shpërndarjes të tërë 20% të punëtorëve pas zgjidhjes të kontesteve gjyqësore të ankesave;

- 1.3. Shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve – Zgjidhjen e pretendimeve të kreditorëve. Zgjidhja e këtyre kontesteve mundëson përmbylljen e procesit të likuidimit.
2. Emërimin e anëtarëve të rinj apo aktual të Bordit të Drejtorëve. Mandati i anëtarëve të Bordit të Drejtorëve skadon në Dhjetor 2017, përveç Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit që kanë mandat deri në Dhjetor 2018:
 - 2.1. Shitjen e aseteve - i gjithë procesi i shitjes nga shpallja deri në nënshkrimin e kontratës është i lidhur me Bordin e Drejtorëve;
 - 2.2. Realizimin e pagesave të 20% të punëtorëve;
 - 2.3. Shpërndarjen e mjeteve ndaj kreditorëve dhe përmbylljen e procesit të likuidimit.
3. Vendorsjen e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në lokalitete tjera. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare aktualisht janë duke i shfrytëzuar asetet me qira të Ndërmarrjeve Shoqërore;
4. Komunitat të jenë më bashkëpunues apo të miratohet një rezolutë nga Kuvendi, si një mekanizëm e cila do të obligonte komunitat që të jenë bashkëpunues me të gjitha shërbimet të cilat ndërlidhen me asetet e Ndërmarrjeve Shoqërore.

18. RAPORTI I ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE NGA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT


Më poshtë po paraqesim vetëm një raport Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA) për tre vitet e përmbledhës të adresimit të rekomandimeve të fundit.

	1	2	3	4	5= sum(1:4)	1	2	3	4	5= sum(1:4)
Viti	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej	Tejkaluar	Zbatuar	Jo	Pjesërisht	Gjithsej
2013	3	19	1	2	25	12%	76%	4%	8%	100%
2014	5	16	1	3	25	20%	64%	4%	12%	100%
2015	2	14	0	6	22	9%	64%	0%	27%	100%
2016	2	7	0	10	19	11%	37%	0%	53%	100%
Gjithsej	12	56	2	21	91	13%	62%	2%	23%	100%

Detajet për planin e zbatimit të rekomandimeve për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016 të Zyrës Kombëtare të Auditimit janë të shpalosura në shtojcën të raportit vjetor të AKP-së.

19. STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

versioni:
27 Prill 2017



20. SHTOJCAT E RAPORTIT VJETOR TË AKP-së

- 20.1. Neni 6.1 - Lista e ndërmarrjeve nën Administrim Direkt
- 20.2. Neni 9 –Përmbledhja e transaksioneve sipas valëve
- 20.3. Neni 9 – Lista e ndërmarrjeve të likuiduara
- 20.4. Pjesa tekstuale e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës (shtojcë)
- 20.5. Pjesa tabelare e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për buxhet dhe financa të Kuvendit të Kosovës (shtojcë)
- 20.6. Pasqyrat financiare të buxhetit vjetor të agjencisë (shtojcë)
- 20.7. Pasqyrat financiare të fondeve në mirëbesim (shtojcë)
- 20.8. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të ZKA-së për vitet 2014, 2015, 2016 (shtojcë)

SHTOJCA 20.1. NENI 6.1- LISTA E NDËRMARRJEVE NËN ADMINISTRIM DIREKT

Nr.	Emri i NSH-së	Vendi	Data e hyrjes nën administrim direkt
1	NSh "Ereniku- Industria"	Gjakovë	22 Qershor 2011
2	NSh "Boksitet e Kosovës"	Klinë	20 Janar 2012
3	MIM Golesh	Lipjan	31 Gusht 2014
4	Nsh" Izgradnja"- Ilirial	Pejë	31 Mars 2017
5	Nsh" Virxhinia"	Gjakovë	25 Shtator 2017
6	Nsh" Jatex"	Gjakovë	25 Shtator 2017
7	Nsh" Metaliku"	Gjakovë	25 Shtator 2017
8	Nsh" Metaliku – Ena"	Gjakovë	25 Shtator 2017

SHTOJCA 20.2. NENI 9 –PËRMBLEDHJA E TRANSAKSIONEVE SIPAS VALËVE

Shitja përmes Likuidimit	Nr. i Aseteve	Nr. i Ofertave të Pranuara	Gjithsej Vlera e Ofertave Fituese	Tërheqjet, Anulimet	Gjithsej Vlera	Nr. i Aseteve të anuluar nga BiD, tërheqjet	Kontratat e realizuara	Shitjet e parealizuara - në proces
27	53	216	5,840,724	1,450,194	4,390,530	6	43	0
28	57	187	7,011,141	764,180	6,246,961	8	36	1
29	51	155	4,587,933	1,524,991	3,062,942	12	24	2
30	59	88	3,986,159	1,766,099	2,220,060	18	13	0
31	65	88	2,821,273	1,510,586	1,310,687	13	18	0
32	74	65	3,334,668	1,629,864	1,704,804	22	08	1
33	90	137	4,439,690	2,091,442	2,348,248	28	18	0
34	78	110	3,919,412	943,503	2,975,909	15	19	1
35	64	151	7,401,518	1,033,284	6,368,234	19	10	16
36	105	156	4,687,401	687,457	3,999,944	18	13	14
37	100	131	4,884,029	229,068	4,654,961	5	07	34
38	120	371	13,632,676	2,000,540	11,632,136	24	00	50
Gjithsej	916	1,855	66,546,624	15,631,208	50,915,416	188	209	119

SHTOJCA 20.3. NENI 9 – LISTA E NDËRMARRJEVE TË LIKUIDUARA

Nr.	Komuna	Emri i NSH-së	Kategoria	Data e fillimit të procesit të likuidimit	Data e prezantimit të raportit përfundimtar në bordin e akp-së	Data e prezantimit të raportit përfundimtar në DHPGJS	Aktevendimi i dhpjgs për mylljen e likuidimit
1	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Gaçkë"	Pa asete / Pa Kërkesa kreditore	10 mars 2014	23 nëntor 2016	25 janar 2017	5 prill 2017
2	Ferizaj	Kooperativa Bujqësore "Agrokultura"	Pa asete / Pa kërkesa kreditore	10 mars 2014	30 mars 2017	11 prill 2017	21 qershor 2017
3	Han i Elezit	Ndërmarrja Shoqërore "16 Nëntori"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	10 mars 2014	27 prill 2017	2 maj 2017	21 qershor 2017
4	Prizren	Ndërmarrja Shoqërore "Ndërtimi"	Pa asete / Me kërkesa kreditore	9 dhjetor 2013	25 maj 2017	6 qershor 2017	31 korrik 2017

Shtojca 20.4. pjesa tekstuale e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT -Raporti Financiar për vitin 2017-

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ: Ekrem Hajdari, Rr. Agim Ramadani Nr. 23, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail:Ekrem.Hajdari@pak-ks.org

Zyrtari Kryesor Financiar: Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Rr. Agim Ramadani Nr. 23, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400, E-mail: adem.selishta@pak-ks.org

1) Hyrje: *Ju lutem paraqitni në formë tekstuale një përmbledhje të zhvillimeve kryesore në buxhetin e organizatës suaj. Të mos kalohet hapësira e ofruar më poshtë!*

Për vitin 2017 buxheti i Agjencisë është financuar nga:

1. Të Hyrat e Dedikuara (aktivitetet operative dhe administrative të AKP-së).
2. Fondi i Përgjithshëm Qeveritar (Studimi i Fizibilitetit të Trepçës).

AKP, në kërkesën buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave nga Granti Qeveritar (GQ) për vitin 2017 për Riorganizimin e Trepçës ka kërkuar mjete në shumë prej EUR 698,920.00. Qëllimi i mjeteve të kërkuara ka qenë mbështetja e punëve të nevojshme për përgatitjen e Planit të Riorganizimit të Trepçës dhe në veçanti angazhimi i OShP-së për Studimin e Fizibilitetit të Trepçës i cili është iniciuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Pavarësisht kërkesës së AKP-së, Ministria e Financave fillimisht nuk kishte aprovuar kërkesën buxhetore në tërësi, mirëpo gjatë procesit të rishikimit gjysmë vjetor sipas Ligjit të buxhetit Nr. 06/L-002, buxheti nga Granti Qeveritar (GQ) është rritur për EUR 598,920.00, ndërsa me datën 15 Dhjetor 2017, Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim për kursime buxhetore (vendimi Nr. 10/19) dhe ka reduktuar buxhetin nga Granti Qeveritar në shumë prej EUR 37,016.

Buxheti përfundimtar më 31 dhjetor 2017, pas procesit të rishikimit dhe kursimeve buxhetore është gjithsej EUR 661,904.

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

a) Të hyrat:

Burim kryesor i financimit për aktivitetet e Agjencisë për vitin 2017 janë të Hyrat e Dedikuara dhe Fondi i Përgjithshëm Qeveritar.

Pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri të AKP-së (Ligjit nr. 04/L-034), AKP ka filluar të mbuloj shpenzimet e saj administrative dhe operative nga Të Hyrat e Dedikuara.

Fondi i përgjithshëm Qeveritar apo Granti Qeveritar është burim i financimit për të mbuluar aktivitetet që nuk ndërlidhen në mënyrë direkte me Agjencinë, mirëpo mbulohen shpenzimet që kanë të bëjnë me riorganizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore e në këtë rast është vetëm Riorganizimi i NSh Trepça.

Thesari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave ka hapur llogarinë me emër AKP Privatizimi Tarifa Administrative dhe numër të llogarisë 1000400070004642. Ndërsa Agjencia alokon buxhetin e aprovuar në llogarinë e sipër shënuar të Thesarit (për financimin e aktiviteteve të Agjencisë) nga llogaria AKP TARIFA ADMINISTRATIVE me numër të llogarisë 1000501000045681 në Bankën Qendrore të Kosovës.

b) Pagat dhe mëditjet:

(Ju lutem të bashkëngjitet organogrami i organizatës suaj si aneks i këtij raporti financiar dhe plotësoni tabelën shtesë lidhur me strukturën e pagesës në pikën 4 f) të këtij raporti.)

Për periudhën Janar – Dhjetor 2017, burim i financimit dhe i pagesave për paga dhe mëditje kanë qenë të hyrat e dedikuara.

Mjetet buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2017 kanë qenë të aprovuara për gjithsej 258 punëtor. Numri aktual i të punësuarve me orar të plotë në fund të periudhës 2017 është 238. Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Ministrisë së Administratës Publike, në të cilën, AKP-ja dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse. Ministria e Administratës Publike pas analizave përcjell informatat tek Ministria e Financave e cila procedon pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

c) Mallra dhe Shërbime:

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime kanë qenë të destinuara për:

- Ofrimin sa më të mirë të shërbimeve teknike dhe logjistike të duhura dhe me kohë në mënyrë që të arrihen objektivat e parapara të Agjencisë sipas Ligjit.
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të privatizimit dhe Likuidimit.
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit.
- Për mbulimin e shpenzimeve për ofrues të shërbimeve profesional.
- Për të mbështetur riorganizimin e Ndërmarrjes Shoqërore “Trepça nën Administrimin e AKP-së”.

Ndryshimet buxhetore në këtë kategori janë vetëm nga Grandi Qeveritar i cili është ndarë ekskluzivisht për Riorganizimin e NSh- Trepça.

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ka qenë EUR 100.000.00. Gjatë rishikimit sipas Ligjit të buxhetit Nr. 06/L-002, buxheti nga Granti Qeveritar (GQ) është rritur për EUR 598,920.00.

d) Shpenzime komunale:

Për periudhën raportuese, burim i financimit për shërbime komunale janë të hyrat e dedikuara (THD) të Agjencisë. Pagesat e shërbimeve publike përfshijnë të gjitha pagesat e bëra për zyrën Qendrore dhe zyrat regjionale të AKP-së.

Gjithsej shuma e buxhetuar për shërbimet komunale në fillim të vitit ka qenë EUR 98,000.00.

Duke u bazuar në faturat e rrymës të gjashtë mujorit të parë të vitit dhe për të siguruar likuiditet në këtë kategori pranë MF kemi paraqitur kërkesën për rialokim të mjeteve brenda programit buxhetor të Administratës Qendrore në shumë prej 20,000€.

Buxheti përfundimtar për këtë kategori është 118.000 EUR, ndërsa shpenzimi është gjithsej 80,913 EUR.

e) Investimet Kapitale:

Për vitin 2017 kanë qenë tri projekte kapitale të aprovuara:

1. Pajisjet mbi EUR 1,000 brenda shpenzimeve kapitale;
2. Riparimi i ndërtesës së AKP-së dhe Zyrave Rajonale; dhe
3. Blerja e veturave zyrtare.

Gjatë periudhës raportuese, është realizuar vetëm një pagesë prej EUR 13,910 për furnizim me pasie të IT-së.

Buxheti i aprovuar në vlerë prej EUR 75,000.00 për blerjen e veturave zyrtare nuk është shpenzuar për arsye se Agjencia Qendrore e Prokurimit sipas Udhëzimit Administrativ të aprovuar nga Qeveria e Kosovës ka iniciuar dhe ka zhvilluar procesin e prokurimit për furnizim me vetura në emër të gjitha autoriteteve kontraktuese të nivelit qendror dhe lokal. Ky tender ende është në proces të vlerësimit nga komisioni i AQP-së. Gjithashtu edhe buxheti i aprovuar në shumë prej EUR 5,000.00 për Riparimin e ndërtesës së AKP-së dhe Zyrave Rajonale nuk është shpenzuar për arsye se nuk kemi lëvizur në objektin e ri.

f) Subvencionet dhe Transferet:

Qëllimi i fondeve të aprovuara për vitin 2017 ka qenë për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit si më poshtë:

- Ndërmarrjet Shoqërore që janë nën Administrim Direkt ushtrojnë veprimtari të ndryshme. Disa Ndërmarrje për shkak të gjendjes jo të mirë financiare kanë vështirësi ta ushtrojnë aktivitetin e veprimtarisë primare. Por disa prej tyre në vazhdimësi e kryejnë aktivitetin e veprimtarisë primare;
- Ruajtja dhe rritja e vlerës së aseteve të ndërmarrjeve para privatizimit;
- Përzgjedhja e menaxhmentit i cili do të ushtroj në mënyrë efikase aktivitetin e ndërmarrjeve dhe rritjen e vlerës të aseteve të Ndërmarrjeve;

Në disa raste duhet bërë pagesa e subvencioneve për menaxhment dhe roje me të vetmin qëllim që kjo të ndikoj në një efikasitet të shtuar në ndërmarrje dhe rritje të vlerës së tyre.

3) Përmbledhje:

(Ju lutem paraqitni shkurtimisht vërejtjet përfundimtare lidhur me buxhetin e institucionit tuaj apo pikëpamjet për zhvillimin në të ardhmen)

Buxheti i AKP-së i aprovuar nga Kuvendi (Ligji Nr. 05/L-125) në fillim të vitit 2017 ka qenë gjithsej 7,020,884 EUR dhe është financuar nga;

- a) Të hyrat e dedikuara EUR 6,920,884 si dhe;
- b) Nga granti Qeveritar EUR 100,000 .

Buxheti përfundimtar në fund të vitit është gjithsej EUR 7,582,788.

- a) Të hyrat e dedikuara EUR 6,920,884 si dhe;
- b) Nga granti Qeveritar EUR 661,904.

Ndryshimet e buxhetit përfundimtar janë rezultat i rritjes së buxhetit gjatë procesit të rishikimit nga Granti Qeveritar. Realizimi i buxhetit është për vitin fiskal 2017 është gjithsej 91%.

Agjencia sa i përket buxhetit të aprovuar fillestar dhe atij përfundimtar nuk ka pasur vërejtje.

Agjencia Kosovare e Privatizimit

20.5 Pjesa tabelare e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa

4) TABELAT

a) Të hyrat:

Kodi ekonomik	Emri i kategorisë ekonomike	Të hyrat e planifikuara/parashikuara për vitin 2017	Të hyrat vetanake të bartura nga viti 2016	Të hyrat aktuale në vitin 2017
1	2	3	4	5
11000	Pagat dhe medijtjet	4,402,884.00	-	4,402,884.00
13000	Mallrat dhe Sherbimet	2,380,000.00	-	2,911,904.00
13200	Sherbimet publike	98,000.00	-	118,000.00
21000	Transferet dhe Subvencionet	40,000.00	-	50,000.00
30000	Shpenzimet kapitale	100,000.00	-	100,000.00
	GJITHSEJ	7,020,884.00	-	7,582,788.00

Përfshinë edhe Grantin Qeveritar në shumën prej EUR 698,920 të transferuar nga Qeveria e Kosovës për pagesën ndaj OShP-së për studimin e fizibilitetit për Trepçën.

Agjencia Kosovare e Privatizimit financohet nga të hyrat e dedikuara që ka realizuar nga shitja e asetëve të NSh-ve si dhe të hyrat e tjera. Kjo në përputhje me nenin 21 të Ligjit nr. 04/L-036 I cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011

Të hyrat për Agjencinë janë kumulative nga viti 2003 deri në dhjetor 2017. Gjithsej të hyrat janë **EUR 43,636,465 dhe prej të cilave janë financuar aktivitetet e saj nga viti 2012. Gjithsej mjetet e transferuara në Qeveri për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative deri më 31 dhjetor 2017 janë EUR 36,448,000. Gjithashtu nga këto të hyra janë financuar edhe shpenzimet për NSh-të që kanë mungesë të likuiditetit bankar.**

SQARIM:

AKP-ja **NUK** planifikon të hyra të cilat buxhetohen me kërkesë në Ministrinë e Financave. AKP-ja planifikon vetëm shpenzimet, të cilat janë prezentuar në tabelën më lartë. Pra, të hyrat nuk planifikohen si në rastin e komunave, meqenëse siç kemi shpalosur në shpjegimin më lartë, të hyrat e AKP-së janë kumulative nga viti 2003 e tutje sipas nenit 21 të Ligjit të AKP-së, i cili ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2011.

Të hyrat e realizuara gjatë vitit 2017 janë **EUR 3,018,473** nga shitjet e asetëve të NSh-ve përmes valëve të privatizimit dhe të hyrave tjera të tilla si: tarifa për pjesëmarrje në tender si dhe konfiskimet e BID depozitave për ofertuesit të cilët nuk kanë përmbushur kushtet e përcaktuara.

b) Shpenzimet:

Kodi ekonomik	Kategoria ekonomike	Buxheti dhe shpenzimet 2016			Buxheti vjetor me ligjin e buxhetit 2017	Buxheti me rishikim 2017	Buxheti Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet deri me 31 Dhjetor 2017	Zotimet deri më 31 Dhjetor 2017	Buxheti i zotuar (%)	Buxheti i shpenzuar (%)	Buxheti i pa shpenzuar (%)
		Buxheti 2016	Shpenzimet 2016	% e shpenzimeve								
1	2	3	4	5	6	7	8	9=8/6	10=7/6	11		
11000	Pagat dhe medijtjet	4,453,484	4,402,591	98.86%	4,402,884	4,390,281	4,390,281	99.71%	99.71%	0.29%		
13000	Mallra dhe shërbime	2,537,760	1,745,292	68.77%	2,380,000	2,349,683	2,507,733	86.12%	80.69%	19.31%		
13200	Shërbimet publike	98,000	73,594	75.10%	98,000	118,000	80,913	69.63%	68.57%	31.43%		
21000	Subvencione dhe transfere	90,000	78,809	87.57%	40,000	50,000	41,379	82.76%	82.76%	17.24%		
30000	Shpenzimet kapitale	30,000	12,603	42.01%	100,000	100,000	13,910	13.91%	13.91%	86.09%		
	GJITHSEJT	7,209,244	6,312,890	87.57%	7,020,884	7,619,804	6,876,167	7,035,467	92.78%	90.68%	9.32%	

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzimev e	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
	Gjithsej	2,537,760	1,745,292	69%	2,911,904	2,349,683	81%
1310	SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NENTOTALI)	13,000	7,040	54%	25,500	14,985	59%
13130	Shpenzimet e Udhëtitimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13131	Meditja e udhëtitimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13132	Akomodimi gjatë udhëtitimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	-	-	-
13133	Shpenzimet tjera të udhëtitimit zyrtar brenda vendit	-	-	-	2,250	856	38%
13140	Shpenzimet e Udhëtitimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	12,000	11,478	96%
13141	Meditja e udhëtitimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	1,250	167	13%
13142	Akomodimi gjatë udhëtitimit zyrtar jashtë vendit	6,000	2,386	40%	10,000	2,484	25%
13143	Shpenzimet tjera të udhëtitimit zyrtar jashtë vendit	7,000	4,654	66%	-	-	-
1330	SHËRBITIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NENTOTALI)	75,142	49,322	66%	70,100	47,221	67%
13310	Shpenzimet për internet	5,000	3,456	69%	11,300	3,130	28%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	59,242	44,143	75%	45,400	41,083	90%
13330	Shpenzimet postare	10,900	1,723	16%	13,400	3,008	22%
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik	-	-	-	-	-	-
1340	SHPENZIMET PËR SHËRBITIME (NENTOTALI)	1,164,388	901,531	77%	1,715,781	1,455,801	85%
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	33,000	17,363	53%	30,000	23,394	78%
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures	26,330	6,181	23%	28,300	2,425	9%
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore	-	-	-	-	-	-
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse	494,100	348,898	71%	375,800	375,387	100%
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	3,200	1,731	54%	9,000	194	2%
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera	583,843	519,699	89%	1,252,081	1,045,953	84%
13470	Shërbime Teknikë	23,915	7,659	32%	20,600	8,448	41%
13480	Shpenzimet për Antarësim	-	-	-	-	-	-
1350	BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NENTOTALI)	75,900	58,457	77%	42,600	29,348	69%
13501	Mobilje (me pak se 1000 euro)	19,700	6,908	35%	7,600	225	3%
13502	Telefona (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13503	Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	14,500	14,158	98%	-	-	-
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	40,200	36,311	90%	27,000	26,503	98%
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13506	Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13507	Pajisje të shërbimit policor (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13508	Pajisje trafiku (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	-	-
13509	Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	1,500	1,080	72%	8,000	2,620	33%

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzimev e	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
1360	BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHERBIME (NENTOTALI)	89,800	63,134	70%	92,300	73,304	79%
13610	Furnizime për zyrë	49,700	38,851	78%	45,000	41,245	92%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	18,000	14,944	83%	29,300	25,157	86%
13630	Furnizime mjekësore	-	-		-	-	
13640	Furnizime pastrimi	22,100	9,339	42%	10,000	6,902	69%
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-		8,000	-	
13660	Akomodimi	-	-		-	-	
13670	Municion dhe armë zjarri	-	-		-	-	
13680	Tiketë sigurorese(banderollat)	-	-		-	-	
13681	Bllombat	-	-		-	-	
1370	DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NENTOTALI)	124,100	60,475	49%	95,900	68,642	72%
13710	Vaj	100	21	21%	4,500	709	16%
13720	Nafte per ngrohje qendrore	53,000	35,204	66%	46,000	37,330	81%
13730	Vaj per ngrohje	-	-		-	-	
13740	Mazut	-	-		-	-	
13750	Qymyr	-	-		-	-	
13760	Dru	-	-		-	-	
13770	Derivate per gjenerator	22,000	1,264	6%	11,200	2,408	21%
13780	Karburant per vetura	49,000	23,986	49%	34,200	28,195	82%

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzimev e	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
1380	ILLOGARITE E AVANSIT (NENTOTALI)	-	-		15,000	-	
13810	Avans per para te imeta (p.cash)	-	-		-	-	
13820	Avans per udhetime zyrtare	-	-		-	-	
13821	Avanc	-	-		15,000	-	
13830	Avans per mallra dhe shërbime	-	-		-	-	
13850	Avanc - per ambasadat	-	-		-	-	
1390	SHËRBIMET FINANCIARE (NENTOTALI)	-	-		-	-	
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore	-	-		-	-	
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank	-	-		-	-	
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke	-	-		-	-	
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit	-	-		-	-	
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike	-	-		-	-	
13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina	-	-		-	-	
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme	-	-		-	-	
13940	KPA-Provizioni Bankar	-	-		-	-	
1395	SHERBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NENTOTALI)	26,000	11,880	46%	16,000	7,049	44%
13950	Regjistrimi i automjeteve	5,000	3,125	63%	6,620	150	2%
13951	Sigurimi i automjeteve	10,000	8,405	84%	9,000	6,899	77%
13952	Taksa komuale e regjistrimit te automjeteve	1,000	350	35%	380	-	
13953	Sigurimi i ndertesave dhe tjera	10,000	-		-	-	
1400	MIRËMBAJTJA (NENTOTALI)	94,536	49,934	53%	77,913	49,668	64%
14010	Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve	51,070	20,710	41%	40,500	30,963	76%
14020	Mirembajtja e ndertesave	5,000	651	13%	2,000	529	26%
14021	Mirembajtja e ndertesave te banimit	-	-		-	-	
14022	Mirembajtja e ndertesave administrative afariste	-	-		-	-	
14023	Mirembajtja e shkollave	-	-		-	-	
14024	Mirembajtja e objekteve shendetesore	-	-		-	-	
14030	Mirembajtja e auto rrugeve	-	-		-	-	
14031	Mirembajtja e auto rrugeve regjionale	-	-		-	-	
14032	Mirembajtja e auto rrugeve lokale	-	-		-	-	
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	22,813	14,035	62%	18,913	17,681	93%
14050	Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve	15,653	14,538	93%	16,500	495	3%
1410	QIRAJA (NENTOTALI)	414,940	414,334	100%	417,810	412,450	99%
14110	Qiraja per ndertesave	414,940	414,334	100%	247,500	242,140	98%
14120	Qiraja per toke	-	-		-	-	

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzimev e	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
14130	Qiraja per paisje	-	-		-	-	
14140	Qiraja per makineri	-	-		-	-	
14150	Qiraja për pordorime tjera hapësinore	-	-		170,310	170,310	100%
1420	SHPENZIMET E MARKETINGUT (NENTOTALI)	428,954	103,295	24%	298,900	181,592	61%
14210	Reklammat dhe konkurset	10,000	5,988	60%	4,800	2,769	58%
14220	Botimet e publikimeve	409,404	88,768	22%	12,000	5,389	45%
14230	Shpenzimet per informim publik	9,550	8,539	89%	282,100	173,434	61%
1430	SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NENTOTALI)	-	-	0%	10,000	6,216	62%
14310	Drekat zyrtare	-	-		10,000	6,216	62%
1440	SHPENZIME-VENDIMET EGJYKATAVE (NENTOTALI)	31,000	25,890	84%	34,100	3,407	10%
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave	31,000	25,890	84%	34,100	3,407	10%
1700	SERVISIMI I BORGJIT (NENTOTALI)	-	-		-	-	
17000	Pagesa e borgjit qeveritar	-	-		-	-	

4.d) SHPENZIMET KOMUNALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

13000	Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
	Gjithsej	98,000	73,594	75%	118,000	80,913	69%
1320	SHPENZIME KOMUNALE (NENTOTALI)	98,000	73,594	75%	118,000	80,913	69%
13210	Rryma	61,300	61,034	100%	79,500	66,168	83%
13220	Uji	6,500	4,968	76%	6,500	6,204	95%
13230	Mbeturinat	4,200	3,045	73%	6,000	3,233	54%
13240	Ngrohja qendrore	-	-		-	-	
13250	Shpenzimet telefonike	26,000	4,547	17%	26,000	5,308	20%

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

30000	INVESTIMET KAPITALE	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzime ve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzime ve
	Gjithsej	30,000	12,603	42%	100,000	13,910	14%
3110	NDËRTESTAT (NENTOTALI)	-	-		5,000	-	
31110	Ndertesat e banimit	-	-		5,000	-	
31120	Ndertesat administrative afariste	-	-		-	-	
31121	Objektet arsimore	-	-		-	-	
31122	Objektet shendetesore	-	-		-	-	
31123	Objektet kulturore	-	-		-	-	
31124	Objektet sportive	-	-		-	-	
3120	NDËRTIMI I RRUGËVE (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31210	Ndërtimi i auto rrugëve	-	-		-	-	
31220	Ndërtimi i rrugëve regionale	-	-		-	-	
31230	Ndërtimi i rrugëve lokale	-	-		-	-	
31240	Trotualet	-	-		-	-	
31250	Kanalizimi	-	-		-	-	
31260	Ujësjellësi	-	-		-	-	
3150	FURN.ME RRYME, GJENERIMI (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31510	Furnizim me rrymë gjenerim dhe transmision	-	-		-	-	
3160	PAISJE (SIST.VLERA MBI 1000 EURO) (NENTOTALI)	10,000	9,948	0%	20,000	13,910	70%
31600	Pajisje të Teknologjise Informative (ne vlere mbi 1000 euro)	-	-		-	-	
31610	Pajisje të Teknologjise Informative	10,000	9,948	99%	20,000	13,910	70%
31620	Mobilje	-	-		-	-	
31630	Telefona	-	-		-	-	
31640	Kompjuter	-	-		-	-	
31650	Makina Fotokopjuese	-	-		-	-	
31660	Pajisje Speciale Mjeksore	-	-		-	-	

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

30000	INVESTIMET KAPITALE	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzime ve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzime ve
31670	Pajisje te Shërbimeve Policore	-	-		-	-	
31680	Softver	-	-		-	-	
31690	Pajisje Tjera	-	-		-	-	
3170	AUTOMJETE TRANSPORTI (NENTOTALI)	-	-		75,000	-	
31700	Vetura zyrtare	-	-		75,000	-	
31701	Kamionë	-	-		-	-	
31702	Xhip dhe kombibusë	-	-		-	-	
31703	Vetura të ndihmës së shpejtë	-	-		-	-	
31704	Veturat e shërbimit policor	-	-		-	-	
31705	Motorë	-	-		-	-	
31706	Automjete transporti tjera	-	-		-	-	
3180	MAKINERIA (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31800	Makineria	-	-		-	-	
3190	KAPITAL TJETËR (NENTOTALI)	-	-		-	-	
31900	Kapital tjetër	-	-		-	-	
31910	Avans per investime	-	-		-	-	
3200	INVESTIMET NË VIJIM	20,000	2,655	13%	-	-	
32000	Investimet në vijim	20,000	2,655	13%	-	-	
3210	TOKA (NENTOTALI)	-	-		-	-	
32100	Toka	-	-		-	-	
3220	PASURITË E PAPERKSHME (NENTOTALI)	-	-		-	-	
32200	Pasuri e paprekshme	-	-		-	-	
3310	TRANSF.KAPITALE-ENTITETE (NENTOTALI)	-	-		-	-	

4.e) INVESTIMET KAPITALE: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

30000	INVESTIMET KAPITALE	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzime ve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzime ve
33100	Trans.kap.-entitetet publike	-	-		-	-	

4.f) SUBVENCIONET DHE TRANSFERET: DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

21000	Subvencione dhe Transfere Emri i kategorisë ekonomike	Buxheti 2016			Buxheti 2017		
		Planifikimi Janar - Dhjetor 2016	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2016	% e shpenzim eve	Planifikimi Janar - Dhjetor 2017	Shpenzimet Janar - Dhjetor 2017	% e shpenzim eve
	Gjithsej	90,000	78,809	88%	50,000	41,379	83%
2100	SUBVENCIONET	90,000	78,809	88%	50,000	41,379	83%
2110	Subvencionet per Etnitete Publike	90,000	78,809	88%	50,000	41,379	83%
21120	Subvencionet per Etnitete Publike (Teatri Kombëtar)	-	-	-	-	-	-
21200	Subvencionet per Etnitete Jopublike	-	-	-	-	-	-
2200	TRANSFERET	-	-		-	-	
22100	Transfere per qeveri tjera	-	-	-	-	-	-
22110	Unops-projekti i administrates-Agjensioni Kosovar.I.Pronave	-	-	-	-	-	-
22200	Pagesat për perfitues individual	-	-	-	-	-	-
22210	Pensionet bazë	-	-	-	-	-	-
22220	Pensionet për persona me aftësi te kufizuar	-	-	-	-	-	-
22230	Pensionet e ndihmës sociale	-	-	-	-	-	-
22235	Pensionet e Trupat Mbrojtëse te Kosoves	-	-	-	-	-	-
22240	Pensionet-Kategoria I (për anëtarët e familieve)	-	-	-	-	-	-
22250	Pensionet-Kategoria II (për anëtarët e familieve)	-	-	-	-	-	-
22260	Pagesat për Invalidët e luftes	-	-	-	-	-	-
22270	Pagesat për invalidët civilë	-	-	-	-	-	-
22280	Pagesat e familjeve të të rënëve ne luftë	-	-	-	-	-	-
22300	Pagesa-vendime gjyqesore	-	-	-	-	-	-

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.g) Personeli dhe struktura e pagave

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet	Pozitat e plotësuara	Buxheti I aprovuar me ligjin për paga dhe meditje	Buxheti I shpenzuar për paga deri më 31 Dhjetor 2017	Totali I pagesave shtesë	Numri i përgjithshëm i të punësuarve që pranojnë pagesa shtesë	a) Orari i punës (orar i plotë/gjysëm orari) dhe b) Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6	6	8
Niveli i Bordit	8	8	375,800.00	301,661.00	5,046.00	-	1 mbledhje në muaj
Niveli i menaxhmentit të lartë	3	3	180,000.00	173,293.58	-	-	Me orar të plotë
Niveli i menaxhmentit	110	96	2,283,000.00	2,280,591.51	-	-	Me orar të plotë
Niveli profesional	130	125	1,845,000.00	1,843,510.75	-	-	Me orar të plotë
Niveli mbështetës	15	15	94,884.00	92,883.77	-	-	Me orar të plotë
TOTALI	258	239	4,402,884.00	4,390,279.61	-	-	Me orar të plotë

Shënim:

- Kompenzimi ndaj Bordit të Drejtorëve të AKP-së janë për mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2017. Janë mbajtur gjithsej 17 mbledhje (të zakonshme dhe jashtëzakonshme). Gjithashtu, pagesat e realizuara të prezentuara më lartë paraqesin vlerën neto, ndërsa sipas Ligjit mbi të ardhurat personale, AKP-ja ka deklaruar dhe paguar kontributet dhe tatimet në shumën prej EUR 61 mijë për vitin 2017.
- Pagesat shtesë ndaj anëtarëve të Bordit janë si pjesë e komisioneve për Komitetin e Auditimit . Për periudhën Janar - Dhjetor 2017 janë mbajtur katër mbledhje.
- Pagesat e realizuara për personelin përfshijnë pagën bruto duke përfshirë edhe 5% e punëdhënësit.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

**PASQYRAT FINANCIARE
FONDET NË MIRËBESIM
PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM.....	7
GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	9
HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE.....	13
<i>BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE</i>	<i>13</i>
<i>SUBJEKTI RAPORTUES.....</i>	<i>13</i>
<i>RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË.....</i>	<i>14</i>
<i>VALUTA RAPORTUESE.....</i>	<i>14</i>
<i>DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE.....</i>	<i>14</i>
TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	15
1. TË HYRAT NGA SHITJA.....	15
2. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË	17
3. INTERESI I FITUAR	18
4. TARIFA PËR TENDERËT E SHITJES DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE.....	19
5. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER.....	19
6. TË HYRAT E TJERA	20
7. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	21
SHPENZIMET/SHPËRNDARJA	22
8. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK	22
9. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP)	22
10. MALLRA DHE SHËRBIME	25
10.1 PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE	26
11. SHËRBIMET PUBLIKE	28
12. TATIMET	28
13. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE	29
14. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-SË	30
15.1 TË HYRAT E REALIZUARA PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT.....	30
15. SHPENZIMET TJERA	31
16. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE NË LIKUIDIM	32
17. FONDET TEPRICË TRANSFERUAR QEVERISË SË KOSOVËS	33
LLOGARITË E ARKËTUESHME	34
18. NDËSHKIMET NDAJ NSH-VE ME SPIN-OFF SPECIAL.....	35
19. SHITJA E ASETIVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT	36
20. QIRAJA APO TË HYRAT TË TJERA	37
LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE.....	38
21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE.....	38
22. MALLRA DHE SHËRBIME	38
23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE	39

24. DETYRIMET KONTIGJENTE.....	40
PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE	41
TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE	42
TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM	42
LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE	42
GJENDJA E PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË NSH-VE NË LIKUIDIM	43
LLOJET E LLOGARIVE BANKARE	45

PASQYRAT FINANCIARE 2017

- **PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**
- **GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM**

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUdhËN JANAR – dhJETOR 2017

PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE	Shënime shpjeguese	Deri me	Periudha	Deri me
		31 dhjetor 2016	Janar – dhjetor 2017	31 dhjetor 2017
Të hyrat nga shitjet	1	666,082,049	31,087,867	697,169,916
Të hyrat nga qiraja	2	26,034,444	6,528,207	32,562,651
Interesi i fituar	3	34,844,700	0.00	34,844,700
Tarifa për tenderat e shitjes dhe konfiskimet e BID depozitave	4	7,577,564	652,400	8,229,964
BID depozitat e ofertuese	5	592,320	1,438,500	2,030,820
Të hyra të tjera	6	6,707,317	159,218	6,866,535
Kapitali themeltar i Agjencisë	7	1,013,200	0.00	1,013,200
GJITHSEJ		742,851,594	39,866,192	782,717,786

PAGESAT/SHPËRNDARJA	Shënime shpjeguese	Deri me	Periudha	Deri me
		31 dhjetor 2016	Janar – dhjetor 2017	31 dhjetor 2017
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	8	109,973,567	9,283,737	119,257,304
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit)	9	14,423,930	996,000	15,419,930
Mallra dhe shërbime	10	12,186,335	2,194,849	14,381,184
Shërbime publike	11	1,262,807	731,503	1,994,309
Tatimet	12	3,288,605	1,723,361	5,011,966
Taksa/depozita të Gjykatave dhe vendimet e gjykatave/përmbauesve	13	1,774,806	33,405	1,808,211
Transferimi i mjeteve 5% për aktivitetet e AKP-së	14	32,148,000	6,100,000	38,248,000
Shpenzimet tjera	15	715,255	34,286	749,541
Pagesat ndaj kreditorëve të NSh-ve	16	15,872,028	8,105,856	23,977,884
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	17	90,244,911	325,664	90,570,575
GJITHSEJ		281,890,244	29,528,661	311,418,904

	31 dhjetor 2016	Janar – dhjetor 2017	31 dhjetor 2017
BILANCI BANKAR I PRANIMEVE DHE SHPENZIMEVE	460,961,350	10,337,531	471,298,882

GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

PËR PERIUHDHËN JANAR – DHJETOR 2017

LLOJET E LLOGARIVE NË BQK	JANAR	JANAR	JANAR
	DHJETOR	DHJETOR	DHJETOR
	2017	2016	2015
Privatizim	8,986,889	9,682,795	9,724,189
Likuidim	432,327,446	411,464,705	427,135,393
Para të NSH-ve në mirëbesim	5,325,079	5,016,134	3,544,638
Komercializim	-	3,667,287	3,667,287
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	15,400,400	21,121,998	25,021,170
Depozita nga tenderët e privatizimit	-	-	-
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	-	-	267,527
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim	2,039,421	602,159	10,000
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	14,989	65,099	335,609
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25	25	25
Kapitali themeltar i AKP-së	1,109,549	1,109,549	1,109,549
Fondi rezervë i AKP-së	-	1,000,000	1,000,000
Donator	8,463	8,463	8,463
Tarifa administrative e AKP-së	6,086,620	7,223,136	14,995,375
Depozitat Kohor	1	-	-
GJITHSEJ	471,298,882	460,961,350	486,819,225

Llojet e llogarive bankare në Bankën Qendrore të Kosovës të cilat i administron AKP-ja janë të shpalosura në fund të shënimeve shpjeguese.

SHËNIMET SHPJEGUESE

HYRJE NË SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga “Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim” e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Meqenëse pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP, atëherë sa i përket **llogarive të arkëtueshme, llogaritë e pageshme dhe detyrimet kontingjente janë paraqitur vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Foneve në Mirëbesim.**

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSh-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në **Bankën Qendrore të Kosovës**. Të dhënat nuk paraqesin rezultate të NSh-ve që kanë pasur apo aktualisht kanë menaxhmentin aktiv, të cilët kanë menaxhuar apo administruar me llogaritë bankare në bankat komerciale.

AKP ka në dispozicion edhe shtojcat e pasqyrave financiare të Fondeve në Mirëbesim, të cilat janë raporte të detalizuara që paraqesin bilancet përfundimtare dhe trasakcionet e ndodhura gjatë periudhës raportuese. Këto raporte paraqesin detajet e kategorizuara sipas planit kontabël të fondeve në mirëbesim për llogaritë bankare që administrohen nga AKP. Shtojca e pasqyrave financiare i dorëzohen Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Menaxhmentit dhe Departamenteve/Njësive të AKP-së.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji Nr. 03/L-067) që ka hyrë në fuqi me 1 Korrik 2008 e ndryshuar me Ligjin nr.04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 Shtator 2011 (këtej e tutje “Ligji”) dhe ndryshimet në Ligjin me nr. 080 të datës 24 Dhjetor 2015.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH) nëpërmjet metodave të “spin off-it”, qiradhënies afatgjate, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore sipas Ligjit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit menaxhon Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në Mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës së NSH-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2017. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raporte që paraqesin të dhënat financiare nga data **1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2017.**

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 12 Të Ligjit nr. 04/L-034 të AKP-së.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i gjashtë anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka përfunduar në muajin dhjetor 2017, në përjashtim të Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, mandati i të cilëve skadon në muajin dhjetor 2018.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP-ja menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP-ja bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim më datën **29 Janar 2018** nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

1. TË HYRAT NGA SHITJA

Të hyrat e realizuara nga shitja paraqesin bilancet përfundimtare të pagesave deri më **31 dhjetor 2017** të hyrjeve dhe daljeve në llogaritë bankare të Ndërmarrjeve Shoqërore (fondet në mirëbesim) të cilat administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pasqyra e Pranimeve për shitjet paraqet gjendjen bankare më 31 Dhjetor 2016, gjendje e transaksioneve Hyrëse/Dalëse gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2017 dhe gjendjen përfundimtare bankare më 31 dhjetor 2017.

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin e pranimeve për periudhën raportuese sipas llojeve të shitjeve:

LLOJET E SHITJEVE	VLERA
Shitjet Përmes Valëve të Privatizimit dhe Likuidimit	31,050,073
Të hyra nga bartja e së drejtës banesore	37,794
GJITHSEJ	31,087,867

Ashtu siç është paraqitur më lartë, shuma totale prej EUR **31,050,073** e shitjeve përmes valëve të privatizimit dhe likuidimit paraqet bilancin e pranimeve të realizuar **nga blerësit (kontrata të nënshkruara) dhe ofertuesit (të kontratave të panëshkruara)**. Pra, ky bilanc nuk paraqet realizimin e shitjeve. **Realizimit i shitjeve** ka të bëjë vetëm me nënshkrimin e kontratave me blerësit. Gjatë kësaj periudhe, shitjet e realizuara janë gjithsej EUR **26,851,569** të gjithsej **211 kontratave të nënshkruara**. Detajet e tjera janë të paraqitura në raportin e akviteteteve të AKP-së.

PËRSHKRIMI	VLERA	RENDITJA
Pagesat e realizuara në periudhat paraprake për kontratat e nënshkruara 2017	240,298	1
Bilancet e pagesave të realizuara gjatë vitit 2017	26,608,271	2
BID depozitat të pa transferuar të kontratave të nënshkruara	3,000	3
Gjithsej pagesat e realizuara për kontratat që janë nënshkruar në vitin 2017	26,851,569	4=Σ(1:3)
Pagesa të realizuara të shitjeve të kontratave të panëshkruara/në process	4,441,802	5
				Ofruesi i Shërbimeve Profesional e	Mallra dhe Shërbime	Kreditorët e NSh-ve
Departamenti I Likuidimit	1,591,507	(1,285,420)	306,087	0.00	1,137	304,950
ZQ – Mim Golesh	0.00	328	328	0.00	328	0.00
ZR Prishtinë	31,137	12,013	43,150	0.00	43,150	0.00
ZR Mitrovicë	0.00	1,807	1,807	0.00	1,807	0.00
ZR Pejë	0.00	193	193	0.00	193	0.00
ZR Gjilan	18,057	3,202	21,259	0.00	21,259	0.00
ZR Prizren	1,356	2,813	4,169	0.00	4,169	0.00
GJITHSEJ	1,642,057	(1,265,064)	376,993	0.00	72,043	304,950

Sa i përket obligimeve, ato njihen nga data e pranimit të faturë. Ndërsa për Ofruesit e Shërbimeve me përfundimin e shërbimeve.

Shuma prej EUR 304,950 e papaguar e paraqitur për kreditorët mund të ketë ndryshime, për shkak të kthimit të mjeteve (mos ekzekutimit) nga bankat komerciale për mos ekzekutim të pagesës. Pra mund të ketë ende raste që nuk janë ekzekutuar e që bankat na njoftojnë në janar 2018.

21. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE

Sa i përket obligimeve ndaj OShP-së, për periudhën e përfunduar më 31 Dhjetor 2017, nuk ka asnjë faturë pa paguar. Si pjesë e kontraktuar, bilanci i papaguar paraqet mjetet në dispozicion sipas vlerës të kontraktuar dhe është obligim për vitin 2018 vetëm për pjesën e aneks kontratës me kontraktorin

Për OShP-në, më gjerësisht është shpalosur në *shënimin shpjegues nr. 9*

22. MALLRA DHE SHËRBIME

Shuma prej **EUR 72,043** janë për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSh-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Më poshtë janë paraqitur detajet. Shih në faqen tjetër.

PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE TË NDODHURA	VLERA
Shpallje në gazeta	1,136
Shpenzimet për ofruesit e Shërbimeve	16,124
Paga e muajit dhjetor për punëtorin e MIM Golesh	328
Shpenzimet për shërbimet e sigurimit fizik për ruajtjen e aseteve me operatorët ekonomik	19,436
Qiraja për muajin dhjetor 2017 nga NSh Tregu për pronësinë e përbashkët	3,000
Shërbimet profesionale/matje kadastrale	2,724
Shpenzimet e telekomunikimit	1,351
Shpenzimet për pastrimin e mbeturinave	12,628
Shpenzime për rrymë	14,291
Shërbime të marketingut	237
Furnizim me material higjienik dhe artikuj ushqimor për NSh Grandi dhe ABC Genci	738
Tjera	50
GJITHSEJ	72,043

Sa i përket Ofruesve të Shërbimeve, si obligim janë të paraqitura shuma e përgjithshme të pagave bruto me 5% e punëdhënësit. Pagat neto janë paguar në muajin janar 2018 në shumën prej **EUR 14,156 për gjithsej 55 persona**. Pjesa tjetër prej EUR 1,967 (16,124 – 14,156) janë tatime dhe kontributet pensionale që do të procesohen nga muaji Shkurt 2018 si rezultat i hapjes të llogarisë tatimore për periudhën e pagesave të Janarit 2018.

23. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Ashtu siç është përmendur edhe në *shënimin shpjegues nr. 16*, obligimet e papagura janë pagesat e porealizuara ndaj kreditorëve të NSh-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve.

Gjithsej shuma e vendimeve të aprovuar në Bordine Drejtorëve është EUR 24,282,834. Ndërsa pagesat janë realizuar prej EUR 23,977,884.

Vlera e mbetur për tu paguar prej EUR 304,950 janë si rezultat i mungesës të informacioneve të sakta të llogarive bankare. AKP-ja ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të vënë në kontakt kreditorët në fjalë (edhe përmes reklamave në TV). AKP-ja së fundi ka vënë në përdorim edhe aplikacionin në uebfaqen e saj zyrtare në menyrë që kreditorët të informohen me të dhënat e fundit rreth procesit të shpërndarjes. Këto veprime kanë pasur efekt në shpërndarjen e informacionit ndaj kreditorëve për të cilët janë aprovuar shumat për shpërndarje.

24. DETYRIMET KONTIGJENTE

Janë konteste gjyqësore të pazgjidhura për një numër të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Detyrimet kontingjente janë të shpalosura në këtë format: Kolona 1 paraqet totalin e shumave të periudhës 2016, kolona 2 paraqet rastet e reja dhe të bartura nga viti 2016. Ndërsa kolona 3 paraqet totalin e të gjitha vlerave të bartura, të raportuara të bilanceve deri më 31 Dhjetor 2017.

Detajet në lidhje me detyrimet kontingjente janë paraqitur në Tabelën e më poshtme:

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	MUN DËSIA	1	2	3=1+2
			VLERA POTENCIALE 2016	VLERA POTENCIALE 2017	GJITHSEJ
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P.nr.479/15, kompensim në shumë prej 8.216.91 Euro	e ultë	8,217	0.00	0.00
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr.397/2015, kompensim në shumë prej 2.640.00 Euro	e ultë	2,640	2,640	2,640
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr.1342/11, kompensim në shumë prej 3.440.00 Euro	e ultë	3,440	0.00	0.00
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-09-0135, shpenzime procedurale, në shumë prej 1500 Euro	e ultë	1,500	1,500	1,500
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumën prej 14,478,50 si dhe avokatin në shumën prej 365,04 Euro.	e ultë	14,844	14,844	14,844
Kompensim	Sipas Aktgjykimit SCC-07-0059-Urdhërohet AKM-ja, t'ia bëjë pagesën prej 59,807,04, si dhe shpenzimet e gjykatës prej 780 eurove. NSh Famipa	e ultë	60,587	60,587	60,587
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-00214, AKP-ja detyrohet për pagesën e 35,400. NSh Magjistrala Peje	e ultë	35,400	35,400	35,400
Kompensim	Aktgjykimi SCC-06-0348, NSH Ratko Mitrovicë	e ultë	122,994	122,994	122,994
Kompensim	Aktgjykimi SCC-10-0091, AKP-ja detyrohet për pagesën e 113.794	e ultë	113,794	113,794	113,794
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.190/2007 NSH Auto Prishtina	e ultë	35,725	35,725	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr.185/2009. për NSH Ujmiri në likuidim	e ultë	70,000	70,000	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSH Agrokultura	e ultë	2,296	2,296	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit AC-I-17-0257, agjencia është e obliguar t'i paguaj shpenzimet procedurale	e ultë	0.00	203	203.00
Kompensim	Sipas Aktgjykimit C-II-14-0118, kompensimi i të ardhurave personale	e ultë	0.00	26,247	26,247
Kompensim	Lënda nr. SCC-08-0199 Kërkesë për shërbime menaxheriale nga KEK-u.	e ultë	0.00	4,945,129	4,945,129
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t'i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankuesit	e ultë	0.00	655	655
GJITHSEJ			471,437	5,432,014	5,432,014

PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas ventimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSh-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.

Gjatë periudhës raportuese, bilanci i hyrjeve/daljeve nga llogaria e tarifës administrative është si më poshtë:

Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2016	7,223,136
Shuma e transferuar shtesë për buxhetin e vitit 2017- <i>shënimin shpjegues nr. 14</i>	- (6,100,000)
Gjithsej mjetet e paguara për tarifën fikse sipas aneks kontratës- <i>shënimin shpjegues nr. 9</i>	- (996,000)
Shpenzime për dërgesa postare <i>shënimi nr. 10</i>	- (11,421)
Bilanci i pagesave për Ofruesit e Shërbimeve <i>shënimi nr. 10.1</i>	- (160,519)
Provizione për ruajtjen e asetëve <i>shënimi nr. 10</i>	- (3,050)
Shërbime profesionale – Angazhimi i përmbaruesve apo përfaqësime ligjore <i>shënimi nr. 10</i>	- (830)
Shpalle në gazeta vendore dhe ndërkombëtare <i>shënimi nr. 10</i>	- (46,712)
Shpenzime të marketingut, përkthime, auditimi, taksa gjyqësore dhe tjera <i>shënimi nr. 10</i>	- (1,165)
Tatimet dhe Trustet Pensionale për OSh-të nga tarfia për NSh-të përkatëse <i>shënimi nr. 10</i>	- (20,856)
Shpenzime bankare <i>shënimi nr. 15</i>	- (1,190)
Shpenzimet nga avansi për udhëtim zyrtar/paraja e imët në tarifën administrative të AKP-së	- (38,334)
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve që janë paguar nga tarifa administrative	+ 132,012
Të hyrat për Agjencinë Kosovare të Privatizimi – <i>shih shënimin shpjegues nr. 14.1</i>	+ 3,018,474
Rimbursimi i mjeteve nga llogaritë e NSh-ve për koston fikse të OShP-së	+ 3,093,075
Gjendja në fund të periudhës raportuese më 31 Dhjetor 2017	6,086,620

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Shpërndarja e 75% nga llogaritë e privatizimit për në llogaritë bankare të likuidimit prej **EUR 367,241**;
2. Transferimi i gjendjes bankare të NSh-ve në tranzicion prej **EUR 415,433** dhe llogaritë e komercializimit prej **EUR 3,667,271**. Në total mjetet janë transferuar për në llogaritë bankare të likuidimit prej **EUR 4,082,705**;
3. Konfiskimin e depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit prej EUR 162,500
4. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likuidimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim. *Këto raste janë të paraqitur në shënimin nr. 1, 4 dhe 5.* Gjithsej shuma e transferuar prej **EUR 3,234,008**;
5. Kompensimi i llogarisë të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 3,093,075**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar ndër-vite të kosos fikse dhe variable me OShP-në;
6. Kompensimi i llogaris të tarifës administrative nga llogaritë e NSh-ve përkatëse në vlerën prej **EUR 132,012**; Këto mjete janë kompensuar nga pagesat e realizuar për shpenzimet e NSh-ve të cilat nuk kanë pasur mjeteve për ekzekutim të pagesave;
7. Të hyrat e realizuara transferuara për tarifën administrative prej **EUR 3,018,474 nga 5% i tarifës administrative, konfiskimi i BID depozitave si dhe tarifa për pjesëmarrje në tenderë**;
8. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSh-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është **EUR 421,536**. Këto mjete do të shpërndahen pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

AKP-ja gjatë vitit fiskal 2017 ka mbyllur llogaritë bankare që ka pasur në Procredit Bank duke i transferuar mjetet në llogari të NSh-ve përkatëse prej EUR 295.70 si dhe duke transferuar të drejtën e nënshkrimit në llogarinë që ka pasur gjendjen prej EUR 1,250 për shitjen e Ndërmarrjen e Re. Kjo ka qenë paguar si kapital themeltar për NSh kur është themeluar.

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank:

1. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për liçensën sipas rregullorës të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.

GJENDJA E PROCESIT TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve NË LIKUIDIM

PERIUDHA 2005 - 2017

NR.	LLOJI I TË ARDHURAVE	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE	VLERA
1	Shitje e asetëve	i1 - Shitje gjatë likuidimit	109,132,596
2	Shitje e asetëve	i3 - Depozita të transferuara nga llogaria e depozitës së tenderëve	9,361,270
3	Shitje e asetëve	i1a - Shitjet e banesave	245,994
4	Qiraja	i12 - Të ardhura nga qiraja	15,637,635
5	Interesi	i2 - Interesi i fituar	8,388,625
6	Të ardhura tjera	i4 - TVSH hyrëse	532,714
7	Të ardhura tjera	i8 - Transferimi i depozitave të parave të gatshme	23,029
8	Të ardhura tjera	i13 - Të ardhura tjera	570,697
9	Të ardhura tjera	i9 - Transferim nga llogaritë bankare të NSH-ve	668,091
10	Të ardhura tjera	i10 - Pranimet nga debitorët e NSH-ve	33,354
11	Nga shitja të Nder. Reja	i6 - Transferimi i 75% nga shitjet me privatizim	443,471,431
12	Nga shitja të Nder. Reja	i7 - Transferimi i parave të NSH-ve në mirëbesim	10,834,894
GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM			598,900,330

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE	VLERA
1	Rreg. për punëtorët	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	18,432,392
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	6,103,122
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose asetëve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,129,391
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	100,509
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	15,327,728
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe asetëve	2,105,795
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	5,986,043
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Pagesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	2,839,445
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre asetëve	48,652
10	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	2,169,454
11	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	3,298,332
12	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	17,935,165
13	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSH	526,281
14	19.3.3, 40 dhe 42	Fondet Tepricë dhe Fondet e Mbetura transferuar Qeverisë	90,570,575
GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM			166,572,884

*Detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjesë të mësipërme janë në faqen tjetër

GJENDJA E LLOGARISË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM 432,327,446

PLANI KONTABËL PËR SHPENZIMET E NSH-VE NË LIKUIDIM

Lista detaje e shpenzimeve sipas renditjes të tabelës

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	12,733,713
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	5,698,679
	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitiqeve me likuidim)	5,731,139
2	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
	e1 - Shpenzimet bankare	21,420
	e6 - Shpenzime për reklamim	708,414
	e7 - Kostoja e shitiqeve për likuidim të aseteve	45,320
3	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	272,720
	e9 - Magazininim, transportim i dokumenteve të NSH-ve	7,558
	e10 - Para të imta AVANS për kosto të vogla për likuidim	421
	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	73,537
4	e14 - Shpenzime për gjykatë	100,509
5	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	15,327,728
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	11,917
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	2,093,878
	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,504,097
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	2,182,411
	Pagesa në avans për udhëtime zyrtare	625
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	123,120
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	173,320
	e27 - Mallra	133,574
	e29 - Shërbime	439,945
	e30 - Ujë	131,282
	e31 - Rrymë	945,301
	e32 - Mbeturina	259,258
	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	25,613
	e24 - Udhëtime zyrtare	31,760
	e19 - Tatimi në të ardhura personale për Ofrues të Shërbimeve	358,898
8	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	85,276
	e36 - Tatimi komunal në pronë	599,839
	e38 - Tatimi i korporatës	214,922

9	e39 - TVSH paguar ATK-së	1,577,515
	e41 - Kreditorë të siguruar	48,652
	e43 - Pagat (neto) kreditorë preferencialë 3 paga	1,902,099
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditorë preferencialë 3 paga)	56,878
10	e45 - Kontribute për pension (për kreditorë preferencialë 3 paga)	210,477
	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditorë preferencialë	2,860,533
11	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditorë preferencialë)	118,068
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditorë preferencialë)	319,731
	e49 - Pagat (neto) kreditorë të pasiguruar	5,758,310
	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditorëve të pasiguruar)	771,555
	e51 - Kontribute për pension kreditorë të pasiguruar	1,750,868
	e52 - Kreditorët e pasiguruar - Huazimet	135,755
	e53 - Avanset e pranuar në para të gatshme nga NSH-të - kreditorë të pasiguruar	200,586
	e54 - Furnizues vendorë kreditorë të pasiguruar	2,460,423
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditorë të pasiguruar	204
	e56 - Tatimi në pronë - kreditorë të pasiguruar	1,285,347
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditorë të pasiguruar	58,554
	e58 - Tatimi i korporatës kreditorë të pasiguruar	475,082
	e59 - TVSH kreditorë të pasiguruar	3,193,597
	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditorë të pasiguruar	167,935
	e61 - Rryma kreditorë të pasiguruar	493,379
	e62 - Ujë kreditorë të pasiguruar	194,763
	e63 - Mbeturina kreditorë të pasiguruar	159,787
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditorë të pasiguruar	31,023
	e65 - Kreditorë tjerë të pasiguruar	797,997
13	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në NSH	526,281
	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
14	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	325,664

LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.
2. **LLOGARITË E NSH-VE NË TRANZICION** - Mban paratë e NSH-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që NSH-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të NSH-ve (rasti i statuseve të pa përcaktuara të NSH-ve e të ngjashme).
3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për NSH-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e NSH-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.
4. **LLOGARITË E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mblehura gjatë procesit të komercializimit të NSH-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të NSH-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.
5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shita sipas nenit 9 të ligjit të Agjencisë.
6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.

7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSH-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin ofertuesit të pasuksesshëm. Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSH në likuidim.

9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtresit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.

11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë

12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-SË** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.

13. **LLOGARIA E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.

14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifat administrative të Agjencisë.

15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizojnë këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju

Raporti Financiar

Për periudhën e përfunduar deri me 31 Dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE	5
RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	6
SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL.....	7
1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE	7
1.2. SUBJEKTI RAPORTUES.....	7
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA	8
1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)	8
1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK.....	9
1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE	9
1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE.....	9
SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA.....	9
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME	10
3.1. BUXHETI NGA GRANTI QEVERITAR.....	11
3.2. BUXHETI NGA TË HYRAT E DEDIKUARA	12
3.3. PAGESAT E REALIZUARA	12
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE	15
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	15
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE	16
SHËNIMI 7 KTHIMI I HUAMARRJEVE	17
SHËNIMI 8 TJERA.....	17
SHËNIMI 9 TË HYRAT TATIMORE.....	17
SHËNIMI 10 TË HYRAT JO TATIMORE.....	17
SHËNIMI 11 TË HYRAT E DEDIKUARA.....	17
11.1. Të hyrat e dedikuara për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative të AKP-së	19
SHËNIMI 12 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE.....	20
SHËNIMI 13 HUAMARRJET.....	20
SHËNIMI 14 RAPORTI DETAJ I NDRYSHIMEVE BUXHETORE.....	20
SHËNIMI 15 TË ARKËTUESHMET	21
SHËNIMI 16 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA.....	21
SHËNIMI 17 DETYRIMET KONTINGJENTE.....	22

SHËNIMI 18 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO)	23
SHËNIMI 19 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO)	23
SHËNIMI 20 STOQET	24
SHËNIMI 21 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA.....	24
SHËNIMI 22 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE	25
SHËNIMI 23 RAPORT PËR NUMRIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE TË VEÇANTA PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE	25
SHËNIMI 24 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)	26

ANEKSI I PASQYRAVE FINANCIARE:

TABELA 1 – RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT	1
TABELA 2 – PASQYRA KRYESORE.....	2
TABELA 3 – DETAJET E FATURAVE TË PAPAGUARA	3/6
TABELA 4 – RAPORTI I PASURIVE	7
TABELA 5 – LISTA DETAJE E ADRESIMIT TË REKOMANDIMEVE	8/17

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE

Pasqyra e Pranimave dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit
Për periudhën Janar – Dhjetor 2017

Shënime	2017		2016		2015	
	Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme	Llogaria e vetme e Thesarit	Pagesat nga palët e treta të jashtme
	BKK		BKK		BKK	
BURIMET E FONDEVE						
Granti qeveritar	652,960	-	9,515	-	10,573	-
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	6,223,207	-	6,303,375	-	5,959,695	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim	-	-	-	-	-	-
Pranimet tjera	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ	6,876,167	-	6,312,890	-	5,970,268	-
SHFRYTEZIMI I FONDEVE						
Operacionet						
Paga dhe rroga	4,390,281	-	4,402,591	-	4,321,066	-
Mallra dhe shërbime	2,349,684	-	1,745,292	-	1,401,519	-
Shpenzime komunale	80,913	-	73,594	-	84,980	-
GJITHSEJ	6,820,878	-	6,221,477	-	5,807,565	-
Transferet						
Transfere dhe subvencione	41,379	-	78,809	-	116,003	-
Shpenzime kapitale						
Prona, ndërtesa dhe pajisje	13,910	-	12,603	-	46,700	-
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-
Pagesa tjera	-	-	-	-	-	-
GJITHSEJ	6,876,167	-	6,312,890	-	5,970,268	-

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Për periudhën Janar – Dhjetor 2017

Shënime	Janar – Dhjetor 2017			Variance D=C-B	2016		2015	
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti final (Ndarja) B	Realizimi C		Realizimi	Realizimi	Realizimi	Realizimi
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit								
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	6,920,884	6,920,884	6,111,946	(808,938)	7,199,729	6,811,383		
Grantet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej Pranimet e mbledhura në FKK-në	6,920,884	6,920,884	6,111,946	(808,938)	7,199,729	6,811,383		
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit								
Paga dhe rroga	4,402,884	4,402,884	4,390,281	(12,603)	4,402,591	4,321,066		
Mallra dhe shërbime	2,380,000	2,911,904	2,349,684	(562,220)	1,745,292	1,401,519		
Shpenzime komunale	98,000	118,000	80,913	(37,087)	73,594	84,980		
Transfere dhe subvencione	40,000	50,000	41,379	(8,621)	78,809	116,003		
Shpenzime kapitale	100,000	100,000	13,910	(86,090)	12,603	46,700		
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-		
Tjerat	-	-	-	-	-	-		
Gjithsej pagesat e bëra nga BRK nëpërmes LIVTh	7,020,884	7,582,788	6,876,167	(706,621)	6,312,889	5,970,268		

Raporti detaj i ndryshimeve buxhetore është paraqitur në shënimin shpjegues nr. 14

Buxheti përfundimtar (pas procesit të rishikimit dhe kursimeve buxhetore nga Qeveria) i aprovuar nga Kuvendit i Kosovës për AKP për vitin fiskal 2017 është gjithsej në vlerën EUR 7,582,788. AKP-ja financohet nga 2 (dy) burime: Të Hyrat e Dedikuara EUR 6,920,884 dhe Grandi Qeveritar EUR 661,904. Grandi Qeveritar në tabelën e mësipërme, të hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e Thesarit nuk është paraqitur.

AKP për të mbuluar shpenzimet e planifikuara sipas ndarjeve buxhetore dhe planit të rrjedhës së parasë të dorëzuar në Thesar, për të mbuluar buxhetin e Të Hyrave të Dedikuara depoziton mjetet në Fondin e Kosovës sipas Ligjit të buxhetit (Ligji Nr. 05/L-125, neni 8 paragrafi 6) të aprovuar nga Kuvendi. Në raportin e hyrjes të parasë së gatshme në llogari të Thesarit (shih më lart) paraqitet transferimi i mjeteve shtesë prej EUR 6,100,000 e realizuar më 20 Janar 2017 nga fondi i 5% nga të Hyrat e Dedikuara të AKP-së. Pjesa prej EUR (808,938) e paraqitur tek varianca, përkatësisht në kolonën D, mbulohet nga tepricat e pashpenzuara të buxhetit të vitit 2016. Vlera prej **EUR 6,920,884 nuk është planifikim i të hyrave por planifikim i**

shpenzimeve. Për kujdesin e juaj, AKP-ja nuk planifikon të hyra si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Shuma prej EUR 11,946 është kthim i mjeteve për shpenzimet e telefonisë mobile, pagesa e kthyer që është ekzekutuar nga përbaruesit dhe raste tjera. *Këto raste trajtohet sipas situatës të shënimit nr. 1.5 ,11 dhe 21 të shënimit shpjegues.*

Gjithashtu AKP-ja ka transferuar mjetet prej EUR 325,664.00 në Buxhetin e Kosovës pas përfundimit të procesit të likuidimit për NSh "Den Des". Në përputhje me shtojcën e Ligjit të AKP-së, shuma prej EUR 325,664.00, transferohet në buxhetin e Kosovës të cilat duhet të trajtohen si të hyra për Buxhetin e Kosovës.

Andaj, Departamenti i Thesarit nuk duhet ti trajtoj (regjistroj në planin kontabël) si të hyra të AKP-së siç ka ndodhur për periudhën raportuese.

SHËNIMI 1 INFORMATA PËR ORGANIZATËN DHE POLITIKAT KONTABËL

1.1. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik e bazuar në para të gatshme.

Pasqyrat financiare i përbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga udhëzimet administrative të Ministrisë së Financave dhe janë të bazuar në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare formojnë pjesën përbërëse të pasqyrave financiare dhe duhet të lexohen së bashku dhe në ndërlidhje me pasqyrat financiare.

Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme përgjatë tërë periudhës raportuese.

1.2. SUBJEKTI RAPORTUES

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendorë duke përfshirë një anëtarë të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mandati i gjashtë (6) anëtarëve të Bordit të Drejtorëve ka përfunduar në muajin dhjetor 2017, në përjashtim të Kryesuesit dhe Zëvendës Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve, mandati i të cilëve skadon në muajin dhjetor 2018.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) nëpërmjet të metodave të "spin off-it" dhe shitjeve të asetëve përmes procesit të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore. Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si

administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve në Kosovë.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2017**. Aktivitetet e AKP-së gjatë periudhës raportuese janë financuar nga **Të hyrat e Dedikuara të AKP-së (THD) dhe Granti Qeveritar (GQ)**.

Sipas Ligjit të LMFP-së (neni 64) dhe Ligjit të AKP-së 04/L-034 (neni 21), **Të hyrat e Dedikuara (THD)** janë 5% i të gjitha të hyrave të pranuarra si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, është tarifë administrative për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative.

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar aktivitetet që kanë të bëjnë me riorganizimin e NSh-së në këtë rast Ndërmarrjen Trepça, e cila deri në periudhën raportuese, ka qenë nën kompetencën e Agjencisë sipas Ligji nr. 04/L-035 për Riorganizimin e Ndërmarrjeve të Caktuara dhe Pasurisë së tyre.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETË

Janë pagesa që realizohen **nga palët e treta për Agjencinë Kosovare të Privatizimit**, për paga, mallra, shërbime apo çfarëdo shpenzimi tjetër ndaj operatorëve ekonomik.

Ashtu siç është paraqitur në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave, gjatë periudhës raportuese, Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka përfituar asnjë rast, për të cilat, palët e treta do t'i realizonin pagesat ndaj operatorëve ekonomik.

1.4. LLOGARIA E VETME E THESARIT (LLVTH)

Nga Granti Qeveritar, pranimi i të hyrave dhe realizimi i pagesave bëhet vetëm nëpërmjet llogarisë kryesore të Thesarit, të cilën e menaxhon dhe administron Departamenti i Thesarit në Ministrinë e Financave. Meqenëse sipas Ligjit nr. 04/L-034, mjet kryesor i financimit të aktiviteteve të AKP-së janë të hyrat e dedikuara, Thesari ka hapur një llogari ekskluzivisht për AKP-në. Kjo llogari menaxhohet dhe administrohet nga Thesari si llogaria kryesore.

Llogaria e hapur nga Thesari në të cilën i pranon mjetet nga AKP-ja për mbulimin e shpenzimeve është: Privatizimi Tarifa Administrative" me numër të llogarisë 1000400070004642. Në përputhje me ligjin nr. 04/L-034, tepricat (mjetet e pashpenzuara) barten për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasues.

Nga viti fiskal 2012, shpenzimet operative dhe administrative të Agjencisë Kosovare të Privatizimit mbulohen nga Të Hyrat e Dedikuara (THD).

Sa i përket fondeve në mirëbesim, bazuar në ligjin mbi themelimin e AKP-së dhe procedurave bankare të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve, AKP operon me llogaritë bankare në mirëbesim të mbajtura në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Pasqyrat Financiare dhe Shënime Shpjeguese

të Fondeve në Mirëbesim sipas nenit 20 të Ligjit të AKP-së janë paraqitur ndaras nga Pasqyrat Financiare të AKP-së.

1.5. KTHIMET E SHPENZIMEVE NGA VITI PARAPRAK

Sipas Ligjit MIFPP, gjatë periudhës raportuese, mjetet e kthjera për korrjigim apo rimbursim të pagesave për vitet paraprake, regjistrohen si “të hyra nga vitet e kaluara”, ndërsa për shpenzimet e vitit aktual stornohen apo regjistrohen si zbritje të shpenzimeve.

1.6. VALUTA DHE SHUMA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro (€). Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në tabelat përkatëse.

1.7. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare janë autorizuar për lëshim më 29 janar 2018 nga: Ekrem Hajdari, Drejtor Menaxhues, AKP, dhe Adem Selishta, u.d. Drejtor i Financave dhe Buxhetit, AKP.

SHËNIMI 2 PAGA DHE RROGA

Përshkrimi	Buxheti		Janar – Dhjetor 2017		Gjithsej Pagesat €	Krahasimi %	2016 Pagesat €	2015 Pagesat €
	Final €	GQ €	THD €					
Pagat neto përmes listës së pagave	3,645,000	-	3,638,852		3,638,852	99.83%	3,649,751	3,584,559
Pagesa për sindikatë	-	-	-	-	-	-	-	-
Pagesa neto për punë jashtë orarit	-	-	-	-	-	-	-	-
Punëtorët me kontratë (jo në listën e pagave)	338,562	-	333,496	-	333,496	98.50%	333,543	324,976
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	209,661	-	208,967	-	208,967	99.67%	209,649	205,766
Kontributi pensional-punëtori	209,661	-	208,967	-	208,967	99.67%	209,649	205,766
Kontributi pensional-punëdhënësi	209,661	-	208,967	-	208,967	99.67%	209,649	205,766
GJITHSEJ PAGA DHE RROGA	4,402,884	-	4,390,281	-	4,390,281	99.71%	4,402,591	4,321,066

Buxheti i aprovuar për vitin fiskal 2017 është në vlerën prej **EUR 4,402,884** dhe është ndarë në programin “Administrata Qendrore” të AKP-së.

Ashtu siç është paraqitur edhe në tabelën e mësipërme, gjatë këtij viti fiskal, burim i vetëm i financimit për mbulimin e pagave dhe mëditjeve për punëtorët e AKP-së janë **të hyrat e dedikuara (THD)**

Numri i punëtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2017 është gjithsej 258 zyrtarë. Shih edhe në shënimin shpjegues nr 22.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Ministrisë së Administratës Publike, në të cilën, AKP-ja dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse. Ministria e Administratës Publike pas analizave përcjell informatat tek Ministria e Financave e Financave e cila procedon pagesat në logaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME

Shumat e paraqitura në tabelën e mallrave dhe shërbimeve janë financuar nga të Hyrat e Dedikuara (THD) dhe për Trepçën nga Granti Qeveritar (GQ). Më poshtë janë paraqitur dhe shpalosur në detaje shënimet lidhur me dy burimet e financimit për buxhetin e AKP-së.

Përshkrimi	Buxheti Final €	Janar – Dhjetor 2017			Gjithsej Pagesat €	Krahasimi %	2016 Pagesat €	2015 Pagesat €
		Pagesat		THD €				
		GQ €	THD €					
Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jashtë vendit	-	-	-	-	0%	4,654	2,269	
Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar brenda vendit	2,250	-	856	856	38%	-	-	
Shpenzimet e Udhëtimit zyrtar jashtë vendit	12,000	-	11,478	11,478	96%	-	-	
Mëditja e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,250	-	167	167	13%	-	125	
Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jashtë vendit	10,000	-	2,484	2,484	25%	2,386	845	
Shpenzimet për internet	11,300	-	3,130	3,130	28%	3,456	5,575	
Shpenzimet e telefonisë mobile	45,400	-	41,083	41,083	90%	44,143	51,456	
Shpenzimet postare	13,400	-	3,008	3,008	22%	1,723	3,132	
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	30,000	-	23,394	23,394	78%	17,363	7,555	
Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës	28,300	-	2,425	2,425	9%	6,181	823	
Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse	375,800	-	375,387	375,387	100%	348,898	13,729	
Shërbime shtypje- jo marketing	9,000	-	194	194	2%	1,731	847	
Shërbime Kontraktuese Tjera	1,252,081	651,986	393,967	1,045,953	84%	519,699	574,184	
Shërbime Teknike	20,600	974	7,474	8,448	41%	7,659	5,715	
Mobile (me pak se 1000 euro)	7,600	-	225	225	3%	6,908	-	
Kompjuterë (me pak se 1000 euro)	-	-	-	-	0%	14,158	-	
Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	27,000	-	26,503	26,503	98%	36,311	47,955	
Pajisje tjera (me pak se 1000 euro)	8,000	-	2,620	2,620	33%	1,080	21,931	
Furnizime për zyrë	45,000	-	41,245	41,245	92%	38,851	20,631	
Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	29,300	-	25,157	25,157	86%	14,944	10,292	
Furnizime pastrimi	10,000	-	6,902	6,902	69%	9,339	9,523	

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Furnizim me veshmbathje	8,000	-	-	0%	-	5,857
Akomodimi	-	-	-	0%	-	274
Nafte për ngrohje qendrore	46,000	-	37,330	81%	35,204	29,715
Derivate për gjenerator	11,200	-	2,408	21%	1,264	9,743
Karburant për vetura	34,200	-	28,195	82%	23,986	28,794
Vaj	4,500	-	709	16%	21	40
*Avanc	15,000	-	-	0%	-	-
Regjistrimi i automjeteve	6,620	-	150	2%	3,125	2,250
Sigurimi i automjeteve	9,000	-	6,899	77%	8,405	7,395
Taksa komunale e regjistrimit te automjeteve	380	-	-	0%	350	270
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	40,500	-	30,963	76%	20,710	23,846
Mirëmbajtja e ndërtesave	2,000	-	529	26%	651	7,804
Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	18,913	-	17,681	93%	14,035	13,193
Mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve	16,500	-	495	3%	14,538	20,660
Qiraja për ndërtesa	247,500	-	242,140	98%	414,334	420,564
Qiraja për përdorime tjera hapësinore	170,310	-	170,310	100%	-	-
Reklamat dhe konkurset	4,800	-	2,769	58%	5,988	807
Botimet e publikimeve	12,000	-	5,389	45%	-	-
Shpenzimet për informim publik	282,100	-	173,434	61%	88,768	10,829
Drekat zyrtare	10,000	-	6,216	62%	8,539	3,225
Shpenzime-vendimet e gjykatave	34,100	-	3,407	10%	25,890	39,666
GJITHSEJ MALLRA DHE SHËRBIME	2,911,904	652,960	1,696,724	81%	1,745,292	1,401,519

*Avanc ka qenë e buxhetuar për paranë e imët që është mbajtur në arkë. Të gjitha pagesat prej EUR 5,831 janë kategorizuar sipas planit kontabël, kurse bilanci tani është zero pas kthimit të mjeteve të pashpenzuar.

3.1. BUXHETI NGA GRANTI QEVERITAR

Buxheti i aprovuar fillestar nga Granti Qeveritar (GQ) për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” ka qenë EUR 100.000.00. Gjatë riskimit sipas Ligjit të Buxhetit Nr. 06/L-002, buxheti nga Granti Qeveritar (GQ) është rritur për EUR 598,920.00.

AKP, në kërkesën buxhetore të dorëzuar në Ministrinë e Financave nga Granti Qeveritar (GQ) për vitin 2017 për Riorganizimin e Trepçës ka kërkuar mjete në shumë prej EUR 698,920.00. Qëllimi i mjeteve të kërkuara ka qenë mbështetja e punëve të nevojshme për përgatitjen e Planit të Riorganizimit të Trepçës dhe në veçanti angazhimi i OShP-së për Studimin e Fizibilitetit të Trepçës i cili është iniciuar me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të AKP-së. Pavarësisht kërkesës së AKP-së, Ministria e Financave fillimisht nuk kishte aprovuar kërkesën buxhetore në tërësi.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Për të mos ngecur në realizimin e pagesës, gjatë procesit të rishikimit të buxhetit 2017, AKP ka kërkuar nga MF aprovimin e buxhetit shtesë për vlerën e kontratës së nënshkruar në mes AKP dhe OSHP-së në shumë prej EUR 598,920.00. Ministria e Financave dhe Kuvendi sipas Ligjit të rishikimit të buxhetit Nr. 06/L-002 nga Granti Qeveritar ka aprovuar rritjen e buxhetit sipas kërkesës së AKP-së.

- Gjithashtu, me vendim të Qeverisë me nr. 10/19, buxheti nga Granti Qeveritar është shkurtuar në shumën prej EUR 37,016 në kategoritë si më poshtë:
 - për “shërbime kontraktuese tjera” në kodin 13460 në shumën prej EUR 17,016; dhe
 - për Shpenzimet për informim publik në kodin 14230 në shumën prej EUR 20,000

Buxheti përfundimtar më 31 dhjetor 2017 është EUR 661,904 pas ndryshimeve buxhetore me rishikimit të buxhetit dhe vendim të Qeverisë për kursime buxhetore.

3.2. BUXHETI NGA TË HYRAT E DEDIKUARA

Për të Hyrat e Dediкуara, buxheti i aprovuar për kategorinë “Mallra dhe Shërbime” është EUR 2,250,000.00. Para procesit të rishikimit të buxhetit kemi pasur transfere ndërmjet programeve buxhetore. Shih tabelën e mëposhtme:

PËRSHKRIMI	VLERA	Shuma e transferit	Buxheti pas transfereve
Likuidimi - (zvogëlim i buxhetit nga kodet e shpenzimeve për informim publik).	540,000	(80,000)	460,000
Administrata Qendrore - (ritje e buxhetit të kodit i Shërbimeve tjera kontraktuese)	1,320,000	50,000	1,370,000
Privatizimi - (ritje e buxhetit të kodit i Shpenzimeve për informim publik)	200,000	30,000	230,000

3.3. PAGESAT E REALIZUARA

Sa i përket pagesave, në mënyrë që lexuesi të ketë një pasqyrë më të qartë, do të pasqyrohen më në detaje në tabelat e mëposhtme, pasi që brenda një kategorie (kodit ekonomik të shpenzimeve) janë realizuar pagesa për shërbime të ndryshme dhe që kanë vlera të mëdha.

3.3.1 Shërbimet kontraktuese tjera në shumën prej EUR 1,045,953 përfshinë pagesat si më poshtë:

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
*Pagesa ndaj Ofruesit të shërbimeve profesionale për studimin e fizibilitetit për Trepçën në shumën prej EUR 598,920 si dhe interesin krijuar për vonesën në pagesë prej EUR 35,935.20 – Granti Qeveritar	634,855	60.70%
Pagesat ndaj BSPK-së, kompensimin e shpenzimeve mujore. Ky kompensim bëhet në përputhje me vendimin e Bordit të Drejtorëve	51,228	4.90%
Shërbimet e sigurimit të Zyrave të AKP-së ndaj operatori ekonomik “Policia e Kosovës”	176,440	16.87%
Vlerësim dhe Auditimi i NSH Dubrava Live Stock, NSH “IDGJ Tobacco” dhe NSH “Emin Duraku”	6,889	0.66%
Shpenzime për përktim të dokumentacionit për interes publik	7,131	0.68%

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2017 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Pagesat e trusteve pensionale dhe tatimit në të ardhura personale për Ofruesit e Shërbimeve	15,248	1.46%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për analizë të raportit të fizibilitetit për Trepçën – Granti Qeveritar	15,098	1.44%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për ruajtjen e aseteve të NSh-ve para se të hyjnë në likuidim	32,526	3.11%
Sigurimi i mbulimit të përgjegjësisë për Drejtoret e Bordit të AKP-së dhe disa zyrtarëve të Lartë të AKP-së	31,624	3.02%
Pagesat ndaj Ofruesve të Shërbimeve për shërbimet e tjera administrative sidomos për NSh në transicion	55,785	5.33%
Punëtori për organizimin e planit të punës të AKP-se për vitin 2018	3,460	0.33%
**Ekzekutimi i pagesave nga Thesari i Ministrisë së Financave ndaj përmbauesve privat	10,583	1.01%
Pagesa për shpërblim në pagë pas daljes në pension si dhe një pjesë e pagës për ish-zyrtarin e AKP-së i cili është emëruar Gjykatës.	2,166	0.21%
Shpenzime tjera	2,920	0.28%
GJITHSEJ PAGESATERREALIZUARA NË KATEGORINË “SHËRBIME KONTRAKTUERE TJERA”	1,045,953	100%

***Pagesa e interesit prej EUR 35,935.20** ka ndodhur si rezultat i tejkalimit të afatit të pagesës në shumën prej EUR 598,920 ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale. Afati i pagesës ka qenë në qershor 2017, ndërsa kjo pagesë është realizuar në muajin nëntor 2017. Agjencia Kosovare e Privatizimit gjatë vitit 2016, duke u mbështetur në Ligjin e Buxhetit në shumën prej EUR 1,816,039 të aprovuar nga Granti Qeveritar (GQ) për planin e riorganizimit të Trepçës, ka iniciuar dhe përfunduar të gjitha procedurat e prokurimit publik për realizimin e “Studimit të Fizibilitetit të Trepçës me Orientim Strategjik për zhvillim të saj” dhe me datën 20 shtator 2016 ka nënshkruar kontratën me Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP) në vlerë prej EUR 598,920. Meqenëse shërbimi i kontraktuar do të zgjatej /bartej edhe në vitin 2017, AKP përmes kërkesës buxhetore të dorëzuar në MF ka kërkuar aprovimin e buxhetit për vlerën e kontratës së nënshkruar në shumën prej EUR 598,920, për përmbushjen e obligimit financiar ndaj OSHP-së i cili është pritur të realizohet në kuartalin e parë ose të dytë të vitit 2017. Pavarësisht kërkesës së AKP-së, Ministria e Financave nuk kishte aprovuar kërkesën dhe si rrjedhojë përmes shkresave zyrtare edhe disa herë kemi njoftuar MF dhe kemi kërkuar alokimin e buxhetit duke i njoftuar për kushtet dhe termat e pagesës sipas kontratës së nënshkruar.

Së fundmi, përmes procesit të rishikimit të buxhetit gjysmë-vjetor, AKP-ja ka paraqitur kërkesën për rritje të buxhetit, të cilën Qeveria e kishte aprovuar. Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar Ligjin e rishikimit tek në muajin nëntor 2017, dhe si rezultat i kësaj vonese (alokimit të mjeteve nga MF për realizimin e pagesës) OSHP-ja ka aplikuar kamatë ditore për vonesën në pagesë e cila ka qenë në përputhje me nenin 16.5 të kontratës të nënshkruar ndërmjet dy palëve.

****Ekzekutimi i pagesave nga Thesari i Ministrisë së Financave ndaj Përmbauesve Privat.** Departamenti i Thesarit ka ekzekutuar dy pagesa ndaj përmbauesit privat në shumën totale prej EUR 10,583, shuma totale e cila përbën pagesën e obligimeve dhe interesit ndaj Grupit Koha në shumën prej EUR 9,402.51 si dhe pagesën prej EUR 1,180.70 për obligimet e pretenduara ndaj “Siguria”.

Sa i përket pagesës të obligimeve ndaj Grupit Koha, në shumën prej EUR 6,365, këto obligime kanë qenë të prezantuara në pasqyrat financiare 2016 tek obligimet kontingjente të AKP-së si dhe obligimet e papaguara në fondet në mirëbesim për NSh-të përkatëse. Këto obligime nuk kanë qenë brenda vlerës të kontraktuar, mirëpo në anën tjetër, AKP-ja kishte bërë porosi për shpallje të cilat Grupi Koha i kishte publikuar për shpalljen e listave punëtoresh për 20%. Menaxhmenti për të ikur ndëshkime, kamatave dhe tarifave që aplikohen nga përmbauesit ka marrë vendim që këto obligime të paguhen në mënyrë që të eliminohehin kostot tjera përmbaresh.

Në të njëjtën kohë, në vitin 2016 sipas marrëveshjes në takimin e mbajtur në mes dy palëve, ishin pajtuar që pas realizimit të pagesës të obligimeve, Grupi Koha do të tërhiqej nga të gjitha procedurat e iniciuara përmbaresh.

procedura përbarimore dhe se Thesari ka ekzekutuar mjetet duke përfshirë edhe interesin, që në total janë EUR 9,402.51. AKP-ja ka kërkuar që këto mjete të kthehen, pasi që përbën ekzekutim të dyfishtë të mjeteve, me nga EUR 6,365 (pagesa në vitin 2016 dhe tani në 2017), si dhe interesin dhe kosto tjera përbarimore, që sipas marrëveshjes, operatori do të duhej të tërhiqej nga këto procedura. Ne kemi përcjell shkresat ndaj Grupit Koha që të bëjë kthimin e mjeteve, mirëpo, “Grupi koha” ka kthyer vetëm shumën prej EUR 6,365 të obligimeve, ndërsa pjesën tjetër të kostove përbarimore prej EUR 3,037.51 nuk i ka kthyer ende. AKP-ja do të shqyrtoj rrugët ligjore që pala të bëjë kthimin e mjeteve. *Shuma e kthyer prej EUR 6,365 është paraqitur në shënimin shpjegues nr. 11 si dhe në shënimin shpjegues nr. 21.*

Gjithashtu edhe për rastin “Siguria”, AKP-ja ka shikuar të gjithë dokumentacionin dhe ka vërtetuar se nuk ka asnjë obligim ndaj këtij operatori. AKP-ja për shpenzimet e vitit 2008 i ka përfunduar pagesat ndaj shpediterit “Forca”, përmes të cilit, sipas kontratës janë pranuar shërbimet e “Siguria”. Edhe për këtë rast, AKP-ja ka kërkuar që të bëhet kthimi i mjeteve, dhe në qoftë se këto mjete nuk kthehen, AKP-ja do të ndjek procedurat ligjore.

Gjithashtu, në anën tjetër, AKP-ja ka ngritur shqetësim edhe në Departamentin e Thesarit, i cili nuk na ka njoftuar përmes të gjitha rrugëve të komunikimit, siç ka qenë edhe më përpara praktik. Pra, Thesari do të duhej të sigurohej saktësisht dhe në mënyrë të plotë për rastet në fjalë dhe jo të ndërmer veprime, pa marrë “feedback” e plotë të AKP-së.

3.3.2. Shërbimet të ndryshme intelektuale dhe këshillëdhënëse në shumën prej EUR 375,387

PËRSHKRIMI	VLERA	% e totalit
Kompensimi në vlerën neto i anëtarëve të Bordit për mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme	301,661	80.36%
